

ENTI RREGULLATOR I UJIT I SHQIPËRISË

Raporti i Performancës për Shoqëritë Ujësjetëlës Kanalizime

2024



Publikuar nga Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë (ERRU)
Rr. "Viktor Eftimiu" Nd. 1, Njësia Administrative Nr.5, 1022
Tiranë, Shqipëri

E-mail: public@erru.al
Tel: +355 42 258 046
Faqja e internetit: www.erru.al
©Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë

Korrik 2025

PËRMBAJTJA

Shkurtime	3
Përmbledhje.....	4
Parathënie	12
1 Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendenca	14
1.1 Analiza e Treguesve Kryesorë të Performancës për Sektorin	14
1.1.1 Uji Pa të Ardhura (UPA).....	15
1.1.2 Mbulimi i Kostos Direkte të O&M dhe i Kostos Totale	16
1.1.3 Norma e Arkëtimit	20
1.1.4 Niveli i Matjes.....	21
1.1.5 Eficenca e Stafit.....	212
1.1.6 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	22
1.1.7 Mbulimi me Shërbimet e KUN	22
1.1.8 Eficenca e Energjisë.....	23
1.1.9 Ankesat e Klientëve.....	25
1.2 Rezultatet Financiare të Sektorit	25
1.2.1 Të Ardhurat nga Aktiviteti dhe Subvencionet.....	25
1.2.2 Investimet në Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimit të Ujërave të Ndotura ...	27
1.3 Besueshmëria dhe Saktësia e të Dhënave të Raportuara nga Shoqëritë UK.....	29
2 Analiza e Performancës për Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime	31
2.1 Analiza e Performancës në Lidhje me Objektivat e Vendosura nga ERRU	32
2.2 Treguesit Kryesorë të Performancës.....	33
2.2.1 Uji Pa të Ardhura (UPA).....	33
2.2.2 Mbulimi i Kostove O&M.....	35
2.2.3 Mbulimi i Kostove Totale	39
2.2.4 Norma e Arkëtimit	40
2.2.5 Niveli i Matjes.....	42
2.2.6 Eficenca e Stafit.....	45
2.2.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë.	48
2.2.8 Mbulimi me Kanalizime.....	50
2.2.9 Eficenca Energjisë	53
2.2.10 Ankesat e Klientëve.....	56
Renditja e Shoqërive UK Sipas Performancës.....	58
3 Progresi i Reformës në Sektorin e Ujësjiellës-Kanalizime	59
4 Konkluzione dhe Rekomandime	61
5 Tema e Veçantë: Ndikimi i Skemës së Subvencionimit për Familjet me Ndihmë	
 Ekonomike.....	62
6 Aneke: Të dhënat Kryesore të Sektorit.....	71

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
UK	Ujësjiellës Kanalizime
SHUK	Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime
SHRUK	Shoqëri Rajonale Ujësjiellës Kanalizime
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
AKUK	Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve
TKP	Treguesit Kryesor të Performancës
ITUN	Impiant i Trajtimin të Ujërave të Ndotura
FU	Furnizimi me Ujë
KUN	Kanalizime të Ujërave të Ndotura
O&M	Operim dhe Mirëmbajtje
NAP	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme
NAK	Norma e Arkëtimit Korente
UPA	Uji Pa të Ardhura
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Përmbledhje

Raporti i Performancës, si Instrument Analize, Informimi dhe Transparence i Sektorit Ujësjiellës Kanalizime (UK)

Raporti Vjetor i Performancës për sektorin UK dhe për secilën shoqëri të licencuar përbën një detyrim ligjor të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU-së), në cilësinë e tij si institucion rregullator i pavarur. Ky dokument synon të ofrojë një pasqyrë të zhvillimit të sektorit UK dhe të vlerësimit të performancës së secilës shoqëri UK, krahasuar me vitin paraardhës (benchmarking) duke shërbyer gjithashtu si instrument transparence dhe informimi publik për të gjithë aktorët e përfshirë në sektorin e ujit.

Hartimi i tij realizohet pasi ERRU siguron të dhënat financiare të vitit 2024 nga shoqëritë UK, të cilat duhet të jenë certifikuar nga auditues të autorizuar deri në fund të marsit të vitit pasardhës. Paralelisht, sektori i monitorimit pranë ERRU mbledh dhe përpunon të dhëna të tjera me karakter teknik dhe operacional.

Përveç analizës së të dhënave, raporti përmban edhe rekomandime për përmirësimin e treguesve të performancës tekniko-ekonomike të shoqërive UK, duke shërbyer gjithashtu si një instrument krahasimi të performancës ndërmjet shoqërive.

Viti 2024 konsiderohet si viti i dytë i implementimit të reformës në sektorin e ujit në Shqipëri, ku deri në mbyllje të vitit janë krijuar 14 shoqëri rajonale UK, nga 15 të planifikuara sipas reformës. Ndërkohë, në sektor vazhdojnë të operojnë 3 shoqëri UK ekzistuese si SHUK Tiranë, Kamëz dhe Vorë.

Duke qenë se aktualisht në sektor operojnë 14 shoqëri rajonale UK, analiza në këtë raport do të realizohet në bazë të këtyre shoqërive, së bashku me tre shoqëritë UK ekzistuese, për efekt krahasimi me vitin paraardhës 2023 dhe vlerësimin e ecures që nga viti 2022. Në këtë kontekst raporti për këtë vit nuk është paraqitur i ndarë në grupe ku krahasimi ndërmjet shoqërive UK realizohej sipas madhësisë së numrit të lidhjeve, por shoqëritë do trajtohen dhe krahasohen në një grup të vetëm, duke marrë në konsideratë strukturën e re të shoqërive rajonale UK.

Treguesit Kryesorë të Performancës së Sektorit UK, Viti 2024

Treguesit Kryesorë të Performancës (TKP) për vitin 2024 për vlerësimin e performancës së shoqërive UK jepen në tabelën e mëposhtme nr.1.

Tabela nr.1: Treguesit Kryesorë të Performancës për vitet 2023-2024

Nr.	Treguesit Kryesorë të Performancës	2023	2024	Tendenca	Performancë e Mirë (ERRU)
1	Uji Pa të Ardhura (%)	64.7	61.0	↗	30
2	Mbulimi i Kostove O&M (%)	100.5	107.6	↗	100
3	Mbulimi i Kostos Totale (%)	72.8	83.2	↗	80
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	103.5	102.6	↘	82
5	Norma e Arkëtimit Korente(%)	83.9	84.6	↗	82
6	Niveli i Matjes (%)	86.5	87.9	↗	85
7	Efienca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	4.56	4.43	↗	4/6/10
8	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	16.3	17.44	↗	18
9	Mbulimi me Kanalizime KUN (%)	54.8	57.0	↗	75
10	Mbulimi me Furnizim me Ujë (%)	75.3	77.8	↗	n/a
11	Efienca e Energjisë FU (kwh/m³)*	0.63	0.66	↗	n/a
12	Ankesat e Klientëve (%)*	4.23	4.64	↘	n/a

Burimi: ERRU

Referuar tabelës së mësipërme, vërehet se reforma në sektorin UK gjatë vitit 2024, ka dhënë ndikim pozitiv, duke çuar në përmirësim të ndjeshëm në shumicën e

treguesve të performancës, veçanërisht në gjendjen financiare të sektorit, në krahasim me vitin paraardhës 2023, i cili përbënte një ndër objektivat kryesorë të reformës dhe të Strategjisë Sektoriale Kombëtare 2023-2030.

Mbulimet e Kostove Totale dhe ato O&M kanë një përmirësim të ndjeshëm përkatësisht me 10.4% dhe 7.1%, ndërsa Norma e Arkëtimit Korente është përmirësuar me 0.7%.

Përmirësimi i treguesit të Kostove të Operim & Mirëmbajtjes, i cili është rritur me 7.1%, vjen kryesisht si rezultat i uljes së disa prej kostove të Operim dhe Mirëmbajtje (O&M) me përjashtim të kostove të punës, të cilat kanë pësuar një rritje me 6%, kostot e Riparim dhe Mirëmbajtje me 8% dhe shpenzimet e qerasë të cilat rriten me 14%. Ndikimin kryesor e japin reduktimi i kostove të materialeve kimikate me -8% ose -22.5 milion lekë, duke vijuar më tej me kostot e karburanteve me -5% ose -11.5 milion lekë, kostot e tjera operacionale me -23% ose -103.4 milion lekë si dhe kostot e shërbimeve të nënkontraktuara me -2% ose -11.3 milion lekë. Gjithashtu edhe mbulimi i Kostove Totale ka rritje me 10.4% si pasojë e uljes së kostove të amortizimit me -9% ose -229.3 milion lekë dhe interesat & principalet, të cilat kanë shënuar një rënie të ndjeshme me 49% ose 312.7 milion lekë.

Treguesit e tjetër të përmirësuar për vitin 2024 lidhen direkt me rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve dhe menaxhimit më të mirë të shoqërive UK, si: rritja e Normës së Arkëtimit Korente të cilat paraqiten përkatësisht në nivelin 84.6%, Niveli i Matjes në 87.9%, Eficenca e Stafit në 4.43 staf/1000 lidhje UK dhe Mbulimi me Kanalizime në 57%.

Treguesi “Eficenca e Stafit” në nivelin 4.43 punonjës për 1000 lidhje UK është përmirësuar për vitin 2024, pasi numri i lidhjeve është rritur me rreth 29,340 lidhje uji dhe me rreth 24,041 lidhje Kanalizime të Ujërave të Ndotura (KUN). Megjithatë, kostot e punës kanë vijuar të rriten me 6%, duke zënë 55% të kostove operacionale, kryesisht si rezultat i ndryshimit të pagës minimale në vitin 2023 dhe rritjes së përgjithshme të pagave në vitin 2024.

Treguesi “Uji Pa të Ardhura” mbetet një nga indikatorët kryesorë të performancës së sektorit UK, duke reflektuar një trend zbritës dhe përmirësim të vazhdueshëm. Viti 2024, si viti i dytë i funksionimit të sektorit në formë të rajonalizuar tregoi mirëmenaxhim, seriozitet dhe përgjegjshmëri në ofrimin e shërbimit për konsumatorët, si dhe raportim të saktë të të dhënave, të cilat sjellin një pasqyrim më real të performancës së sektorit UK. Gjatë vitit 2024, problematikat dhe vështirësitë e hasura gjatë hartimit të Bilancit të Ujit, për shkak të nivelit të ulët të matjes në disa prej shoqërive UK, lidhur me vlerësimin e volumeve të prodhuara dhe faturuara, tregojnë arsyet e luhatjeve të herëpashershme të treguesit “Uji pa të ardhura” (UPA) në disa prej tyre.

Sa i takon treguesit “Ankesat e Klientëve” ky tregues ka pësuar rritje krahasuar me vitin 2023, si rezultat i problemeve që u shfaqën gjatë riorganizimit dhe konsolidimit të shoqërive rajonale UK.

ERRU, në përputhje me kërkesat e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK dhe të rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve i ka dhënë një rëndësi të veçantë përcaktimit dhe vlerësimit të TKP.

**Bilanci
Financiar i
Sektorit UK**

Performanca financiare e sektorit UK për vitet 2023 dhe 2024 jepet në mënyrë të përmblodhur në tabelën nr. 2.

Tabela nr.2: Performanca financiare e sektorit UK për vitet 2023 dhe 2024 (në 000 lekë)

Nr.	Kostot e Shërbimit UK	Viti 2023	Viti 2024	Diferenca 2024- 2023	Rritja/Rëni 2024/2023 në %
1	Kostot Operim & Mirëmbajtjes	10,346,217	10,575,792	229,575	2%
2	Kostot Kapitale	3,926,215	3,093,276	(832,939)	-21.2%
3	Kostot Totale	14,272,432	13,669,068	(603,364)	-4.2%
4	Të Ardhurat nga Aktiviteti UK	10,395,198	11,378,607	983,409	9.5%
5	Të Ardhurat nga Subvencionet	310,000	349,894	36,894	12.9%
6	Totali i të Ardhurave	10,705,198	11,725,501	1,020,303	9.6%
7	Mbulimi i Kostove O&M me Subvencion	103.5%	110.9%	229,575	7.4%
8	Mbulimi i Kostove Totale me Subvencion	75%	85.8%		10.8%

Burimi: ERRU

Gjatë vitit 2024, të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i shoqërive UK arritën në 11,378 milion lekë, duke shënuar një rritje prej 983 milion lekësh krahasuar me vitin 2023.

Në nivel sektori, vetëm 5 nga 17 shoqëri UK që operojnë në të gjithë territorin kanë arritur të mbulojnë mbi 100% kostot O&M. Në tërësi, niveli i mbulimit të Kostove O&M është rritur, duke arritur në 107.6%, me të ardhurat nga aktiviteti (pa përfshirë subvencionet), çka tregon një përmirësim të qëndrueshëm financiar në raport me vitin e kaluar.

Të ardhurat nga aktiviteti kanë pësuar një rritje të lehtë me 9.5%, si rezultat i rritjes me rreth 29,340 lidhje të reja të Furnizimit me Ujë (FU) të cilat vijnë kryesisht nga vendet bregdetare SHRUK Vlorë, e cila e ka dhe vitin e parë të rajonalizimit, vijon SHUK Tiranë me rritje të lidhjeve të reja për FU, SHRUK Durrës dhe SHRUK Sarandë. Ndërkohë ka rritje me 24,041 të numrit të lidhjeve KUN që vijnë kryesisht nga SHUK Tiranë, SHRUK Durrës, SHRUK Elbasan, SHRUK Korçë dhe SHRUK Vlorë.

Megjithatë, në sektor mbeten ende 12 shoqëri UK që nuk mbulojnë kostot O&M dhe që janë subvencionuar nga qeveria qendrore.

Subvencionimi i Sektorit UK nga Qeveria Qendrore

Gjatë vitit 2024, qeveria qendrore, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizime (AKUK), ka shpërndarë 349 milion lekë në formë subvencionesh, çka përbën një rritje prej 36.9 milion lekësh krahasuar me vitin 2023.

Shpërndarja e subvencioneve është realizuar referuar udhëzimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr.2, datë 26.03.2024 *“Për Miratimin e Metodologjisë, për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e UK për vitin buxhetor 2024”*.

Referuar këtij udhëzimi, 16 shoqëri kanë përfituar nga fondi i subvencioneve, me përjashtim të UK Kamëz, e vetmja që nuk është përfshirë në këtë skemë. Nga totali i subvencioneve për vitin 2024 rezulton se 91.2% janë shpërndarë për kostot e energjisë elektrike dhe 8.8% janë shpërndarë për subvencionimin e shtresave në nevojë.

Sektori UK, edhe pse me të ardhurat e gjeneruara për vitin 2024 arrin të mbulojë kostot O&M në nivelin e 107.6%, vetëm 5 shoqëri UK nga të cilat 4 shoqëri SHRUK Korçë, Berat, Lezhë dhe Pogradec dhe 1 shoqëri UK ekzistuese (SHUK Tiranë) arrijnë

t'i mbulojnë ato mbi masën 100%. Ndërkohë 6 shoqëri që i mbulojnë kostot O&M në masën mbi 85% dhe 6 shoqëri të tjera mbulojnë kostot O&M më pak se 85%.

Ecuria e Reformës në Sektorin UK sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022 dhe Problematikat

Gjatë vitit 2024, procesi i riorganizimit të sektorit Ujësjellës Kanalizime sipas VKM Nr.302, datë 11.05.2022 të lancuar nga qeveria qendrore në maj të vitit 2022, e cila e agregon sektorin UK në 15 shoqëri rajonale nga 58 që operonin në sektor, hyri në fazën përfundimtare duke krijuar 14 shoqëri rajonale UK, përkatësisht: *Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Durrës, Fier, Lushnje, Sarandë, Elbasan, Korçë, Pogradec, Berat, Gjirokastrë, Vlorë*, 13 prej të cilave e kanë filluar ushtrimin e aktivitetit që në fillim të vitit 2023, ndërsa SHRUK Vlorë e ka filluar në fillim të vitit 2024. Mbetet akoma pa u krijuar shoqëria Rajonale *UK Tiranë*, e cila përfshin bashkitë: Tiranë, Kamëz, Vorë si rezultat i diskutimeve në vazhdim ndërmjet drejtuesve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi disa çështje teknike të veçanta të procesit. Kjo, duke pasur parasysh se procesi i reformës zbatohet mbi baza vullnetare dhe dakordësie ndërmjet palëve të përfshira.

ERRU ka luajtur një rol proaktiv në procesin e riorganizimit të sektorit, duke licencuar në kohë shoqëritë rajonale UK të krijuara. Deri në fund të vitit 2024 janë licencuar të gjitha shoqëritë e ngritura sipas modelit rajonal. Riorganizimi i sektorit është një proces kompleks me shumë sfida të një sërë problematikash të diktuar nga auditimi nga ekspertët e pavarur, si më poshtë:

- Mosrakordimi i detyrimeve të prapambetura kontraktuale të shoqërive të mëparshme ekzistuese me institucionet financiare kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat shoqëritë rajonale janë të detyruara t'i respektojnë;
- Mosrakordim i numrit të klientëve debitorë në sistem me ato të pasqyruara në bilancet financiare nga UK ekzistuese;
- Mungesa e stafeve të kualifikuara në pozicionet kyçe të shoqërive;
- Në përgjithësi u konstatua mungesë e dokumentacioneve të rregullta nga shoqëritë UK ekzistuese.

Unifikimi tarifar synohet në të gjithë zonën e re të shërbimit. Për disa nga shoqëritë rajonale tarifat janë të përafërta nga zona në zonë, prandaj unifikimi tarifar është i mundshëm. ERRU inkurajon procesin e unifikimit tarifar për nivel të njëjtë shërbimesh UK, sepse duke patur të dhënat e variablave tekniko-financiare të përbashkëta krijohet mundësia e një menaxhimi financiar dhe monitorimi relativisht më të kontrollueshëm dhe efikas, si dhe zbatohet parimi i barazisë të detyrimit financiar ndërmjet klientëve në zonën e shërbimit.

Megjithatë, në disa raste si SHRUK Durrës, SHRUK Korçë etj, unifikimi tarifar paraqet vështirësi për shkak të diferencave të mëdha tarifore të trashëguara nga shoqëritë e mëparshme. Në këto raste, aplikimi i menjëhershëm i tarifës unike do të sillte rritje të ndjeshme të faturave për një pjesë të konsumatorëve, gjë që mund të ndikojë negativisht në normën e arkëtimit për shkak të refuzimit të pagesave. Pra në vend që të përmirësonte gjendjen financiare të shoqërisë, do ta përkeqësonte atë. Në këtë rast, unifikimi tarifar duhet të realizohet në mënyrë graduale duke vlerësuar gjendjen rast pas rasti.

Licencimi i Shoqërive UK nga ERRU, Viti 2024

Deri në fund të vitit 2024, si rezultat i procesit të riorganizimit të sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve janë licencuar gjithsej 17 shoqëri UK që operojnë në të gjithë territorin.

Këto përfshijnë:

- 14 shoqëri rajonale UK, të krijuara në zbatim të reformës sipas VKM-së Nr. 302, datë 11.05.2022, përkatësisht:

Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Durrës, Fier, Lushnjë, Sarandë, Elbasan, Korçë, Pogradec, Berat, Gjirokastrë dhe Vlorë, dhe

- 3 shoqëri ekzistuese: SHUK Tiranë, SHUK Kamëz dhe SHUK Vorë, të cilat ende nuk janë bashkuar në një strukturë të vetme rajonale, por vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetin si njësi të ndara.

Gjatë vitit 2024, 8 shoqëri UK kanë aplikuar pranë ERRU për licencë të re ose rinovim, si më poshtë:

- 1 aplikim për licencim për herë të parë:
SHRUK Vlorë, e cila nisi aktivitetin në fillim të vitit 2024.
- 2 aplikime për rinovim licence për shkak të përfundimit të afatit:
SHUK Vorë dhe SHRUK Korçë.
- 4 aplikime për ndryshim të drejtuesit ligjor:
SHRUK Shkodër, Kukës, Durrës dhe SHUK Tiranë.
- 1 aplikim për ndryshim të drejtuesit teknik:
SHRUK Durrës

Në përfundim të vitit 2024, të gjitha shoqëritë UK që operojnë në sektor janë të pajisura me licencë aktive, duke plotësuar kështu kërkesat ligjore për ofrimin e shërbimit dhe duke garantuar vijimësinë e procesit të rregullimit dhe mbikëqyrjes së tyre nga ERRU.

Miratimi i Tarifave të Reja për Shoqëritë UK Viti 2024

Për vitin 2024, pranë ERRU-së janë paraqitur aplikime për tarifa të reja nga 6 shoqëri rajonale UK përkatësisht: Pogradec, Gjirokastrë, Shkodër, Korçë, Elbasan dhe Berat. Deri në mbyllje të vitit 2024, Komisioni Kombëtar Rregulator (KKRR) ka marrë vendim përfundimtar për miratimin e tarifave të reja për shoqëritë rajonale Pogradec, Gjirokastrë, Shkodër, si dhe për tre shoqëri të tjera rajonale Lezhë, Fier dhe Durrës, të cilat kishin aplikuar që në shtator të vitit 2023, duke u miratuar gjatë vitit 2024. Ndërkohë, ka vijuar për vitin pasardhës procesi i analizës tekniko-ekonomike për 3 shoqëri rajonale UK si: Korçë, Elbasan dhe Berat.

SHRUK Pogradec ka aplikuar me qëllim unifikimin e tarifave fikse në zonën e shërbimit dhe ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura. Me tarifat e reja të miratuara synohet mbulimi deri në 109% i kostove O&M, si dhe janë vendosur objektiva sfiduese për treguesit kryesorë të performancës.

SHRUK Shkodër ka aplikuar me qëllim unifikimin e tarifave fikse në zonën e shërbimit, si dhe për ndryshimin e tarifave volumetrike për shërbimin e FU dhe KUN për të gjithë klientët. Me tarifat e reja të miratuara synohet mbulimi 92.3% i kostove operative, me fokus përmirësimin e treguesve financiarë të shoqërisë.

SHRUK Gjirokastrë ka aplikuar me qëllim unifikimin e tarifave fikse dhe rishikimin e tarifave volumetrike për shërbimin e FU dhe KUN për të gjithë kategoritë e klientëve në zonën e shërbimit për një periudhë 3-vjeçare. Tarifat e reja të miratuara synojnë përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë me qëllim mbulimin 102% të kostove operative.

SHRUK Korçë ka aplikuar me qëllim unifikimin e tarifave fikse për të gjithë kategoritë e klientëve në zonën e shërbimit si dhe unifikimin e tarifave volumetrike për dy zonat e shërbimit për një periudhë 5-vjeçare. Tarifat e reja të propozuara synojnë përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë me qëllim mbulimin e Kostove Totale mbi 100%.

SHRUK Elbasan ka aplikuar me qëllim unifikimin e tarifave volumetrike dhe fikse për të gjithë kategoritë e klientëve në zonën e shërbimit për periudhën 3-vjeçare. Tarifat e reja të propozuara synojnë përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë me qëllim mbulimin kostove operative.

SHRUK Berat ka aplikuar me qëllim unifikimin e tarifës fikse në zonën e shërbimit, si dhe për ndryshimin e tarifave për shërbimin e FU dhe KUN për të gjithë klientët në zonën e shërbimit. Tarifat e reja të propozuara synojnë mbulimin e kostove operative mbi 100% me fokus përmirësimin e treguesve financiarë të shoqërisë.

Efienca e Energjisë Elektrike, Sfidë e sektorit UK

Kosto e energjisë elektrike edhe për vitin 2024 vijon të mbetet zëri i dytë pas kostove të punës me peshën më të madhe në kostot O&M të shoqërive UK me rreth 23% të totalit të tyre. Rishikimi i çmimit të energjisë elektrike gjatë vitit 2024, sipas Vendimit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.16, datë 06.02.2023, i cili përjashton shoqëritë UK nga blerja e energjisë në tregun e liberalizuar solli ndikim të menjëhershëm në uljen e kostove në vitin 2023 dhe mbajtjen në të njëjtin nivel në 2024 të energjisë, si dhe në të njëjtën kohë edhe energjia e konsumuar është në të njëjtat nivele me një vit më parë.

Për sa më sipër, si dhe faktit që sektori ka rritur orarin e furnizimit me ujë edhe gjatë vitit 2024, konstatohet një tendencë pozitive në menaxhimin e konsumit të energjisë elektrike në sektor.

Në fund të vitit 2024 janë 12 shoqëri UK që nuk arrijnë t'i mbulojnë kostot O&M si rrjedhojë e detyrimeve të prapambetura që shoqëritë kanë ndaj Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), të cilat vazhdojnë të rriten më tej. Detyrimet e shoqërive UK ndaj OSHEE në mbyllje të vitit 2024 rezultojnë rreth 15.8 miliardë lekë. ERRU konstaton se zgjidhja e kësaj problematike qëndron në rritjen e efiençës së përdorimit të energjisë elektrike dhe të përmirësimit në tërësi të TKP-ve të shoqërive UK, të cilat duhet të shoqërohen me planet e veprimit përkatëse, paralelisht me një plan të rritjes së tarifave dhe vazhdimin e subvencionimit të tyre të paktën për një periudhë tranzitore nga buxheti i shtetit.

Investimet në Sektorin UK

Investimet në sektorin UK për vitin 2024 nëpërmjet AKUK jepen në tabelën nr.3

Tabela nr. 3: Financimi i projekteve në vazhdim dhe të reja nga AKUK dhe burimet e huaja

Përshkrimi	Vlera e Planifikuar	Vlera e Financuar	Realizimi
	(në lekë)	(në lekë)	(në %)
Investimet nga AKUK	11,309,982,000	11,179,835,619	99
I. Objektet në vazhdim me financim të brendshëm	8,658,288,677	8,577,121,472	99
a) Objektet e reja të vitit 2024 me financim të brendshëm	2,026,589,910	1,988,725,384	98
b) Supervizim punimesh	137,885,489	127,087,887	92
TVSH	321,177,278	320,960,230	100
c) Kosto Lokale	166,040,646	165,940,646	100
II. Investimet e Huaja (Objekte në vazhdim)	1,659,539,000	1,473,559,055	89
TOTALI	12,969,521,000	12,653,394,674	98
	(eq.129.7 mln euro)*	(eq.126.5 mln euro)*	

Burimi: AKUK

Referuar tabelës përkatëse, rezulton se gjatë vitit 2024 në sektor janë financuar rreth 12.6 miliardë lekë nga 12.9 miliardë lekë të planifikuara ose 98% e fondit të planifikuar. Ky nivel realizimi vjen si rezultat i vonësve në ecurinë e investimeve për shkak të procedurave tenderuese, të cilat kanë pësuar shtyrje në kohë.

Nga totali i investimeve të planifikuara, **11.3 miliardë lekë (ose rreth 113.09 milionë Euro) janë nga Qeveria Shqiptare (rreth 87.2% të totalit) dhe 1.6 miliardë Lekë (ose rreth 16.6 milionë Euro) nga donatorët e huaj (rreth 12,8%).**

Sipas raportimeve nga AKUK, gjatë vitit 2024 janë përfunduar gjithsej 43 investime të planifikuara, me një vlerë totale prej 2.027 miliardë lekë, të cilat janë zbatuar në 18 bashki të ndryshme të vendit (shih Tabelën nr. 11).

Vlen të theksohet se në sektorin UK po vijon financimi i një numri të konsiderueshëm projektesh, kryesisht në zonat rurale. Për informacion të detajuar, në Aneksin 13 jepet tabela nr. 36, e cila përmban të dhëna të plota për çdo shoqëri UK të bashkive përkatëse ku përfshihen detaje të secilit projekt, autoritetin kontraktues, vlerën e financuar, si dhe periudhën e zbatimit të punimeve.

Renditja e Shoqërive UK Sipas Performancës (Benchmarking)

Për të vlerësuar arritjet në performancën e shoqërive UK në sektor gjatë vitit 2024 u përzgjedhën disa Tregues Kryesorë të Performancës, të cilët lidhen direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive, si dhe me cilësinë e shërbimit që ato i ofrojnë konsumatorëve, respektivisht: *Mbulimi i Kostove të O&M, Norma e Arkëtimit Korente, Uji Pa të Ardhura dhe Vazhdimësia (Orët) e Furnizimit me Ujë.*

Bazuar në mesataren e renditjes të katër treguesve të mësipërm, në klasifikimin e përgjithshëm, shoqëria me performancën më të mirë për të dytin vit radhazi edhe për vitin 2024 u rendit SHRUK Korçë, e ndjekur nga shoqëritë rajonale SHRUK Lezhë, SHRUK Berat dhe SHRUK Pogradec (shih Aneks 6, tabela nr. 29).

Konkluzione & Rekomandime

- Kostot e punës zënë aktualisht **55%** në kostot O&M të shoqërisë. Treguesi i efikasitetit të stafit në nivelin 4.43 punonjës për 1,000 lidhje UK, edhe pse i përmirësuar për vitin 2024 ka mjaft hapësirë për reduktimin e tij nga punonjësit e tepërt në numër dhe pozicione të pajustificuara. Shoqëritë rajonale UK duhet të rishikojnë organigramën dhe pozicionet e punës bazuar në një analizë të detajuar për të justifikuar numrin e punonjësve në përputhje me nevojat reale që kërkon zhvillimi i aktivitetit normal të saj, kërkesë e cila theksohet në veçanti nga ERRU kur shoqëritë UK aplikojnë për tarifa të reja.
- Saktësia dhe besueshmëria e të dhënave të raportuara pranë ERRU-së vazhdojnë të mbeten një sfidë gjatë hartimit të këtij raporti. Shoqëritë UK duhet të angazhohen në përdorimin dhe implementimin i proceseve të avancuara dixhitale të mbledhjes dhe vlerësimit të të dhënave për të minimizuar gabimet, dhe përmirësuar cilësinë e të dhënave në çdo fazë, nga matja deri te raportimi final pranë ERRU-së. Po ashtu, është e rëndësishme që ato të zbatojnë me rigorozitet procedurat dhe standardet e saktësisë të përcaktuara në Metodologjinë për Vendorsen e Tarifave të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë.
- Megjithëse ka një ulje të konsiderueshme nga viti 2023, nivelet e larta të ujit pa të ardhura prej **61.0%** për vitin 2024 mbeten problem serioz brenda sektorit, që kërcënon qëndrueshmërinë e shoqërive rajonale UK dhe atyre ekzistuese. Shoqëritë rajonale duhet të kenë në fokusin e tyre kryesor reduktimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme si dhe të humbjeve fizike. Nga ana tjetër, për një vlerësim real të gjendjes së humbjeve dhe të hartimit nga shoqëritë të bilanceve të ujit sa më të sakta, mbetet e një rëndësie të veçantë financimi dhe instalimi i matësve të mëdhenj të ujit në burim dhe ato individuale tek konsumatorët privatë dhe familjarë. Bilancet e ujit përcaktojnë gjendjen reale të kërkesës për ujë dhe shërbejnë si bazë për hartimin e planeve për reduktimin e humbjeve dhe mbrojtjen e burimeve nga mbikonsumi i pajustificuar. Si fillim,

shoqëritë mund të përqendrohen në trajtimin e humbjeve administrative (komerciale) që bëjnë të mundur rikuperimin e të ardhurave, të cilat për momentin nuk arkëtohen për shkak të konsumit të paligjshëm. Gjithashtu, sa herë që të tentohet rehabilitimi apo shtrimi i ri i rrjetit për reduktimin e humbjeve reale është e nevojshme të gjenden zgjidhje teknike me kosto të përballueshme

- Eficenca e energjisë duhet të jetë një prioritet kryesor për shoqëritë UK, pasi shpenzimet e energjisë elektrike mbeten ndër shpenzimet më të mëdha operative pas atyre të punës. Fokusi duhet të jetë kryesisht tek shoqëritë që përdorin sisteme të furnizimit me ujë me ngritje mekanike. Këto shoqëri duhet të shqyrtojnë mundësitë për përdorimin e burimeve alternative dhe të pavarura të energjisë elektrike të rinovueshme, ndërkohë që duhet të investojnë në pompa të reja me efikasitet të lartë energjie.
- Shoqëritë UK, sidomos ato rajonale, duhet kenë në fokus hartimin e Planeve 5-vjecare të Biznesit, si një instrument bazë i vizionit të menaxhimit të shoqërisë për përmirësimin e performancës financiare dhe të cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve. Ky dokument duhet të jetë i orientuar në drejtim të mbulimit të plotë të Kostove O&M, në mënyrë që të gjitha shoqëritë UK të arrijnë mbulimin e tyre mbi 100%.
- Shoqëritë rajonale duhet të fokusohen në përgatitjen e Planeve të Menaxhimit të Aseteve, të cilat janë instrumente kyçe për justifikimin e kërkesave dhe nevojave për financimin e investimeve fizike. Këto plane gjithashtu mundësojnë vlerësimin e efikasitetit të pritur të investimeve në operimin e shoqërisë dhe ndihmojnë në reduktimin e kostove.
- Shoqëritë: SHUK Tiranë, SHUK Kamëz dhe SHUK Vorë, të cilat nuk janë riorganizuar akoma si shoqëri rajonale rekomandohet ta përmbyllin sa më parë këtë proces si një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të performancës, efikasitetit operacionale dhe qëndrueshmërisë financiare të tyre.

Parathënie

Enti Rregullator i Ujit është institucion publik i pavarur, përgjegjës për rregullimin dhe monitorimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar. Hartimi i Raportit Vjetor të Performancës së Sektorit UK dhe të secilës shoqëri UK të licencuar përbën një detyrim ligjor dhe funksional të ERRU-së. Si institucion i pavarur, ERRU ka për detyrë që të jetë sa më objektiv dhe i paanshëm në vlerësimet e tij për sektorin e UK, ku një ndër elementët kyç është hartimi i Raportit Vjetor 2024 të Performancës të Sektorit UK.

Raporti i Performancës së shoqërive UK për vitin 2024, hartuar nga ERRU, shërben si një instrument informimi dhe transparence ndaj publikut dhe gjithë aktorëve përfshirës në sektorin e ujit. Në të jepet një pasqyrë e sektorit UK krahasuar me vitet paraardhëse (benchmarking) dhe tendenca e performancës së tij.

Përmes një analize të thelluar teknike dhe financiare, raporti formulon konkluzione dhe rekomandime specifike për përmirësimin e treguesve të performancës së shoqërive UK, si dhe u shërben vetë shoqërive për të krahasuar performancën e tyre me shoqëri të tjera me profil dhe madhësi të ngjashme.

Në janar 2025, si pjesë e raportit të tij vjetor ndaj Kuvendit, ERRU publikoi një raport paraprak të performancës së sektorit për vitin 2024. Ky raport ishte bazuar në të dhëna ekonomiko-financiare jo të certifikuar, por që ishin mjaft afër realitetit dhe mundësuan një analizë të besueshme të gjendjes dhe tendencave të performancës në sektor.

Raporti përfundimtar i performancës për vitin 2024, i cili botohet në korrik 2025, është hartuar mbi bazën e të dhënave të dorëzuara nga shoqëritë UK dhe të certifikuar nga ekspertë kontabël të autorizuar, si dhe të dhënave tekniko-operative të shoqërive UK, të grumbulluara dhe përpunuara nga sektori i monitorimit pranë ERRU.

Viti 2024 konsiderohet si viti i dytë i implementimit të reformës në sektorin e ujit në Shqipëri, ku deri në mbyllje të vitit janë krijuar 14 shoqëri rajonale UK nga 15 të parashikuara sipas reformës, ndërkohë që në sektor akoma operojnë 3 shoqëri UK ekzistuese si UK Tiranë, Kamëz dhe Vorë.

Duke qenë se aktualisht në sektor operojnë 14 shoqëri rajonale UK, analiza në këtë raport do të realizohet në ndarje sipas shoqërive rajonale UK (14 shoqëri) dhe tre shoqëri UK ekzistuese që ende nuk janë pjesë e strukturës së re (SHUK Tiranë, Kamëz dhe Vorë). Për efekt krahasimi me vitin paraardhës 2023, si dhe për të ndjekur ecurinë që nga viti 2022, të dhënat e raportuara nga shoqëritë UK gjatë vitit 2022 janë bashkuar sipas ndarjes së re rajonale, me përjashtim të tre shoqërive UK: Tiranë, Kamëz dhe Vorë të cilat mbeten të veçanta. Në këtë kontekst, Raporti i Performancës për vitin 2024 do trajtojë ecurinë e rezultateve të sektorit si një njësi të përbashkët, duke pasur parasysh se shumica e shoqërive tashmë funksionojnë si struktura të konsoliduara rajonale.

Vlen të theksohet se, saktësia e të dhënave të raportuara vijon të mbetet sfida për shoqëritë UK, pasi ato përbëjnë bazën kryesore për realizimin e një analize objektive të performancës së shoqërive. Gjithashtu, të dhënat e sakta janë të domosdoshme për vendosjen nga ERRU të objektivave të

matshëm dhe sfidues, që janë realist, por njëkohësisht nxitës për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së shoqërive UK në të ardhmen.

Gjendja e sektorit UK për vitin 2024, e paraqitur përmes Treguesve Kryesorë të Performancës krahasuar me vitin e mëparshëm, pasqyron një performancë të përmirësuar.

Mbulimet e Kostove Totale dhe ato O&M kanë një përmirësim të ndjeshëm, përkatësisht me 10.4% dhe 7.1%. Pjesa tjetër e treguesve të përmirësuar për vitin 2024 lidhen direkt me rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve dhe menaxhimit të mirë të shoqërive UK, si: rritja e Normës së Arkëtimit Korente, të cilat paraqiten përkatësisht në nivelin 84.6%; Niveli i Matjes në 87.9%; Eficenca e Stafit në 4.43 staf/1000 lidhje UK; Uji pa të ardhura në 61% dhe Mbulimi me Kanalizime në 57%.

Investimet në sektor gjatë vitit 2024 kanë qenë në nivele të kënaqshme. Në total janë financuar rreth 12,9 miliardë lekë ose 98% e fondit të planifikuar. Investimet kryesore kanë qenë të orientuara në përmbushje të objektivit të qeverisë për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë 24 orë/ditë. Këto investime kanë influencuar edhe në përmirësimin e disa treguesve të sektorit UK në përgjithësi, përkatësisht Kohëzgjatja e Orëve të Furnizimit me Ujë, rritja e Nivelit të Matjes dhe Mbulimi me Kanalizime.

Raporti vjetor i performancës trajton në një kapitull të veçantë ndikimin e skemës së subvencionimit të 5 m³ ujë në muaj për familjet përfituese të ndihmës ekonomike, si pjesë e angazhimeve për garantimin e aksesit universal dhe të përballueshëm në shërbimet bazë të Ujësjetllës Kanalizimeve. Skema e miratuar nga Qeveria Shqiptare në vitin 2024 mbulon tërësisht kostot mujore për furnizimin me ujë, kanalizimet dhe tarifën fikse, duke u aplikuar automatikisht në faturat e konsumatorëve në nevojë. Përveç garantimit të aksesit, kjo nismë synon të nxisë formalizimin e lidhjeve familjare, të reduktojë ujin pa të ardhura dhe të përmirësojë matjen dhe ndërgjegjësimin për përdorimin e ujit.

Në analizë është përfshirë ndikimi i kësaj skeme tek 17 shoqëri UK në vend (14 të rajonalizuara dhe 3 ekzistuese: Tiranë, Kamëz, Vorë), me fokus në ndikimin mbi të ardhurat, vëllimin e konsumit dhe përqindjen e familjeve përfituese. Një element i rëndësishëm është edhe mënyra e financimit: ndërsa shoqëritë që kanë lidhur kontratë performance me AKUK përfitojnë mbulim nga buxheti i shtetit, ato që nuk kanë një kontratë të tillë e përballojnë vetë koston, çka rrezikon qëndrueshmërinë e tyre financiare. Raporti nxjerr në pah efektet pozitive dhe sfidat që kjo skemë paraqet për performancën dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore në nivel kombëtar.

Si përfundim, përmirësimi i qëndrueshëm i performancës së sektorit të ujësjetllës-kanalizimeve kërkon një angazhim të koordinuar dhe gjithëpërfshirës nga të gjithë aktorët institucionalë: shoqëritë UK si zbatues të shërbimit; qeveria qendrore si aksionere dhe financuese kryesore; ERRU dhe AKUK si autoritete rregullatore dhe mbështetëse teknike, si dhe pushteti vendor në rolin e garantuesit të shërbimeve në nivel lokal. Vetëm përmes bashkërendimit të këtyre roleve është e mundur rritja e efikasitetit operacional dhe garantimi i shërbimeve të qëndrueshme, të përballueshme dhe me cilësi për të gjithë qytetarët.

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

1 Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendenca

1.1 Analiza e Treguesve Kryesorë të Performancës për Sektorin

Performanca e përgjithshme e sektorit UK për vitin 2024 jepet përmes 12 treguesve të performancës të marrë në analizë nga ERRU. Ato paraqiten në tabelën nr. 4 në formë të përmbledhur dhe rishikuar sipas metodologjisë së tarifave. Në tabelë jepet tendenca e treguesve të performancës krahasuar me vitin 2023 si dhe objektivat e "Performancës së Mirë" të përcaktuara nga ERRU.

Tabela nr. 4: Treguesit e Performancës së Sektorit të UK për vitet 2023, 2024

Nr.	Treguesit Kryesorë të Performancës	2023	2024	Tendenca	Performancë e Mirë (ERRU)
1	Uji Pa të Ardhura (%)	64.7	61.0	↗	30
2	Mbulimi i Kostove O&M (%)	100.5	107.6	↗	100
3	Mbulimi i Kostos Totale (%)	72.8	83.2	↗	80
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	103.5	102.6	↘	82
5	Norma e Arkëtimit Korente(%)	83.9	84.6	↗	82
6	Niveli i Matjes (%)	86.5	87.9	↗	85
7	Efienca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	4.56	4.43	↗	4/6/10
8	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	16.3	17.44	↗	18
9	Mbulimi me Kanalizime KUN (%)	54.8	57.0	↗	75
10	Mbulimi me Furnizim me Ujë (%)	75.3	77.8	↗	n/a
11	Efienca e Energjisë FU (kwh/m ³)*	0.63	0.66	↘	n/a
12	Ankesat e Klientëve (%)*	4.23	4.64	↗	n/a

Burimi: ERRU

Referuar tabelës së mësipërme, vërehet se reforma në sektorin UK gjatë vitit 2024 ka dhënë impaktin e saj në drejtim të përmirësimit pothuajse në të gjithë treguesit dhe në veçanti, të situatës financiare të sektorit krahasuar me vitet paraardhës 2022-2023, i cili ka qenë një ndër objektivat kryesorë të reformës.

Mbulimet e Kostove O&M dhe ato Totale kanë një përmirësim të ndjeshëm përkatësisht me 7.12% dhe 10.41%, Normat e Arkëtimit Korente me 0.7%.

Gjithashtu, të përmirësuar paraqiten edhe një pjesë e treguesve të tjerë të performancës, si **Niveli i Matjes, Uji pa të Ardhura, Efienca e Stafit, Mbulimi me Kanalizime dhe Ujë**, të cilët gjithashtu kanë patur ndikimin e tyre në përmirësimin e situatës financiare të shoqërive dhe në cilësinë e ofrimit të shërbimit, ndërkohë që treguesi **Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë** është rritur në nivelin e 17.44 orë/ditë, nga 16.3 që ishte në vitin 2023.

Përmirësimi i Kostove të Operim & Mirëmbajtjes vjen kryesisht si rezultat i uljes së pothuajse të gjitha kostove të O&M me përjashtim të kostove të punës të cilat kanë pësuar një rritje me 6% dhe kostos së riparim mirëmbajtjes, e cila ka pësuar rritje me 8%. Ndikimin kryesor e japin reduktimi i kostove të tjera operationale me 23% ose -103.5 milion lekë, materialeve kimikate me -8% ose -22.5 milion lekë, duke vijuar më tej me kostot e karburantit me -5% ose -11.5 milion lekë, si dhe kostot e shërbimeve të nënkontraktuara me -2% ose -11.3 milion lekë, kostot e tjera me -7% ose -12.4 milion lekë.

Gjithashtu, edhe Kostot Totale kanë rënie me -4%, e cila vjen nga ulja e kostove të interesave dhe principaleve me -49% ose -312.7 milion lekë, duke vijuar me rënien e kostos së amortizimit me -9 ose -229.3 milion lekë.

Pjesa tjetër e treguesve të përmirësuar për vitin 2024 lidhen direkt me rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve dhe menaxhimit të mirë të shoqërive UK, si: rritja e Normës së Arkëtimit Korente, e cila paraqitet përkatësisht në nivelin 83.2%; Niveli i Matjes në 87.9%; Eficenca e Stafit në 4.43 staf/1000 lidhje UK; dhe Mbulimi me Kanalizime në 57%.

Treguesi “Eficenca e Stafit” në nivelin 4.43 punonjës për 1000 lidhje UK, megjithëse paraqitet i përmirësuar për vitin 2024 pasi numri i punonjësve është në të njëjtin nivel si vitin e kaluar 2023, ndërkohë që numri i lidhjeve është rritur me rreth 29,340 lidhje Ujë dhe me rreth 24,041 lidhje KUN, përsëri konstatohet rritje e kostove të punës me 6%, të cilat zënë 55% të kostove operacionale të shoqërive UK.

ERRU, në përputhje me kërkesat bashkëkohore të qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK dhe të rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve i ka dhënë një rëndësi të veçantë përcaktimit dhe vlerësimit të treguesve kryesorë të performancës së sektorit.

Më poshtë, analizohen në detaje për të gjithë sektorin secili nga Treguesit Kryesor të Performancës.

1.1.1 Uji Pa të Ardhura (UPA)

Uji pa të ardhura është një nga indikatorët kryesorë të performancës së sektorit UK dhe një nga pengesat kryesore për përmirësimin e performancës teknike dhe financiare të shoqërive. Niveli i Ujit Pa të Ardhura për vitin 2024 rezultoi në nivelin 61%, nga 64.7% që ishte në vitin 2023 duke reflektuar një trend zbritës/përmirësimi të këtij treguesi. Nga 17 shoqëri UK që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, gjatë vitit 2024, 1 shoqëri performoi nën kufirin 30% të performancës së mirë për këtë tregues, 5 prej tyre performuan brenda kufirit 30-50% dhe 11 shoqëritë e tjera mbi kufirin 50% të performancës së dobët. Treguesi UPA lidhet ngushtësisht me cilësinë e shërbimeve që shoqëritë i ofrojnë konsumatorëve, si edhe me qëndrueshmërinë financiare të tyre. Vetëm dy prej shoqërive jo rajonale raportojnë një përkeqësim të këtij treguesi gjatë 2024.

“Uji i prodhuar” që hyn në sistemin e shpërndarjes raportohet në sasinë 302,816,000 m³, nga të cilat 60.3 % rezultoi i matur dhe 39.7% i vlerësuar. Për vitin 2024, vihet re ulja e sasisë së ujit të prodhuar me 14.6 milion m³ krahasuar me vitin 2023, ndërsa faturimi total rezulton 118 milion m³ me një tendencë përmirësimi prej 6 milion m³ krahasuar me 2023, ndaj dhe treguesi i UPA rezulton me një zbritje prej me 3.7% në shkallë kombëtare.

Megjithë përmirësimin që vërehet, matja e ujit të prodhuar, ende qëndron në nivele jo të kënaqshme, pasi shumë shoqëri nuk kanë të instaluar matësa në pikat kyçe të rrjetit. Ndaj dhe fokusi kryesor i çdo shoqërie rajonale duhet të jetë pajisja e të gjitha burimeve të shfrytëzueshme me aparate ujëmatës, pasi saktësia në matje e sasisë së ujit të prodhuar është përcaktues për të arritur një nivel të UPA sa më të besueshme dhe sa më afër realitetit për çdo sistem furnizimi. Kështu, megjithëse disa shoqëri e kanë ulur prodhimin e ujit, vihet re dhe ulje e nivelit të faturimit krahasuar me 2023 si tek SHUK Tiranë dhe SHRUK Lezhë.

Viti 2024, si viti i dytë i një sektori të rajonalizuar, konfirmoi se një mirëmenaxhim, seriozitet dhe përgjegjshmëri në ofrimin e shërbimit për konsumatorët, por dhe në raportimet e treguesve të shoqërive, reflekton një pasqyrim më real dhe të saktë të performancës së sektorit UK. Gjatë vitit 2024 problematikat dhe vështirësitë e hasura gjatë hartimit të Bilancit të Ujit, kjo reflektuar dhe në nivelin e ulët të matjes për disa nga shoqëritë UK lidhur me vlerësimin e volumeve të prodhuara dhe faturuara, tregojnë arsyet e luhatjeve të herëpashershme të treguesit UPA në disa prej shoqërive UK.

Monitorimi i efikasitetit të ujit dhe sidomos ujit pa të ardhura, është një tregues që pasqyron një qasje të përgjithshme ndaj humbjeve të ujit (përfshirë faktorët teknikë, organizativë dhe ekonomikë). Analiza e sasisë dhe shpërndarjes së ujit të disponueshëm për konsum të njeriut është mjaft e rëndësishme për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt për popullatën, duke shmangur krizën e mundshme të ujit dhe është Bilanci i ujit që e sintetizon më së miri këtë analizë. Referuar këtij koncepti dhe në përmbushje të detyrave të saj, ERRU po harton dhe për vitin 2024 Raportin e Bilancit të Ujit për 14 shoqëritë tashmë të rajonalizuara dhe për tre shoqëritë me statusin e mëparshëm.

Analiza e humbjeve të ujit në sistemin e ujësjellësit ka të bëjë me sasinë fizike të ujit që humbet nga rrjeti dhe nuk arrin tek konsumatori, duke na shërbyer për të evidentuar arsyet që pengojnë përmirësimin e treguesit. Problematike vazhdojnë të jenë “Lidhjet e shumta të paligjshme” në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes, apo pasaktësitë në matje. Duke marrë në konsideratë tashmë edhe faktin që juridiksioni i shoqërive është rajonal (duke përfshirë dhe zonat jo urbane), problem është niveli i ulët i matjes në variablat “Ujë i Prodhuar” dhe “Faturimi Total”. Kështu, gati vetëm 40% e ujit të prodhuar faturohet, sistemet e furnizimit janë të vjetra deri në 50-60 vjeçare, sistemi i pompave jo efektiv si dhe “kualifikimi jo i duhur i stafit teknik” lidhur me vlerësimin real dhe evidentimin e të gjitha llojeve të humbjeve etj.

Mbi bazën e kësaj analize, ERRU orienton dhe sugjeron masat apo hapat që duhet të ndërmerren çdo shoqëri për një menaxhim sa më efektiv të këtij aseti siç është uji, të cilat do të çojnë në përmirësimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë të shoqërive.

1.1.2 Mbulimi i Kostos Direkte të O&M dhe i Kostos Totale

Treguesit financiarë të performancës si Mbulimi i Kostove O&M dhe Totale kanë një rëndësi themelore për qëndrueshmërinë financiare në sektor. Performanca në sektor për vitin 2024 lidhur me këta tregues paraqitet e përmirësuar, përkatësisht me 7.1% për treguesin e Mbulimit të Kostove O&M dhe me 10.4% për treguesin e Mbulimit të Kostove Totale krahasuar me vitin 2023. Kostot e Operim & Mirëmbajtjes kanë një rritje me rreth 229.6 milion lekë ose 2.2%, që vjen kryesisht nga rritja e totalit të kostove të punës, kostos së qerasë, kostos së riparim mirëmbajtjes, kostot e blerjes së ujit. Në të njëjtën kohë kemi rënie të kostove të tjera operationale. Ndërsa Kostot Totale kanë një rënie me 603.36 milion lekë ose -4 %, që vjen kryesisht nga rënia e kostove totale të interesave dhe principal me -49%, për shkak të rënies shumë të lartë të kostos totale të interesave dhe principal nga shoqëria SHRUK Durrës me rreth -211.7 milion lekë (95%) .

Ndërkohë kostot e Operim & Mirëmbajtjes janë rritur me 2%, e cila është një rritje shumë e vogël, por të ardhurat e aktivitetit janë rritur me vetëm 983.4 milion lekë ose 9% çka ka ndikuar drejtpërsëdrejti në rritjen e niveleve të treguesve të mbulimit të kostove.

Tabela nr. 5 jep të detajuara kostot e O&M dhe Kostot Totale për vitet 2023 dhe 2024 dhe diferencat për secilën prej tyre në vlerë absolute në lekë dhe në përqindje.

Tabela nr.5: Zërat e Kostove të O&M dhe Kostove Totale për vitet 2023 e 2024 (në 000 lekë)

Nr	Kostot e Shërbimit UK	Viti 2023		Viti 2024		Diferenca 2024-2023 lekë	Rritja/Rënia 2024/2023 në %
		Lekë	Lekë	Ndaj Kostove O&M (%)	Ndaj Kostove Totale (%)		
1	Kosto e punës	5,540,678	5,863,945	55%	43%	323,267	6%
2	Kosto e energjisë së konsumuar	2,437,001	2,452,581	23%	18%	15,580	1%
3	Kosto e riparim/mirëmbajtjes	428,846	462,606	4%	3%	33,760	8%
4	Kosto e shërbimeve të kontraktuara	604,248	592,925	6%	4%	-11,323	-2%
5	Kosto e materialeve kimikate	267,527	244,973	2%	2%	-22,553	-8%
6	Kosto të tjera	1,067,917	958,761	9%	7%	-109,156	-10%
	Kostot Operim & Mirëmbajtjes	10,346,217	10,575,792	100%	77%	229,575	2%
7	Kostot e Amortizimit	2,658,990	2,429,658		18%	-229,332	-9%
8	Kosto financiare, taksa tatime	1,267,225	663,618		5%	-603,606	-48%
	Kostot Kapitale	3,926,215	3,093,276		23%	-832,939	-21%
	Kostot Totale	14,272,432	13,669,068		100%	-603,364	-4%

Kostot e Operim dhe Mirëmbajtjes për vitin 2024 janë rritur me 2% ndërkohë në vitin 2023 kanë rënë me (-9%).

Konstatohet se, për vitin 2024 rritja e Kostove O&M të sektorit UK vjen kryesisht nga rritja e kostove të punës, kostos së energjisë së konsumuar, kostos së riparim mirëmbajtjes, por në të njëjtën kohë kemi rënie të kostove të tjera operacionale, kostove për materiale kimikate, kosto e shërbime të kontraktuara. Ndikimin më të madh e jep shoqëria SHUK Tiranë, kostot e të cilës në total kanë rritje me rreth 284.8 milion lekë. Kjo vjen kryesisht nga rritja e kostos së punës, e cila ka rritje me 315.6 milion lekë. Më pas, ndikim kanë dhënë shoqëritë e tjera rajonale si: SHRUK Sarandë me 88.4 milion lekë, SHRUK Fier me 82.8 milion lekë, SHRUK Vlorë me 73.6 milion lekë dhe SHUK Vorë me 41 milion lekë.

Në vitin 2024, kostot operacionale të shërbimit UK shënuan një rritje modeste prej 2% krahasuar me vitin 2023. Kjo rritje vjen kryesisht si rezultat i shtimit të kostos së punës (+6%) dhe të riparim/mirëmbajtjes (+8%), ndërsa një ndikim më të vogël pati edhe kostoja e energjisë së konsumuar (+1%). Nga ana tjetër, janë evidentuar ulje në disa zëra, si: kosto të tjera (-10%), materiale kimike (-8%) dhe shërbime të kontraktuara (-2%), të cilat kanë kontribuar në zbutjen e efektit të përgjithshëm të rritjes.

Kjo situatë pasqyron një menaxhim më të efektshëm të burimeve, me fokus në optimizimin e shpenzimeve, pavarësisht presioneve në disa zëra kyç të operimit.

Në detaje, analiza për secilin zë të kostos të paraqitur në tabelën nr. 5 të mësipërme jepet si më poshtë:

Kosto e Punës Sektori për vitin 2024 e ka zhvilluar aktivitetin me një staf prej 7,616 punonjësish (punonjësit e tyre pa përfshirë nënkontraktorët) nga 7,602 punonjës që janë raportuar në vitin 2023, pra kemi rritje të lehtë në nivel kombëtar me +14 punonjës. Rritja totale prej vetëm 14 punonjës në nivel kombëtar(+0.18%) tregon një trend të stabilizuar të punësimit në sektor.

Rritja më e madhe e punësimit është te SHRUK Vlorë, +91 punonjës. Ky ndryshim lidhet me zgjerim të shërbimit dhe ristrukturim të stafit pas kalimit në shoqërinë rajonale. Rritje të qëndrueshme kanë gjithashtu, SHUK Kamëz dhe SHUK Vorë. Ndërsa shoqëritë SHRUK Shkodër, SHRUK Elbasan dhe SHRUK Berat paraqesin uljen më të madhe relative. Këto ulje shpjegohen me masa për racionalizim të burimeve njerëzore apo implementimin e teknologjive që reduktojnë nevojën për punë manuale. UK-të me rritje të theksuar si: SHRUK Vlorë, SHUK Tiranë dhe SHRUK Dibër janë në proces konsolidimi rajonal siç parashikon reforma. Shoqëritë me ulje kanë ndërmarrë masa efikasiteti në burimet njerëzore.

Megjithëse numri i punonjësve është rritur me 14 punonjës, kjo nuk ka ndikuar në rritjen e kostove të punës, të cilat për vitin 2024 paraqiten të rritura me rreth 323.3 milion lekë si rezultat i ndryshimeve të pagës bazë minimale mujore në shkallë vendi, rritja e pagave për gjithë punonjësit e administratës. Pritet që me riorganizimin e sektorit numri i punonjësve të reduktohet më tej sidomos stafi administrativ.

Shoqëritë që kanë ulur ndjeshëm numrin e punonjësve janë shoqëritë rajonale SHRUK Elbasan me -37 punonjës, SHRUK Shkodër me -22 punonjës, SHRUK Berat me -18 punonjës dhe SHRUK Lezhë -17 punonjës, të cilët kanë rishikuar strukturën e punonjësve dhe kanë reduktuar stafet përkatëse.

Menaxhimi i burimeve njerëzore duhet të jetë prioritet për stafet menaxhuese të shoqërive rajonale UK pasi kostot e punës përbejnë peshën më të madhe në totalin e kostove O&M të sektorit, e cila për vitin 2024 zë 55% të tyre. Numri i stafit të punësuar duhet të jetë në përputhje me nevojat reale që kërkon zhvillimi i aktivitetit normal të shoqërisë.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar të analizohen hollësisht numri i punonjësve dhe pozicionet në organigramë, përshkrimet e punës dhe ngarkesa reale për çdo pozicion pune, veçanërisht në rastet kur shoqëritë aplikojnë për nivel të ri tarifor. Por sektori në tërësi vazhdon të jetë i mbingarkuar me staf të pajustificuar.

Kosto e Energjisë Elektrike Për vitin 2024, kostot e energjisë për shoqëritë raportohen rreth 15.6 milion lekë më të larta se viti 2023, me një rritje prej 1% dhe zënë rreth 23% në totalin e kostove të O&M.

Edhe pse në përqindje kosto e energjisë elektrike nuk është në nivele të larta, ka ndikim të rëndësishëm në kostot O&M, pasi zënë 23% të tyre. Arsyeja e kësaj rritje vjen kryesisht nga SHRUK Vlorë, për të cilën viti 2024 është viti i parë i rajonalizimit dhe ka rritjen më të lartë ndërmjet shoqërive, si në koston e energjisë ashtu dhe në konsumin në kw.

Ndikimin kryesor në rritjen e kostove të energjisë e ka dhënë SHRUK Vlorë, i cili ka rritur kostot e energjisë me 43.8 milion lekë (18.5%) për arsyet se shoqëria rajonale është krijuar në fund të vitit 2023 dhe viti 2024 është viti i parë i agregimit. SHRUK Vlorë ka bërë rivlerësim të tre njësive dhe ka një rritje të konsumit të energjisë rreth 5.5 milion kw. Rritje të kostove të energjisë elektrike kanë pasur edhe

SHRUK Fier (19.9 milion lekë) dhe SHRUK Sarandë (19 milion lekë), SHRUK Korçë (10.6 milion lekë) dhe SHRUK Pogradec (9.5 milion lekë).

Duke qenë se 70% e shoqërive nuk arrijnë ti mbulojnë kostot operative me të ardhurat e faturuara, detyrimet e prapambetura që shoqëritë kanë ndaj OSHEE-së akumulohen çdo vit duke shtuar llogaritë e pagueshme edhe pse qeveria qendrore vazhdon të subvencionojë shoqëritë. Nga 17 shoqëri (14 shoqëri rajonale dhe 3 shoqëri UK ekzistuese) që operojnë në sektor gjatë vitit 2024, vetëm 5 shoqëri i mbulojnë Kostot O&M, pjesa e mbetur prej 12 shoqërive nuk arrijnë t'i mbulojnë këto kosto.

Kostot e energjisë elektrike do të mbeten problematike sa kohë që shoqëritë nuk kanë kapacitete financiare për t'i mbuluar të gjitha kostot operative, prandaj përballimi i kësaj situate nga shoqëritë rajonale UK duhet të trajtohet për zgjidhje përfundimtare nga qeveria qendrore.

Kostot e Riparimeve Kostot e riparimeve dhe mirëmbajtjes gjatë vitit 2024, krahasuar me ato të vitit 2023 kanë rezultuar gjithashtu me rritje 8% ose 33.7 milion lekë.

Rritja e kostove për këtë shërbim ka qenë e dukshme, sidomos për shoqërinë SHUK Kamëz me 25.8 milion lekë, SHRUK Sarandë me 22.5 milion lekë, SHRUK Elbasan me 12.8 milion lekë dhe SHUK Tiranë me 10.7 milion lekë.

Rritja e këtyre kostove vjen si rezultat i rritjes së numrit të defekteve në rrjetin e transmetimit me rreth 21%, por ndikim kryesor në kostot e riparimeve vjen nga defektet në rrjetin shpërndarës e cila për vitin 2024 është në rritje me 24%. Gjithashtu janë kryer edhe investime kryesisht nga palët e treta dhe shoqëritë nuk kanë pasur riparime kryesore gjatë vitit 2024.

Kosto e Shërbimeve të Nënkontraktuara për vitin 2024 gjithashtu kanë pësuar rënie për sektorin UK dhe janë reduktuar me 11.3 milion lekë (2%) krahasuar me 2023. Ndikimin kryesor e ka dhënë SHRUK Vlorë me një ulje prej rreth 21 milion lekë, SHRUK Durrës me një ulje rreth 19.7 milion lekë, SHRUK Lushnje me një ulje rreth 15.3 milion lekë dhe SHRUK Shkodër me një ulje rreth 6 milion lekë .

Në këto kosto përfshihen shpenzime të tjera për shërbimet e kontraktuara që kryhen nga të tretët, por pjesën më të madhe të këtyre kostove e zënë ato për shërbimin e rojeve nga nënkontraktorët. Shoqëritë janë të detyruara të mbajnë përgjegjësi për sigurinë e komponentëve të furnizimit me ujë, si depo, stacione pompimi, puse etj., të cilët konsiderohen si objekte me rëndësi strategjike për ruajtjen e sigurisë së shëndetit të popullsisë. Kështu, shërbimi i rojeve përveçse me punonjësit e tyre kryhet dhe me nënkontraktorë.

Shoqëritë Rajonale UK duhet të investojnë në monitorimin e objekteve nëpërmjet sistemeve të sigurimit me kamera, të cilat sjellin reduktimin e këtyre kostove. Ky investim duhet të jetë një nga prioritetet e investimeve në sektor.

Kosto e Materialeve Kimikate krahasuar me vitin 2023 ka një rënie me 8% ose me vlerë 22.6 milion lekë. Ndikimin kryesor në këtë rënie të kostove të materialeve kimikate e ka dhënë SHUK Tiranë me rënie rreth 26.6 milion lekë, e cila zë 64% në totalin e këtyre kostove për sektorin, pas shoqërisë SHUK Tiranë reduktim në përdorimin e këtyre materialeve kimikate ka pasur SHRUK Shkodër, SHRUK Vlorë dhe SHRUK Berat.

Kosto të Tjera janë me rënie rreth 109 milion lekë (10%) krahasuar me kostot e vitit 2023. Rënie të konsiderueshme ka shënuar SHRUK Durrës me 58.8 milion lekë, UK Kamëz 28.6 milion lekë dhe SHRUK Gjirokastrë 28.2 milion lekë.

Në këto kosto shoqëritë raportojnë detyrimet ndaj ERRU, SHUKALB-it, pagesat e këshillave të Administrimit, tarifatat ndaj Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore për përdorimin e burimeve ujore, ekspertë kontabël, shpenzime për konsulencë si dhe të tjera kosto që nuk kategorizohen në zërat e tjerë sintetikë të kostove.

Kostot Kapitale përfshijnë kostot e amortizimit dhe të kredive. Këto kosto zënë një peshë të konsiderueshme me rreth 23% të totalit të kostove të sektorit.

Kostot e amortizimit për vitin 2024 rezultojnë 229.3 milion lekë më të reduktuara se viti 2023, e cila kryesisht ka ardhur nga rënia e kostove të amortizimit për SHRUK Shkodër me 106 milion lekë. Më pas ndikim kanë dhënë edhe shoqëritë SHRUK Korçë me 78 milion lekë dhe SHRUK Durrës me 67.5 milion lekë. Kjo rënie e kostove të amortizimit vjen për shkak të rajonalizimit. Gjatë bashkimit të shoqërive UK ekzistuese në shoqërinë rajonale nga ana ekspertëve kontabël janë kryer rillogaritje të normës së amortizimit për asetet e secilës njësi.

Kostot financiare, ku përfshihen kostot e interesave, kostot e taksave dhe tatimeve, provizione dhe zëri kosto financiare kanë rënë me 603.6 milion lekë, ku kryesisht ka ndikuar rënia e kostove të interesave me 313 milion lekë dhe rënia e kostove të provizioneve me 256 milion lekë.

Kostot Totale të aktivitetit të shoqërisë përbëhen nga Kostot O&M dhe Kostot Kapitale. Theksohet se sektori UK vazhdon të jetë larg mbulimit 100% të Kostove Totale. Aktualisht janë 2 shoqëri, SHUK Tiranë dhe Shoqëria Rajonale SHRUK Korçë, që arrijnë që t'i mbulojnë këto kosto.

Me të ardhurat e gjeneruara mbulohen vetëm 83.2% të shpenzimeve totale. Ritmi i rënies së kostove totale me 4% për vitin 2024 tregon për një qëndrueshmëri të nivelit të kostove.

1.1.3 Norma e Arkëtimit

Norma e Arkëtimit është një nga treguesit financiarë më të rëndësishëm të performancës së shoqërive që lidhet me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë dhe me aftësinë paguese të saj. Raporti ka konsideruar dy tregues në lidhje me Normën e Arkëtimit, përkatësisht Normën e Arkëtimit të Përgjithshme (NAP) dhe Normën e Arkëtimit Korente (NAK). NAP në përllogaritjen e saj, përfshin të gjitha arkëtimet e kryera gjatë gjithë vitit nga shoqëria (edhe debitë e vjetra), ndërsa NAK i përjashton këto të fundit, pra llogarit vetëm arkëtimet e kryera lidhur me të ardhurat e faturuara brenda vitit ushtrimor.

Aneksi 2, tabela nr. 25, jep për secilën shoqëri NAP dhe NAK të vitit 2024 dhe krahasuar ato me vitin 2023.

Norma e Arkëtimit Korente për sektorin UK për vitin 2024 raportohet në nivelin 84.6 % nga 83.9% në vitin 2023, pra me një rritje prej 0.7% krahasuar me vitin 2023. Ky tregues mund të mos jetë real pasi shumë shoqëri në kontabilizimin e arkëtimit korent përjashtojnë arkëtimet e vonuara në kohë, por që kryhen brenda vitit dhe i raportojnë si arkëtim i debive. NAP është një tregues më real pasi e amortizon “gabimin” që konstatohet në NAK.

Për vitin 2024, nga 17 shoqëri të sektorit, ku 14 janë shoqëri rajonale UK dhe 3 janë shoqëri UK, 8 prej tyre janë me performancë të mirë në total kanë performuar pozitivisht sa i përket normës korente të arkëtimit, krahasuar me vitin 2023. Shoqëritë me normë më të lartë arëkëtimi korente (mbi 82%) janë shoqëritë: SHRUK Lezhë, SHRUK Lushnje, SHUK Tiranë, SHRUK Berat, SHRUK Durrës, SHRUK Korçë, SHUK Vorë dhe SHRUK Gjirokastrë.

Një nga shoqëritë që operon me normë arkëtimi korente të ulët (nën 60%) është SHRUK Sarandë.

Norma Arkëtimit e Përgjithshme për vitin 2024 raportohet e ulur me 0.85% dhe paraqitet në nivelin 102.6% nga 103.5% që ka qënë në vitin 2023. Gjatë vitit 2024 shoqëritë kanë arkëtuar rreth 2.051 miliardë lekë debi të prapambetura, pra rreth 21.1 milion lekë më shumë se viti paraardhës. Shoqëritë janë munduar ta përmirësojnë këtë tregues ku në vijim të reformës në disa shoqëri janë shtuar kontrollet me anë të task forcës e cila ka marrë masa deri në ndërprerjen e furnizimit me ujë të konsumatorëve debitorë duke i detyruar kështu që të bëjnë marrëveshjet midis shoqërisë dhe konsumatorit, sipas së cilës arkëtohen edhe debitë e vjetra krahas faturave korente. Përmirësimi i këtij treguesi lidhet me monitorimin e rregullt të arkëtimeve të klientëve, moslejimin e krijimit të borxhit të keq, marrjen e masave për klientët që nuk paguajnë, si dhe me shtimin e qëndrave dhe mënyrave të pagesës së faturave.

1.1.4 Niveli i Matjes

Raporti i lidhjeve me matës ndaj numrit total të lidhjeve i shprehur në përqindje jep treguesin e Nivelit të Matjes. Ky tregues analizon vetëm lidhjet me matësa të kategorive të konsumatorëve individuale dhe nuk pasqyron nivelin e matjes në sistemin e furnizimit me ujë. Për vitin 2024, ky tregues është rritur 1.4 % krahasuar me vitin paraardhës duke e çuar këtë tregues në nivelin 87.9 %, ndërsa krahasuar me vitin 2023 ky tregues ka një rritje prej 5.1 %.

Treguesi “Niveli i Matjes” është një ndër treguesit që ka patur trend në përmirësim në vite. Gjatë vitit 2024, shoqëritë UK kanë raportuar instalimin e 38,857 ujëmatësave më shumë se viti paraardhës, duke qëndruar në nivelet e performancës së mirë mbi 85 %. Numri i lidhjeve me matës në rang sektori ka shkuar 861,637 lidhje nga 980,514 lidhje UK që janë në total në të gjithë shoqëritë. Po ta krahasojmë me vitin 2023 numri i lidhjeve me matës është rritur me 78,719 lidhje. Sektori ende vazhdon të faturojë aforfe 4,154 klientë privat dhe institucione, ndërkohë që procesi i instalimit të matësve, në kategorinë klientë jo familjarë të financuara nga vetë klientët duhet të kishte përfunduar në zbatim të VKM-së nr. 236, datë 10.5.1993 dhe VKM-së nr. 96, datë 21.2.2007.

Megjithëse ky tregues ka rritje, mbetet ende shumë punë për të arritur në 100 % treguesin e nivelit të matjes, e cila kërkon në mënyrë të menjëherëshme pajisjen e të gjithë konsumatorëve me matësa. Ky tregues është shumë i rëndësishëm pasi ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e shërbimit për konsumatorët si dhe në rezultatet e disa treguesve të tjerë duke ndikuar në përmirësimin e tyre.

Konsumatorët nuk duhet të paguajnë për sasi uji pa matje (aforfe 150 litra/ditë, banor) sepse mbart në padrejtësi dhe abuzim, kjo për faktin se shumica e konsumatorëve familjarë konsumojnë nën këtë normë të presupozuar, ndërkohë që një pjesë e tyre konsumojnë shumë më tepër për ujitje (shtëpi private dhe zona rurale) duke cënuar cilësinë e shërbimit në zonat e mbuluara me shërbim. Pajisja

100% me ujëmatës në të gjithë komponentët kyç të sistemeve të furnizimit me ujë vazhdon të jetë një nga objektivat kryesorë që ERRU vendos për shoqëritë, por ky proces kërkon mbështetje financimi edhe nga qeveria qendrore.

Me nivel shumë të mirë të këtij treguesi (mbi 85 %) janë 10 shoqëri, nga të cilat 8 janë shoqëri rajonale UK Lushnje, Durrës, Korçë, Sarandë, Berat, Pogradec, Elbasan, Lezhë dhe 2 janë shoqëri ekzistuese (SHUK Tiranë dhe SHUK Kamëz).

ERRU thekson vazhdimisht nevojën e instalimit të matësve në të gjithë komponentët kyç të sistemeve të furnizimit me ujë dhe konsumatorëve individual, por për këtë kërkohet edhe mbështetja me financime nga qeveria qendrore.

1.1.5 Eficenca e Stafit

Eficenca e Stafit është një tregues shumë i rëndësishëm për sektorin pasi lidhet direkt me kostot e punës, të cilat zënë peshën kryesore ndaj totalit të kostove. Në vlerësimin e këtij treguesi ERRU ka përfshirë vetëm stafet sipas organigramës së shoqërive, pa përfshirë personelin roje të nënkontraktorëve pasi paraqet situatën reale të stafit, i cili operon në shoqëri sipas organigramës. Ky është edhe një nga dokumentet që ERRU i kërkon shoqërive në momentin që aplikojnë për nivel të ri tarifor dhe mbi të cilën vendosen edhe objektivat e këtij treguesi. Eficenca e stafit për vitin 2024 është 4.43 dhe ka një përmirësim nga viti 2023 që ishte 4.56 punonjës për 1000 lidhje UK. Ky tregues luhet në varësi të dy variablave që janë numri i stafit të shoqërive dhe numri i lidhjeve UK. Përmirësimi i lehtë i efencës së stafit për vitin 2024, vjen si rezultat i rritjes së numrit të lidhjeve të ujit me rreth 29,340 lidhje dhe të lidhjeve me kanalizime me rreth 24,041 lidhje duke influencuar kështu në përmirësimin e këtij treguesi.

Vlen të theksohet se në shumë shoqëri ky tregues është artificialisht i lartë për shkak të kërkesës në plotësimin e detyrimit ligjor për garantimin e sigurisë së veprave me personel roje, veçorive të komponentëve të sistemeve të FU dhe KUN. Në ato zona shërbimi ku numri i depove, puseve dhe stacioneve të pompimit është i madh shoqëritë janë të detyruara që të kenë një numër të konsiderueshëm punonjësish për të mbuluar shërbimin e sigurisë në këto objekte që krijojnë përshtypjen e një treguesi të ulët të Eficencës së Stafit. Gjithashtu, faktor tjetër që influencon negativisht në këtë tregues vijnë të mbeten punësimet e pajustificuara, gjë që kërkon një vëmendje të veçantë të analizës së stafit për vlerësimin real të këtij treguesi, bazuar në organigramën përkatëse të shoqërisë dhe justifikimin e çdo pozicioni të punës në përputhje me përshkrimin e saj.

1.1.6 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë

Kohëzgjatja e furnizimit me ujë është një nga treguesit më të rëndësishëm pasi konsumatorët reagojnë më shpejt kundrejt kohëzgjatjes së furnizimit me ujë dhe cilësisë së tij. Për vlerësimin e këtij treguesi përdoret mesatarja e orëve të furnizimit me ujë në ditë, i cili për vitin 2024 është 17.44 orë/ditë, me një rritje 1.14 orë/ditë krahasuar me vitin paraardhës 2023 i cili ka qënë në të njëjtin nivel me vitin 2022 me 16.3 orë/ditë. Objektivi i performancës së mirë të vendosur nga ERRU prej 18 orë në ditë ende nuk është arritur në rang sektori ndërsa për 10 shoqëri ky tregues është mbi 18 orë/ditë të furnizimit me ujë.

Ky tregues lidhet me aftësinë e shoqërisë për të mbajtur rrjetin e shpërndarjes nën një presion të caktuar shërbimi në mënyrë që t'u japë konsumatorëve të saj shërbimin në mënyrë të vazhdueshme dhe pa ndërprerje. Faktorët kryesorë që shkaktojnë këtë vazhdimësi të furnizimit me ujë janë humbjet e ujit nga mbi konsumi i pamatur si pasojë e faturimit aforfe, nga lidhjet e paligjshme dhe nga humbjet teknike në rrjet.

Shoqëritë duhet të kenë në fokus kryesor gjetjen e rrugës dhe mundësisë për përmirësime të mëtejshme të këtij treguesi dhe arritjen e objektivave strategjike të sektorit në tërësi. Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm, pavarësisht shkaqeve si (furnizimi i ujit me ndërprerje periodike, shpimi i tubave nga lidhjet e paligjshme, mbajtja e ujit në depozita etj.) ndikon edhe në cilësinë e ujit të pijshëm, që lidhet dhe me rrezikun e cënimit të shëndetit të popullatës. Gjithashtu, shoqëritë UK duhet të kujdesen në veçanti për treguesin Uji Pa të Ardhura që lidhet ngushtësisht me treguesin e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë të konsumatorëve.

Në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, për vitin 2024 kanë operuar 14 Shoqëri Rajonale Ujësjellës Kanalizime dhe 3 shoqëri ekzistuese Ujësjellës Kanalizime që janë: SHUK Tiranë, SHUK Kamëz dhe SHUK Vorë. Riorganizimi i shoqërive në zbatim të VKM-së nr.302, datë 11.05.2022 u shoqërua me dinamikën dhe problematikën e saj që reflektohet në treguesit kryesorë të performancës të shoqërive në veçanti dhe sektorit në tërësi.

Gjatë vitit 2024, shoqëria që raportoi furnizimin me ujë të pijshëm 24 orë/ditë pa ndërprerje është SHRUK Lezhë. Shoqëritë që kanë pasur rritjen me të ndjeshme të këtij treguesi për këtë vit janë përkatësisht: SHRUK Sarandë me rritje +11.00 orë/ditë dhe SHRUK Dibër me +10.00 orë/ditë.

Investimet kapitale vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e situatës së sektorit dhe në oraret e furnizimit me ujë, por eksperiencia ka treguar që shoqëritë me performancë të mirë ose që kanë arritur në nivele të pranueshme nuk e kanë arritur vetëm nga investimet, por edhe përmes menaxhimi të mirë të shoqërisë.

Kërkohet vëmendje nga shoqëritë UK dhe duhet të mbetet prioritet ofrimi i vazhdueshëm i shërbimit për konsumatorët, pasi me arritjen e standardeve të kërkuara për këtë tregues, shoqëritë përmirësojnë shërbimin ndaj konsumatorëve rrisin të ardhurat e tyre dhe ulin kërkesën e konsumatorëve për burime të tjera të furnizimit me ujë.

1.1.7 Mbulimi me Shërbimet e KUN

Treguesi "Mbulimi me KUN" është një ndër indikatorët kryesorë të objektivave strategjike për sektorin UK dhe si e tillë, ajo raportohet dhe monitorohet rregullisht. Kështu për vitin 2024 ky indikator ka shënuar një rritje respektivisht me **2.2%** krahasuar me vitin 2023. Popullsia në zonën e juridiksionit, për vitin 2024, për 17 shoqëritë UK, raportohet rreth 4,446,331 banorë, nga të cilët kanë akses në shërbimin e grumbullimit të ujërave të ndotura **2,535,858 banorë** ose e shprehur në lidhje me KUN rreth **738,854 lidhje**. Ky tregues ka një rritje të lehtë, pasi shërbimi me kanalizime raportohet të jetë shtuar me rreth 7,616 lidhje duke çuar mbulimin në 57% me këtë shërbim, megjithëse mbetet shumë larg nivelit 75% të mesatares kombëtare të kërkuar.

Mbulimi i përgjithshëm me kanalizime është përmirësuar gradualisht. Ky përmirësim ka ardhur për shkak të rritjes së mbulimit me kanalizime në zonat urbane, ndërkohë që mbulimi me kanalizime në zonat rurale nuk ka pasur përmirësime të ndjeshme. Fondet për investime në sektor për shërbimin e kanalizimeve kanë qenë të pakta, gati sa një e treta e investimeve për shërbimin e ujësjellësit, pasi më shumë i është kushtuar vëmendje shërbimit të furnizimit me ujë, gjithashtu ky diferencim ka ekzistuar edhe midis zonave urbane dhe rurale, me prioritet zonat urbane. Prandaj dhe treguesi i mbulimit për të dyja shërbimet UK është më i lartë në zonat urbane. Problemi kryesor vazhdon të mbetet zona rurale, në të cilën përgjithësisht nuk ka rrjet kanalizimesh dhe shkarkimet e ujërave të ndotura realizohen individualisht me gropa septike, por që lënë mjaft për të dëshiruar në drejtim të respektimit të standardeve teknike të zbatimit të tyre.

Mbulimi i shërbimit me KUN dhe Impiantë të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) mbetet sfidë për sektorin UK për t'u realizuar në të ardhmen duke pasur parasysh që është edhe një nga kërkesat që duhen plotësuar në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në BE dhe të arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030, që të arrihet akses në kanalizime dhe higjienë adekuate dhe të barabartë për të gjithë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grave dhe vajzave dhe ata që janë në situata të cenueshme. Ndaj, është e nevojshme të ndërmerren investime për ndërtimin e infrastrukturës së grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane në shkallë vendi.

1.1.8 Eficenca e Energjisë

Treguesi “Eficenca e Energjisë” llogaritet për të tretin vit në këtë raport dhe është një tregues shumë i rëndësishëm i performancës financiare të shoqërive UK, duke qenë se kostot e energjisë elektrike për shërbimin e furnizimit me ujë zënë pjesën më të madhe të kostove operative të shoqërive UK, që operojnë në sektor. Për këtë vit, eficienta e energjisë për shërbimin e furnizimit me ujë në sektor ka pësuar një përkeqësim të lehtë me 0.03 kwh/m³ duke e çuar këtë tregues nga 0.63 kwh/m³ që ishte në vitin 2023, në 0.66 kwh/m³ për vitin 2024.

Analiza e këtij treguesi bëhet për shkak se rritja e konsumit të energjisë elektrike është e lidhur drejtpërdrejt me rritjen e kostove operative si me situatën e krizës energjitike globale. Ky tregues duhet të ketë trend rënës për një performancë të mirë.

ERRU i rekomandon dhe i nxit të gjitha shoqëritë UK që operojnë në sektor të nisin nga puna për të bërë studim mbi eficientën e energjisë dhe përmirësimin e saj në sistemet e furnizimit me ujë. Në të, të analizohet efikasiteti i përdorimit të energjisë elektrike, si fillim në stacionet e pompimit duke bërë zëvendësim të pompave jo efikase, reduktimi të ujit të prodhuar dhe e ujit pa të ardhura etj. Kjo pasi mbulimi i kostove të energjisë elektrike, jo në të gjitha rastet mund të realizohet nga rritja e të ardhurave nëpërmjet rritjes së tarifës për FU, pasi në pjesën më të madhe të shoqërive do të kërkohej një rritje tarife shumë e lartë dhe e menjëhershme, e cila mund të krijojë reagim negativ nga konsumatorët për mospagimin e faturës së ujit. Gjithashtu, një tjetër element që duhet patur në konsideratë është edhe përballueshmëria e faturës për konsumatorët, e cila nuk duhet të kalojë vlerën prej 5% të shpenzimeve mesatare mujore për familje. Gjithsesi, kjo kërkon një analizë të detajuar dhe duhet parë rast pas rasti për secilën shoqëri.

1.1.9 Ankesat e Klientëve

“Ankesat e Klientëve” është një tregues shumë i rëndësishëm, i cili lidhet direkt me cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve dhe mbrojtjen e interesave të tyre dhe merret për herë të dytë në analizë. Vendosja e këtij treguesi si pjesë e treguesve kryesorë të performancës për t’u vendosur edhe si objektiva për shoqëritë UK, lidhet edhe me angazhimin e ERRU-së në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit. Ankesat e klientëve, në raport me numrin total të lidhjeve të sektorit UK për vitin 2024 janë 4.64%, me një rënie prej 0.41% krahasuar me vitin paraardhës 2023.

Përkeqësimi i këtij treguesi lidhet me faktin e riorganizimit të sektorit gjatë kësaj faze tranzicioni në drejtim të konsolidimit të shoqërive rajonale UK. *Natyra e ankesave të klientëve vijon të paraqitet kryesisht në tre kategori “zbatueshmëria e kushteve të kontratës për shërbime ujësjellës kanalizime”, “cilësia e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK” dhe “faturimi aforfe”.*

1.2 Rezultatet Financiare të Sektorit

1.2.1 Të Ardhurat nga Aktiviteti dhe Subvencionet

Rezultatet financiare për shoqëritë rajonale UK janë me humbje, përveç SHUK Tiranë dhe SHRUK Korçë, të cilat mbulojnë totalisht kostot operative dhe synojnë të mbulojnë kostot kapitale (ku përfshihen edhe ato për investime), me të ardhurat nga aktiviteti dhe të ardhura të tjera.

Për vitin 2024, nga 17 shoqëri UK që kanë operuar në sektor, ku 14 janë shoqëri rajonale UK dhe 3 janë shoqëri UK ekzistuese, rezulton se vetëm 5 prej tyre gjenerojnë të ardhurat e nevojshme për të shlyer totalisht kostot operative, ndërsa të gjitha shoqërive të tjera u mbetet një pjesë e kostove operative për t’u financuar nga jashtë apo subvencionuar, në mënyrë që të mos ngarkohen llogaritë e pagueshme çdo vit.

Gjatë vitit 2024 qeveria qendrore, nëpërmjet AKUK ka shpërndarë 349.9 milionë lekë subvencione, të cilat krahasuar me një vit më parë janë rritur me rreth 39.9 milionë lekë. Për këtë vit, subvencione kanë përfituar 14 shoqëri rajonale UK, respektivisht, Lushnje, Fier, Pogradec, Korçë, Dibër, Gjirokastrë, Kukës, Shkodër, Elbasan, Lezhë, Vlorë, Sarandë, Durrës, Berat dhe dy shoqëritë SHUK Tiranë, SHUK Vorë.

Shoqëritë rajonale janë subvencionuar për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për shoqëritë që e kanë mbi 75% të prodhimit me ngritje mekanike si dhe ato shoqëri që kanë krijuar detyrime të reja për energjinë gjatë vitit 2024 për shkak të kostove të larta të energjisë, kriter i cili është zbatuar për të subvencionuar shoqëritë rajonale UK Durrës, Vlorë, Shkodër, Fier dhe Elbasan. Kjo lidhet edhe me strategjinë e qeverisë qendrore, e cila i ka dhënë prioritet me mbështetje financiare shoqërive UK që janë bërë pjesë e reformës sipas VKM-së nr. 302 ku MIE/AKUK është aksioner me 51% të aksioneve.

Shpërndarja e subvencioneve është bërë 91.2% për mbulimin e kostove të energjisë elektrike dhe 8.8% për shtresat në nevojë sipas tabelës nr.6 të mëposhtme.

Tabela nr.6. Shpërndarja e subvencioneve për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023

Shpërndarja e Subvencioneve	Viti 2023		Viti 2024	
	Shpërndarja		Shpërndarja	
	(në Lekë)	(në %)	(në Lekë)	(në %)
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	14,288,043	4.6		
Tatim Taksa të papaguara	170,684	0.1		
Paga të papaguara	14,091,049	4.5		
Energji Elektrike	281,450,224	90.8	319,028,019	91.2
Performancë				
Shtresa në nevojë			30,865,624	8.8
Totali	310,000,000	100	349,893,643	100

Burimi: AKUK

Për vitin 2024 janë realizuar 11 378 milion lekë të ardhura nga aktiviteti i shoqërive UK, të cilat krahasuar me vitin paraardhës janë rritur me 983 milion lekë.

Në Aneks 3, tabela nr. 26, paraqet nevojat reale për subvencione të shoqërive UK për të mbuluar kostot e O&M si dhe subvencionet e marra për vitin 2024. Në këtë tabelë, të ardhurat nga aktiviteti krahasohen me Kostot e O&M dhe Kotot Totale, gjithashtu paraqitet dhe rezultati financiar vjetor i shoqërive UK me humbje ose fitim.

Tabela nr. 7 jep në mënyrë të përmblëdhur të ardhurat për sektorin nga aktiviteti i shoqërive UK dhe nga subvencionet e akorduara nga qeveria qendrore nëpërmjet AKUK.

Tabela nr.7 Të Ardhurat e Sektorit UK për Vitet 2023-2024 nga Aktiviteti dhe Subvencionet (në 000 lekë)

Nr.	Emërtimi	Viti 2023	Viti 2024	Diferenca
1	Të Ardhurat nga Aktiviteti UK	10,395,198	11,378,607	983,409
2	Të Ardhurat nga Subvencionet	310,000	349,894	39,894
3	TOTALI	10,705,198	11,728,501	1,023,303

Nga tabela e mësipërme vërehet se të ardhurat janë rritur me rreth 983 milionë lekë. Shoqëritë rajonale UK që kanë rritjen më të madhe të të ardhurave janë SHRUK Vlorë (+305 milion lekë), për shkak të rritjes së numrit të lidhjeve për te dy shërbimet FU dhe KUN dhe rritjes së nivelit të faturimit dhe eliminimit të lidhjeve të paligjshme; SHRUK Durrës (+230 milion lekë) për shkak të rritjes së numrit të lidhjeve. Të tjera shoqëri me të ardhura më të larta, krahasuar me vitin paraardhës janë: SHUK Tiranë (+143 milion lekë), SHRUK Elbasan (+57 milion lekë), SHRUK Lezhë (+46 milion lekë),

SHUK Kamëz (+43 milion lekë), SHRUK Pogradec (+32 milion lekë), SHRUK Fier (+32 milion lekë), SHRUK Shkodër (+26 milion lekë), SHRUK Sarandë (+22 milion lekë), SHRUK Korçë (+19 milion lekë), SHRUK Lushnje (+11 milion lekë), SHRUK Kukës (+10 milion lekë), SHRUK Berat (+10 milion lekë), SHUK Vorë (+ 9 milion lekë), SHRUK Dibër (+8 milion lekë).

E vetmja shoqëri që ka rënie të të ardhurave krahasuar me vitin paraardhës është SHRUK Gjirokastrë (- 28 milion lekë) për shkak të rënies së numrit të lidhjeve për shërbimin FU (-707).

Për vitin 2024 janë 5 shoqëri rajonale që i mbulojnë mbi 100% Kostot O&M nga 14 shoqëri rajonale.

Niveli i mbulimit të kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes, krahasuar me vitin e mëparshëm ka pësuar rritje për të gjithë sektorin rreth 7.1%, siç paraqitet dhe në tabelën nr. 8 në vijim.

Tabela nr.8: Mbulimi i Kostove të Sektorit

(në 000 lekë)

Nr.	Emërtimi	Viti	Viti
		2023	2024
1	Kostot e Sektorit UK	10,346,217	10,575,791
2	Të Ardhurat nga Aktiviteti	10,395,198	11,378,607
3	Mbulimi i kostove O&M	100.50%	107.6%
	Shoqëri që mbulojnë Kostot O&M 2024	6	5

Rritja e të ardhurave nga aktiviteti ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së lidhjeve me ujë me rreth 29,340 lidhje të reja dhe atyre me kanalizime me rreth 24,041 lidhje.

Sektori me të ardhurat e gjeneruara arrin të mbulojë kostot e O&M deri në nivelin 107.5%, ku pesë shoqëri arrijnë t'i mbulojnë kostot O&M mbi 100%, 6 shoqëri i mbulojnë mbi 85% dhe 6 shoqëri të tjera i mbulojnë më pak se 85% e këtyre kostove.

1.2.2 Investimet në Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimit të Ujërave të Ndotura

Investimet në fushën e Ujësjetës Kanalizimeve që realizohen nëpërmjet agjencisë zbatuese AKUK ndahen :

I. Të financuara nga buxheti i shtetit, përkatësisht:

- investime fizike në sistemet e furnizimit me ujë dhe KUN
- Investime për studim-projektim-oponencë teknike

II. Të financuara nga donatorët e huaj sipas marrëveshjeve përkatëse me qeverinë shqiptare.

- Investime fizike në sistemet e furnizimit me Ujë, KUN dhe ITUN
- Konsulencë financim i huaj

Në total, vlera e planifikuar e investimeve në sektorin UK sipas tabelës nr.9 të mëposhtme për vitin 2024 ka qenë 21,367,246,000 lekë (ose rreth 194.3 milion Euro), nga të cilat 13,938,972 lekë janë planifikuar për investim nga Qeveria Shqiptare (rreth 65% të totalit) dhe 7,428,274 lekë nga donatorët e huaj (rreth 35%).

Në Aneks 13 jepet gjithashtu tabela nr. 36, (burimi AKUK), e cila përmban të dhëna të plota për çdo shoqëri UK të bashkive përkatëse, ku përfshihen detaje të secilit projekt, vlera e kontratës, vlera e financuar, si dhe realizimi fizik në përqindje deri në mbyllje të vitit 2024.

Theksohet fakti se në sektorin e Ujësjetës Kanalizimeve financohen mjaft projekte, kryesisht në zona rurale, edhe nga agjencia tjetër zbatuese Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), të cilat nuk janë subjekt i këtij raporti.

Tabela nr.9: Investimet totale

Nr.	Zërat	Vlera e Planifikuar (në lekë me TVSH)	Vlera në % mbi Totalin
1	Totali i Investimeve Fizike Buxheti i Shtetit (Ujë, KUN, ITUP)	10,684,878,587	82.4%
2	Totali i Studim-Projektim-Oponencë teknike	625,103,413	4.8%
3	Totali Investime Financimi i Huaj (Ujë, KUN, ITUN)	1,659,539,000	12.8%
4	Totali i Përgjithshëm (me TVSH)	12,969,521,000 (rreth 129.7 milion Euro)	

1 Euro=110 All

Nga tabela e mësipërme vërehet se zëri i financimeve studim-projektim-oponencë teknike përbën 5% të totalit të përgjithshëm të investimeve fizike. Kjo vlerë duhet të jetë ndërmjet 5%-20% të vlerës së totalit të investimeve fizike kushtëzuar nga madhësia e vlerës së investimit si dhe kompleksitetit dhe vështirësisë inxhinjerie të zbatimit të tij. Për rrjedhojë kjo përqindje konsiderohet e ulët gjë që në mjaft raste mund të mbartë rrezikun e cenimit të cilësisë së hartimit të projektit, dhe sidomos cilësinë e supervizionit të punimeve gjatë zbatimit të tij.

Tabela nr.10 jep vlerat e investimeve të planifikuara dhe të financuara gjatë vitit 2024 nga buxheti i shtetit dhe nga financimet e huaja të ndara sipas destinacionit përkatës.

Tabela nr. 10: Investimet e financuara për vitin 2024 sipas vlerave dhe destinacionit

Përshkrimi	Vlera e Planifikuar	Vlera e Financuar	Realizimi
	(në lekë)	(në lekë)	(në %)
Investimet nga AKUM	11,309,982,000	11,179,835,619	99
I. Objektet në vazhdim me financim të brendshëm	8,658,288,677	8,577,121,472	99
a) Objektet e reja të vitit 2024 me financim të brendshëm	2,026,589,910	1,988,725,384	98
b) Supevizim punimesh	137,885,489	127,087,887	92
TVSH	321,177,278	320,960,230	100
c) Kosto Lokale	166,040,646	165,940,646	100
II. Investimet e Huaja (Objekte në vazhdim)	1,659,539,000	1,473,559,055	89
TOTALI	12,969,521,000 (eq.129.7 mln euro)*	12,653,394,674 (eq.126.5 mln euro)*	98

Referuar tabelës nr. 10 dhe krahasimit të saj me tabelën nr. 9 të mësipërme, vërehet se gjatë vitit ka patur një rishikim të fondeve me financim të huaj, nga 1.6 miliardë në 1.5 miliardë lekë. Kjo si rezultat i vonesave në ecurinë e investimeve për shkak të procedurave tenderuese, të cilat janë vonuar në kohë. Referuar vlerave të tabelës rezulton se në sektor janë financuar 98% e investimeve të planifikuara gjatë vitit 2024. Gjithashtu vërehet se investimet në sektor edhe për vitin 2024 vijnë të jenë të fokusuara në drejtim të furnizimit me ujë dhe jo të kanalizimeve.

AKUK raporton se nga totali i investimeve të planifikuara që janë në proces, vetëm gjatë vitit ushtrimor 2024, janë përfunduar në total **43 investime me vlerën 2,027,445,850 lekë, të cilat janë shtrirë në 18 Bashki të vendit**, si më poshtë në tabelën nr.11.

Tabela. nr. 11: Investimet e realizuara dhe të përfunduara gjatë vitit 2024 sipas bashkive

Nr.	Lista e Bashkive	Numri i investimeve të përfunduara	Vlera e investimit të realizuar	Përfundimi Punimeve (VITI)
1	Bashkia Lushnje	1	26,854,606	2024
2	Bashkia Elbasan	2	22,483,494	2024
3	Bashkia Malësi e Madhe	3	147,636,728	2024
4	Bashkia Mat	4	335,050,996	2024
5	Bashkia Kukës	2	31,697,136	2024
6	Bashkia Peqin	2	17,091,928	2024
7	Bashkia Pogradec	4	296,160,096	2024
8	Bashkia Vlorë	1	80,000,000	2024
9	Bashkia Sarandë	2	53,258,696	2024
10	Bashkia Dibër	4	63,179,261	2024
11	Bashkia Bulqizë	5	351,240,212	2024
12	Bashkia Laç	2	274,650,541	2024
13	Bashkia Shkodër	2	43,598,637	2024
14	Bashkia Tiranë	2	10,656,320	2024
15	Bashkia Shijak	2	73,002,833	2024
16	Bashkia Klos	2	118,877,582	2024
17	Bashkia Finiq	2	60,406,784	2024
18	Bashkia Fier	1	21,600,000	2024
Totali		43	2,027,445,850	

Nga 43 investimet e mësipërme të përfunduara, katër prej tyre janë investime të realizuara për përmirësimin e rrjetit të trajtimit të ujërave të ndotura (KUZ). Pjesa tjetër prej 39 investimeve të kryera janë në funksion të përmirësimit dhe rritjes së cilësisë në sistemimin e furnizimit dhe shpërndarjes me ujë të pijshëm.

1.3 Besueshmëria dhe Saktësia e të Dhënave të Raportuara nga Shoqëritë

Raporti i Performancës, për të gjashtin vit radhazi është hartuar duke u bazuar në të dhënat që shoqëritë UK kanë raportuar pranë sektorit të monitorimit të ERRU, në vijim të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 31, datë 28.06.2019 mbi “Platformën e Data Bazës për Grumbullimin e të Dhënave nga Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime”.

ERRU i kushton një rëndësi të veçantë procesit të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së operatorëve UK dhe sektorit në tërësi duke synuar nxitjen e përmirësimit të performancës së tij, referuar cilësisë së shërbimeve të ofruara për konsumatorët dhe qëndrueshmërisë financiare të vetë sektorit. Kjo arrihet përmes një vlerësimi korrekt të performancës së çdo operatori dhe vendosjen e objektivave sfiduese dhe të arritshme, shoqëruar me plane veprimi për arritjen e tyre.

Saktësia e të dhënave të raportuara është një element thelbësor në përgatitjen e Raporti të Performancës së shoqërive UK i cili është një dokument unik në sektor që publikohet çdo vit nga ERRU pas mbylljes së bilanceve financiare në fund të mars 2024, në mënyrë që t'i lihet shoqërive një kohë

minimale e mundshme gjatë vitit për zbatimin e rekomandimeve që rrjedhin nga ky raport në lidhje me performancën dhe problematikën e sektorit në vitin 2024. Kjo bën të mundur që shoqëritë të kenë kohë për të zbatuar rekomandimet e raportit gjatë vitit pasues.

Gjatë vitit 2023-2024, në sektor kanë ndodhur ndryshime thelbësore, të cilat kanë filluar që në vitin 2022, si rezultat i reformës së miratuar nga qeveria. Në vijim të forcimit të rolit të tij monitorues, ERRU grumbullon të dhënat sipas formatit të miratuar të bazës së të dhënave, të cilat përdoren edhe për hartimin e Raportit Vjetor 2024. Në përputhje me planet e miratuara dhe kur vihen re problematika, ERRU kryen gjithashtu monitorime në terren tek shoqëritë UK për një vlerësimin real të performancës, si dhe me njohjen e vështirësive dhe problematikave që hasin shoqëritë UK. ERRU i ka kushtuar rëndësi të veçantë mbështetjes së shoqërive UK në procesin e raportimit të të dhënave, duke mbajtur komunikim të ngushtë me to.

Pasaktësi jo të vogla konstatohen në drejtim të të dhënave tekniko-ekonomike si ato në bilancet e ujit që shoqëritë dorëzojnë pranë ERRU-së, të cilët hartohen me vlerësime dhe jo me instrumenta matëse. Kjo kryesisht për shkak të mungesës së ujëmatësve të mëdhenj në pikat kyçe të sistemeve të furnizimit me ujë. Si rezultat, Uji Pa të Ardhura, si treguesi kryesor i performancës së sektorit mund të rezultojë me shkallë relativisht jo të vogël pasaktësie. Gjithashtu, pasaktësi konstatohen edhe në raportimet që bëjnë shoqëritë në drejtim të arkëtimeve të detyrimeve korente dhe atyre të prapambetura, mbi bazën e të cilave llogariten treguesit e Norma e Arkëtimit Korente dhe ajo e Përgjithshme.

ERRU, në mënyrë të vazhdueshme u ka rekomanduar drejtuesve të shoqërive UK nevojën për caktimin e një personi përgjegjës për raportimin e të dhënave tekniko ekonomike pranë ERRU dhe çdo institucioni tjetër të interesuar në mënyrë që të dhënat e raportuara prej tyre të jenë të njëjta për secilën palë duke pasqyruar kështu situatën reale të shoqërisë.

Për të adresuar këto problematika, në nëntor të vitit 2023 ERRU nënshkroi me AKUK marrëveshjen e bashkëpunimit për rregullimin e përdorimit të një sistemi të integruar mbi të dhënat dhe treguesit kryesorë të performancës (IPIS), që mbahen dhe raportohen nga shoqëritë UK. Ky sistem pritet të ketë impakt pozitiv në zgjidhjen përfundimtare të problematikës së raportimit të të dhënave të sakta dhe të besueshme.

2 Analiza e Performancës për Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime

Monitorimi dhe vlerësimi krahasues i performancës së shoqërive ujësjiellës kanalizime është i bazuar në 12 tregues kryesorë të performancës, të miratuara nga Komisioni Kombëtar Rregullator, *por në raport do të analizohen 11 tregues, pasi Norma e Arkëtimit Korente dhe Norma Totale përmblihen në një tregues.*

Treguesit Kryesor të Performancës janë përzgjedhur për të nxitur përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe forcimin e qëndrueshmërisë financiare të tyre. Përparësi u është dhënë indikatorëve që pasqyrojnë situatën ekonomike, kapacitetet menaxhuese dhe niveli i cilësisë së ofruar të shërbimeve ndaj konsumatorëve. Përmes këtyre treguesve vlerësohen drejtimet kryesore të performancës së operatorëve.

Viti 2024 konsiderohet si viti i dytë i zbatimit të reformës në sektorin e ujit në Shqipëri, ku janë agreguar 14 nga 15 shoqëri rajonale UK të parashikuara sipas reformës. ***Nisur nga situata aktuale e sektorit UK ku shërbimi i furnizimit me Ujë dhe Kanalizime ofrohet nga 14 shoqëri rajonale UK dhe 3 shoqëri UK ende të parajonalizuara si UK (Tiranë, Kamëz dhe Vorë), analiza e shoqërive UK në këtë raport për herë të parë është realizuar sipas shoqërive UK të grupuara së bashku dhe jo të ndara në grupe.*** Duke qenë se ndryshimet në sektor si rezultat i reformës kanë ndodhur gjatë vitit 2022-2023-2024, për efekt krahasimi me vitin paraardhës, analiza e shoqërive është realizuar duke i krahasuar në vitin 2023 dhe duke pare ecurinë që nga viti 2022 sipas shoqërive UK Rajonale (vetëm për 14 shoqëritë rajonale UK të krijuara) dhe tre shoqëri UK ekzistuese (SHUK Tiranë, Kamëz dhe Vorë).

Në tabelën nr. 12 jepen të renditura shoqëritë UK sipas situatës aktuale (pas reformës) që operojnë në sektor sipas madhësisë së tyre bazuar në numrin e lidhjeve të furnizimit me ujë, ndërsa në Aneks 9, në tabelën 32, jepen të detajuara të gjithë Treguesit Kryesorë të Performancës për secilën shoqëri UK më vete.

Tabela nr.12: Numri i lidhjeve për çdo Shoqëri UK

Nr.	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (Ujësjiellës)
1	UK Tiranë	279,302
2	UK Rajonale Durrës	136,114
3	UK Rajonale Vlorë	72,623
4	UK Rajonale Elbasan	69,344
5	UK Rajonale Korçë	55,305
6	UK Rajonale Fier	54,811
7	UK Rajonale Shkodër	46,436
8	UK Rajonale Berat	42,750
9	UK Rajonale Sarandë	32,147
10	UK Rajonale Lezhë	31,848
11	UK Rajonale Gjirokastër	31,373
12	UK Kamëz	30,026
13	UK Rajonale Lushnje	28,687
14	UK Rajonale Pogradec	27,136
15	UK Rajonale Dibër	24,108
16	UK Rajonale Kukës	12,684
17	UK Vorë	5,820

Burimi: ERRU

2.1 Analiza e Performancës në Lidhje me Objektivat e Vendosura nga ERRU

Për efekt të analizës për secilin TKP, ERRU ka përcaktuar objektivat e synuar (që duhen arritur nga shoqëritë UK) për vlerësimin e performancës. Në grafikët e analizës së performancës së çdo treguesi vija e verdhë tregon nivelin e objektivit të synuar për arritjen e një performance të mirë, gjithçka poshtë vijës së kuqe tregon performancë të dobët. Segmenti ndërmjet dy vijave konsiderohet performancë e “pranueshme”, që tregon nga njëra anë përpjekjet e bëra nga shoqëritë dhe nga ana tjetër domosdoshmërinë për përmirësime të mëtejshme. Në tabelën nr. 13 tregohen kufijtë minimal dhe maksimal të përcaktuar për secilin TKP, ku për treguesin e efica e stafit në këtë raport si rezultat i reformës analiza do të marrë në konsideratë objektivin e vendosur për grupin e parë të shoqërive. Në grafikun nr. 1 më poshtë është një shembull i grafikëve të analizës së TKP-ve.

Grafiku nr.1: Analiza e TKP-ve




Tabela nr.13: Objektivat për TKP të Vendosura nga ERRU

Treguesit Kryesorë të Performancës		Objektivat nga ERRU		
		Mirë	Pranueshëm	Dobët
1 – Mbulimi i Kostove O&M		≥ 100%	80 - 100%	≤ 80%
2 – Mbulimi i Kostos Totale		≥ 80%	50 - 80%	≤ 50%
3 – Norma e Arkëtimit		≥ 82%	60 - 82%	≤ 60%
4 – Efienca e Stafit (numri i stafit për 1000 lidhje) ¹	Grupi 1	≤ 4	4 - 6	≥ 6
	Grupi 2	≤ 6	6 - 10	≥ 10
	Grupi 3	≤ 10	10 - 15	≥ 15
5 – Uji Pa të Ardhura		≤ 30%	30 - 50%	≥ 50%
6 – Niveli i Matjes		≥ 85%	n/a	<85
7 – Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë		≥18 orë/ditë	8 - 18 orë/ditë	≤8 orë/ditë
8 – Mbulimi me Kanalizime		≥ 75%	50 - 75%	≤ 50%

¹ Për TKP Efienca e Stafit, objektivi i benchmarking është marrë në konsideratë objektivi i vendosur për grupin e parë të shoqërive, duke marrë parasysh faktin që si rezultat i reformës tashmë kemi të bëjmë me shoqëri të mëdha (të cilat u shërbejnë zakonisht zonave me densitetet popullore më të madhe) dhe si rrjedhojë e kanë më të lehtë të mbajnë më të ulët numrin e stafit për 1000 lidhje.

2.2 Treguesit Kryesorë të Performancës

2.2.1 Uji Pa të Ardhura (UPA)

UPA në thelb është një koncept financiar dhe operacional që përfshin gjithë sasinë e ujit që nuk gjeneron të ardhura për shoqërinë, edhe nëse nuk është sasia reale e ujit të humbur fizikisht. Bilanci i Ujit që hartohet nga ERRU bazuar në raportimet e shoqërive shërben dhe ka si qëllim kryesor evidentimin dhe marrjen e masave për përmirësimin e performancës financiare dhe efikasitetin operativ të shoqërive, por dhe për një menaxhim sa më të qëndrueshëm të burimeve ujore.

Niveli i këtij treguesi për vitin 2024 rezultoi në nivelin **61% nga 64.7%** në vitin 2023, duke reflektuar një trend pozitiv/përmirësues, por ende larg nivelit 30% së performancës së mirë dhe 50 % të performancës së dobët të përcaktuar nga ERRU.


“Uji i prodhuar” që hyn në sistemin e shpërndarjes raportohet në sasinë **302,816,000 m³**, nga të cilat **60.3 %** rezultoi i matur dhe **39.7%** i vlerësuar. Për vitin 2024, vihet re ulja e sasisë së ujit të prodhuar me **14.6 milion m³** krahasuar me vitin 2023, ndërsa faturimi total rezulton **118 milion m³** me një tendencë përmirësimi **prej 6 milion m³** krahasuar me 2023, ndaj dhe treguesi i UPA rezulton me një zbritje prej me **3.7%** në shkallë kombëtare.

Pra, nga një vështrim i përgjithshëm një nga faktorët kryesor në përmirësimin e treguesit UPA **me -3.7%** është **ulja e sasisë së ujit të prodhuar dhe përmirësimi i sasisë së ujit të faturuar** gjatë vitit 2024 e shoqëruar dhe me rritjen e numrit të lidhjeve me klientët.

Problematikat dhe vështirësitë e hasura gjatë hartimit të Bilancit të Ujit janë niveli i ulët i matjes dhe vlerësimi i volumeve të ujit të prodhuar dhe faturuar për disa nga shoqëritë UK, apo historiku i raportimit të të dhënave jo të sakta nga ana e ish shoqërive UK, çka tregojnë arsyet e luhatjeve së herëpa hershme të treguesit UPA në disa prej shoqërive UK.

Llogaritja e këtij treguesi kërkon njohuri të volumit të përgjithshëm të Ujit Pa të Ardhura, numrit të lidhjeve në sistem dhe presionit mesatar të ujit në sistemin e ujësjellësit. Më poshtë jepet një paraqitje grafike e ecurisë së këtij treguesi për tre vitet e fundit për 17 shoqëritë që operojnë në sektorin UK në Shqipëri.

Grafiku nr.2: Uji Pa të Ardhura



Referuar grafikut të këtij treguesi vihet re se, nga 17 shoqëritë UK që ofrojnë furnizimin me ujë në sektor, një shoqëri ka arritur që gjatë vitit 2024 të raportojë nën kufirin 30% të performancës së mirë, 5 prej tyre performuan brenda kufirit 30-50% dhe 12 shoqëritë e tjera mbi kufirin 50% të performancës së dobët, por vlen të theksohet se vetëm dy shoqëri jo rajonale raportojnë përkeqësim të këtij treguesi.

Përmirësim të ndjeshëm të këtij treguesi duke e ulur vlerën krahasuar me vitin 2023 kanë raportuar SHUK Dibër (-22.14%), SHUK Sarandë (-15.61%), SHUK Lezha (-12.17%). Në nivele më pak të ulët por gjithmonë në trend zbritës kanë performuar edhe SHUK Berat (-8.93%), duke u ndjekur nga SHUK Gjirokastrë (-7.03%), SHUK Kukës (-7.53%), SHUK Elbasan (-7.05%), SHUK Durrës (-5.08%), SHUK Vlorë (-5.58%), SHUK Fier (-4.23%), SHUK Shkodër (-3.02%) dhe shoqëria ekzistuese SHUK Kamëz (-4.4%).

SHUK Pogradec dhe SHUK Korçë megjithëse me nivel të ulët përmirësimi janë afër kufirit 30% të performancës së mirë dhe konsiderohen shoqëri me nivel performance të mirë. Megjithëse disa shoqëri paraqesin një trend pozitiv/zbritës të këtij treguesi duhet të sqarojmë se nivelet e ulëta të këtij treguesi për SHUK Durrës, Vlorë, Shkodër, Elbasan dhe SHUK Kamëz tregojnë se ka ende shumë punë për të bërë për përmirësimin e tij.

Vihet re, përkeqësim i këtij treguesi për dy shoqëri kryesisht shoqëri jorajonale si SHUK Tiranë (+1.82%) dhe SHUK Vorë (+2.51%).

Nëse do të bënim një analizë të ecurisë së këtij treguesi, referuar tre viteve të fundit është vërejtur një ulje e ndjeshme e indikatorit të “Ujit pa të Ardhura” për disa shoqëri, e cila përfaqëson një përmirësim domethënës në performancën teknike dhe menaxheriale të tyre. Këto vlera tregojnë jo vetëm progres vjetor, por edhe një ecuri pozitive afatmesme të disa shoqërive rajonale si p.sh. SHUK Dibër, krahasuar me vitin 2023, reduktimi arrin në 22.14%, e ndjekur nga SHUK Sarandë krahasuar me vitin 2023, reduktimi arrin në 15.61%. Ky përmirësim lidhet potencialisht me një menaxhim më të mirë pas riorganizimit duke rritur ndërhyrjet në mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes, identifikimin dhe ndërprerjen e lidhjeve të paligjshme, të konsumit të autorizuar jo të faturuar, si dhe saktësimi i të dhënave nga ana e shoqërive.

Rezultati është një rritje e efikasitetit të sistemit dhe ulje e humbjeve që nuk gjenerojnë të ardhura, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të sektorit të ujit.

Tabela nr.14. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura

(në %)

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024-2023
1	Dibër	UK	47.1	49.3	27.16	-22.14
2	Sarandë	UK	47.2	73.2	57.59	-15.61
3	Lezhë	UK	65.6	70.8	58.63	-12.17
4	Berat	UK	52.8	46.6	37.67	-8.93
5	Kukës	UK	52.1	51	43.47	-7.53
6	Elbasan	UK	63.9	69.5	62.45	-7.05
7	Gjirokastrë	UK	47.7	42.6	35.57	-7.03
8	Vlorë	UK	75.7	79.4	73.55	-5.85
9	Durrës	UK	73.4	72.4	67.32	-5.08

10	Kamëz	UK	73.2	71.5	67.1	-4.40
11	Fier	UK	67.4	65.7	61.47	-4.23
12	Shkodër	UK	66.6	67.02	64	-3.02
13	Lushnje	UK	69.0	57.0	54.13	-2.87
14	Korçë	UK	33.4	35.8	33.53	-2.27
15	Pogradec	UK	38.9	34.8	34.36	-0.44
16	Tiranë	UK	59.8	60.0	61.82	1.82
17	Vorë	UK	70.1	80.7	83.21	2.51

Përfundime

- Niveli i Ujit Pa të Ardhura për vitin 2024 rezultoi në nivelin 61%. Nga 14 shoqëri rajonale dhe 3 shoqëri UK ekzistuese, që ushtrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, një shoqëri performoi nën kufirin 30%, të performancës së mirë, 5 prej tyre performuan brenda kufirit 30-50% dhe 12 shoqëritë e tjera mbi kufirin 50%, të performancës së dobët.
- “Uji i prodhuar” që hyn në sistemin e shpërndarjes raportohet në sasinë 302,816,000 m³, nga të cilat 60.3 % rezultoi i matur dhe 39.7% i vlerësuar.
- Për vitin 2024, vihet re ulja e sasisë së ujit të prodhuar me **14.6 milion m³** krahasuar me vitin 2023, ndërsa Faturimi Total rezulton **118 milion m³** me një tendencë përmirësimi prej **6 milion m³** krahasuar me 2023, ndaj dhe treguesi i UPA rezulton me një zbritje prej me **3.7%** në shkallë kombëtare.
- Niveli i lartë i UPA duhet të trajtohet si një objektiv strategjik nga ana e shoqërive sepse ky tregues lidhet drejtpërdrejtë me efikasitetin, përballueshmërinë dhe besueshmërinë e sistemeve të ujësjellësit. Vëmendje të veçantë duhet t’i kushtohet Indeksit të Rrjedhjeve Infrastrukturore (ILI), saktësimit të të dhënave vjetore si dhe investimeve në ujëmatës për pikat e prodhimit dhe për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.
- Niveli i matjes në prodhim ende rezulton në nivele jo të kënaqshme. Rritja e këtij treguesi nëpërmjet instalimit të ujëmatësve në të gjitha pikat kyçe të prodhimit saktëson të dhënat mbi “Ujin e prodhuar”, mbron burimet ujore nga përdorimi pa kriter si dhe lejon shfrytëzimin e tyre në përputhje me kërkesën standarde për ujë.
- Ende vërehet që “Bilanci i Ujit” për disa nga shoqëritë nuk kuptohet plotësisht dhe trajtohet si një instrument i rëndësishëm për vlerësimin e humbjeve të ujit dhe të menaxhimit të kërkesës për ujë, ndaj investimet për rritjen e kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve për stafin teknik, lidhur me hartimin dhe raportimin bazuar në të dhëna të sakta dhe reale, vazhdon të jetë kërkesë reale.
- Përthithja e investimeve për përmirësimin e situatës teknike të sistemeve të vjetruara të furnizimit me ujë, përdorimi i teknologjive dhe sistemeve të kontrollit që ndihmojnë në identifikimin dhe parandalimin e humbjeve në rrjetin e furnizimit me ujë, janë hapa që duhen ndërmarrë nga ana e shoqërive.

- Sensibilizimi i publikut, edukimi i qytetarëve për rëndësinë e ruajtjes së ujit dhe përdorimit të tij të qëndrueshëm mund të ndihmojë në zvogëlimin e humbjeve në rrjet dhe ky është një hap që duhet të ndërmerret nga shoqëria.


2.2.2 Mbulimi i Kostove O&M

“Mbulimi i Kostove O&M” është një nga treguesit e performancës financiare, i cili paraqet raportin me të cilin të ardhurat e realizuara nga aktiviteti mbulojnë kostot operative që nevojiten për funksionimin e aktivitetit. Në të përfshihen vetëm kostot që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen dhe përjashtohen kostot e amortizimit, huave dhe kostot financiare.

Për vitin 2024, niveli mesatar i këtij treguesi për gjithë sektorin UK është 107.6% nga 100.5% që ishte në vitin paraardhës duke shënuar një rritje me 7.1%. Niveli mbi 100% i këtij treguesi të performancës, tregon se sektori me të ardhurat e faturuara arrin të mbulojë kostot operative. Në vitin 2024 janë 14 shoqëri rajonale dhe 3 shoqëri UK. Për vitin 2024 janë 12 shoqëri nga totali prej 17 shoqëri që nuk arrijnë të mbulojnë kostot e O&M me të ardhurat, të cilat vazhdojnë të subvencionohen plotësisht ose pjesërisht nga qeveria qendrore me anë të AKUK-ut. Në kuadër të reformës, krijimi i shoqërive rajonale duke bashkuar shoqëritë në vështirësi financiare me shoqëritë në gjendje të qëndrueshme financiare, pritet që në disa raste të ndikojë pozitivisht duke zvogëluar/eliminuar subvencionet nga qeveria qendrore e shoqërive UK për shlyerjen e kostove operative të vitit ushtrimor dhe duke u përqëndruar në investime të cilat duhet të sjellin optimizimin e kostove, rritjen e sigurisë dhe cilësisë së shërbimeve.

ERRU konstaton se për vitin 2024, në sektor janë 5 shoqëri që kanë këtë tregues mbi 100%, nga 6 që rezultonin në vitin 2023. Shoqëritë UK që janë shtuar duke kaluar nivelin e mbulimit 100% janë UK Lezhë (nga 89.4% në 103.6%). Shoqëritë UK që kanë pësuar rënie duke mos e kaluar nivelin e mbulimit 100% janë SHRUK Sarandë (nga 118.5% në 96.5%), SHRUK Diber (nga 101.1% në 88.9%), Më poshtë ky tregues analizohet në detaje për secilin grup të shoqërive. Realizimi i këtij treguesi për shoqëritë UK për vitin 2024 jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku nr.3: Mbulimi i Kostove O&M, Viti 2024



Siç vërehet nga grafiku nr. 3, nga 17 shoqëritë përkatësisht: SHUK Tiranë, SHUK Korçë, SHUK Berat dhe SHUK Pogradec për vitin 2024 vijnë të mbeten në nivelin e performancës së mirë ($\geq 100\%$) të mbulimit të kostove O&M të vendosur nga ERRU.

Përkeqësim të këtij treguesi në nivelet më të larta e ka SHUK Sarandë me 22 %. Performanca e SHUK Sarandë ka rënie për shkak të rritjes së lartë të kostos së operimit me 88.4 milionë lekë, përkundërt rritjes së të ardhurave totale nga aktiviteti me 22.2 milion, si rezultat i rritjes së totalit të faturuar UK ITUN.

Në zonën e performancës së dobët për këtë vit janë katër shoqëri rajonale dhe konkretisht: SHUK Vorë (45.4%), SHUK Kukës (75.8%), SHUK Fier (77.2%), SHUK Elbasan (79.3%) Këto shoqëri kanë rënie të nivelit të këtij treguesi, përveç SHUK Elbasan, e cila krahasuar me vitin paraardhës është përmirësuar me 15.6%, por gjithsesi mbeten në nivelin e performancës së dobët të shoqërive. Vlen të theksohet SHUK Kukës gjatë vitit paraardhës ka patur një performancë të mbulimit të kostove O&M me 95.5%, por gjatë vitit 2024 ka pësuar një rënie në 75.8 % të këtij treguesi, e cila e klasifikon në zonën e performancës së dobët. Performanca e SHUK Kukës ka rënie për shkak të rritjes së lartë të kostos së operimit me 39.6 milion lekë përkundërt rritjes së të ardhurave totale nga aktiviteti me 10.9 milion, si rezultat i rritjes së totalit të faturuar ITUN.

Në zonën e performancës së pranueshme (80%-100%) janë gjashtë shoqëri SHUK Shkodër (80.8%), SHUK Gjirokastrë (84.3%), SHUK Dibër (88.9%), SHUK Kamëz (91.2%), SHUK Sarandë dhe SHUK Vlorë (96.5%), SHUK Durrës (97.6%) dhe SHUK Lushnje (98.3%) ku vërehet se këto tetë shoqëri kanë pësuar një rritje të nivelit të treguesit mbulimi i kostove O&M. SHUK Vlorë ka rritje të të ardhurave me 63% në krahasim me vitin 2023 si rezultat i rritjes së totalit nga faturimi dhe rritje të kostos direkte për operim me 9.9%.

Mbulimi i kostove të O&M për vitin 2024 ka një përmirësim, i cili është 107.6% nga 100.5% që ishte në vitin 2023. Kjo situatë ka ardhur si rrjedhojë rritjes së të ardhurave nga aktiviteti me rreth(9.4%) 983.4 milion lekë, dhe rritjes së kostove operative me (2.2%) 229.57 milion lekë .

Tabela nr. 15 paraqet ecurinë e treguesit mbulimi i Kostove O&M për tre vitet e fundit.

Tabela nr.15. Ecuria e Treguesit Mbulimi i Kostove O&M (në %)

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024-2023
1	Vlorë	UK	66.20	64.90	96.50	31.60
2	Durrës	UK	56.10	74.20	97.60	23.40
3	Elbasan	UK	65.30	63.70	79.30	15.60
4	Korçë	UK	127.90	121.10	135.60	14.50
5	Lezhë	UK	78.90	89.40	103.60	14.20
6	Kamëz	UK	66.40	83.30	91.20	7.90
7	Berat	UK	102.60	107.00	114.50	7.50
8	Shkodër	UK	64.20	75.00	80.80	5.80
9	Lushnje	UK	72.00	94.80	98.30	3.50
10	Pogradec	UK	103.10	101.60	104.90	3.30
11	Gjirokastrë	UK	83.50	85.50	84.30	-1.20
12	Fier	UK	67.30	81.40	77.20	-4.20
13	Vorë	UK	74.40	51.30	45.40	-5.90
14	Tiranë	UK	155.70	161.20	149.80	-11.40

15	Dibër	UK	94.80	101.10	88.90	-12.20
16	Kukës	UK	87.80	95.50	75.80	-19.70
17	Sarandë	UK	96.50	118.50	96.50	-22.00

Ecuria e shoqërive UK për periudhën 2022-2024 pasqyron një prirje rritëse të këtij treguesi në nivel mesatar (nga 90.3% në vitin 2022 në 100.5% në vitin 2023 në 107.6% në vitin 2024). Krahasoni i këtij treguesi ndër vite mundëson vlerësimin e performancës ekonomike dhe efektivitetit të menaxhimit.

Gjatë vitit 2024 krahasuar me vitin 2023 kanë pasur përmirësim një pjesë e madhe e shoqërive. Një pjesë e shoqërive kanë një rënie të lehtë përveç SHRUK Sarandë e cila ka pasur një rënie të theksuar me 22%, për shkak të rritjes së lartë të kostos së operimit me 88.4 milion lekë përkundërt rritjes së të ardhurave totale nga aktiviteti me 22.2 milion, si rezultat i rritjes së totalit të faturuar UK.

Ecurinë me rritjen më të lartë e kryeson SHRUK Vlorë (+31.6%), sepse ka rritje të të ardhurave me 63% në krahasim me vitin 2023 si rezultat i rritjes së totalit nga faturimi dhe rritje të kostos totale direkte për operim me 9.9%, pasuar nga SHRUK Durrës (+23.4%), për shkak të rënies së kostove operative me 13%, kurse të ardhurat nga faturimi janë rritur me 18.3%, SHRUK Elbasan ka rritje (+15.6%) për shkak të rënies së kostove me 11.4% dhe rritjes të të ardhurave me 10.2%, SHRUK Korçë ka rritje (14.5%) për shkak të rritjes të të ardhurave me 4.2% dhe rënies të kostove me 6.9%, gjithashtu dhe shoqëria SHRUK Lezhë ka rritje(+14.2%) për shkak të rritjes të të ardhurave me 15.8%. Shoqëritë e tjera janë me rritje më të lehtë.

Përfundime

- Nga analiza e treguesit “Mbulimi i Kostove O&M” për shoqëritë rezulton se niveli i mbulimit të kostove O&M për vitin 2024 është 107.6%, duke shënuar rritje me 7.1% krahasuar me vitin 2023. Ky përmirësim i nivelit të këtij treguesi ka ardhur si rezultat i rritjes në përqindje të të ardhurave dhe rritje së lehtë të kostove O&M, të ardhurat rriten me 9.4% dhe kostot rriten me 2.2%.
- “Mbulimi i Kostove O&M” për sektorin përbën problem të performancës së sektorit pasi në fakt 5 shoqëri nga totali prej 17 arrijnë të mbulojnë mbi 100% të kostove O&M. Ndërkohë janë 8 shoqëri në nivelin e mbulimit 80%-100% dhe 4 shoqëri në nivelin nën 80%.
- Për vitin 2024 në sektor rezultojnë 10 shoqëri me tendencën pozitive të këtij treguesi që përbëjnë rreth 58.8% të shoqërive në sektor dhe 7 shoqëri me tendencë negative që përbën rreth 41.2% të shoqërive në sektor, kjo është arsyeja që niveli i mbulimit të kostos OM për sektorin është me rritje 7.1% në krahasim me vitin paraardhës.
- Nevoja për subvencione është evidente për sektorin UK për mbulimin e kostove O&M, por me rajonalizimin e shoqërive UK në kuadër të reformës, është reduktuar, pasi shoqëritë në vështirësi financiare janë bashkuar duke ndikuar pozitivisht në treguesit financiarë të performancës në të ardhmen.
- Mbulimi i Kostove O&M është elementi bazë në propozimet e shoqërive rajonale për tarifa të reja duke argumentuar në mënyrë të detajuar kostot, si edhe ti raportojnë shpenzimet sipas qendrave të kostos për të orientuar tarifat tek kostot e secilit shërbim më vete. Detajimi i kostove shërben edhe si një element bazë për transparencën ndaj konsumatorëve.

2.2.3 Mbulimi i Kostove Totale

Mbulimi i Kostove Totale për vitin 2024 për të gjithë sektorin UK raportohet në nivelin 83.2% nga 72.8% që ishte në vitin 2023.

Nga 17 shoqëri, 14 prej të cilave janë shoqëri SHRUK dhe tre prej të cilave janë UK që operojnë në sektor, vetëm dy shoqëri arrijnë të mbulojnë kostot totale të operimit me të ardhurat nga aktiviteti, përkatësisht SHUK Tiranë, në nivelin 113.4% dhe SHRUK Korçë, në nivelin 101.1%.

Në nivelin e performancës (50%-80% e mbulimit të kostos totale) raportohen 11 shoqëri, ndërsa në nivelin e performancës së mirë (mbi 80% e mbulimit të kostos totale) raportohen vetëm 5 shoqëri, dy prej të cilave e kanë nivelin e mbulimit mbi 100% (SHUK Tiranë, SHRUK Korçë).

Është një shoqëri SHUK Vorë, që bën pjesë në brezin e performancës së dobët (44%), me mbulimin e kostove totale deri në 50%. SHUK Vorë, por edhe SHRUK Kukës, e cila me të ardhurat e saj nuk mund të mbulojë as kostot e punës janë subjekt i subvencioneve të qeverisë qëndrore.

Janë 10 shoqëri që kanë pasur tendencë pozitive (mbi 5% rritje) në drejtim të mbulimit të kostove totale me të ardhurat nga aktiviteti krahasuar me vitin 2023 që kanë qënë 12 shoqëri. Kjo tendencë varion nga 5.5% SHUK Tiranë, në 26.2% SHRUK Korçë, ndërsa numri i shoqërive nga -5%) deri në 5% raportohen 4 shoqëri. Tendencë negative konstatohet në 3 shoqëri me rënie të konsiderueshme të nivelit të këtij treguesi nga -5.1% në -35.3%.

Kostot totale në sektor për vitin 2024 kanë rënie me 603.4 mln lekë ose 4.2% krahasuar me vitin 2023. Ndërsa, të ardhurat e sektorit kanë shënuar një rritje me rreth 1% ose në vlerë 104.2 milion lekë krahasuar me vitin paraardhës ku peshën kryesore të kësaj rritje e ka SHRUK Durrës me rreth 97%.

Treguesi Mbulimi i Kostove Totale (83.2%) i cili ka një rritje me 10.37% krahasuar me një vit më parë paraqitet në nivele të qëndrueshme, për shkak se kemi rënie të kostove totale me 4% dhe kemi rritje të të ardhurave nga aktiviteti me 9%.

Tabela nr.16: Ecuria e Mbulimit të Kostove Totale

(në %)

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024-2023
1	Korçë	UK	79	74.9	101.1	26.2
2	Vlorë	UK	65	46.4	70	23.6
3	Durrës	UK	48	60	83.2	23.2
4	Lushnje	UK	52	50.3	65.8	15.5
5	Shkodër	UK	41	48	59.9	11.9
6	Lezhë	UK	45	52.8	63.9	11.1
7	Elbasan	UK	54	55.2	66.1	10.9
8	Kukës	UK	63	57.8	64.8	7.0
9	Kamëz	UK	29	65	71.5	6.5
10	Tiranë	UK	116.3	107.9	113.4	5.5
11	Pogradec	UK	48	54.8	59.8	5.0
12	Gjirokastër	UK	67	60.8	62.2	1.4
13	Vorë	UK	72	46.5	44	-2.5
14	Fier	UK	58	69.1	66.5	-2.6
15	Dibër	UK	83	90	82.5	-7.5
16	Sarandë	UK	65	80.7	70.2	-10.5
17	Berat	UK	78	103	87.6	-15.4

2.2.4 Norma e Arkëtimit

Norma e Arkëtimit është shprehja në përqindje e shumës së arkëtuar ndaj shumës së faturuar për shërbimet e ofruara ujësjellës-kanalizime. Ky tregues paraqet efektivitetin e shoqërisë për të garantuar likuiditetin e saj dhe varet kryesisht nga faktorë manaxherial.

Në analizën e shoqërive rajonale llogariten treguesi Norma e Arkëtimit Korente (NAK) që tregon arkëtimet e shitjeve të shërbimeve UK për vitin 2024, si dhe treguesi Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (NAP) ku përfshihen dhe arkëtimet e debive përpara vitit raportues.


Për vitin 2024, NAK rezulton 84.6% kundrejt 83.9% që ishte në vitin 2023, me një rritje prej 0.7%. Kjo tregon për një ecuri pozitive të këtij treguesi, i cili me gjithë nivelin e rritur të çmimeve gjatë vitit 2024 si rezultat i inflacionit është rritur, duke treguar kështu ndërgjegjësimin e konsumatorëve në drejtim të pagesës së faturës së ujit të konsumuar.

Shoqëritë, krahas arkëtimit të faturave korente, bëjnë përpjekje edhe për mbledhjen e debive të prapambetura duke përdorur mekanizma, si lidhja e akt - marrëveshjeve shoqëri – klient, për pagesën e tyre me këste.

Në mbyllje të vitit 2024 rezulton se nga debitë e prapambetura janë arkëtuar rreth 2.051 miliardë lekë ku NAP raportohet e dobët me 0.9% dhe paraqitet në nivelin 102.6% nga 103.5% Në analizën e shoqërive, fokusi është NAK, pasi efienca në mbledhjen e të ardhurave korente është elementi kryesor i qëndrueshmërisë financiare të shoqërisë, që gjithashtu rrit mundësinë e shlyerjes së debive të vjetra.

Gjatë vitit 2024, shoqëritë rajonale UK dhe ato UK janë munduar të përmisojnë këtë tregues, duke shtuar kontrolle me anë të task forcës duke marrë masa deri në ndërprerjen e furnizimit me ujë të konsumatorëve debitor ku krahas faturave korente duhet të paguajnë edhe faturat e prapambetura.

Grafiku nr. 4: Norma e Arkëtimit Korente, Viti 2024



Për vitin 2024, ku bëjnë pjesë 17 shoqëri UK që operojnë në sektor, rezultojnë me performancë të mirë 6 shoqëri rajonale SHUK dhe 2 shoqëri UK pra me një normë arkëtimi korente mbi 82%, që janë:

SHRUK Lezhë (95.60%), SHRUK Lushnje (93.80%), SHUK Tiranë (93.00%), SHRUK Berat (92.80%), SHRUK Durrës (87.90%), SHRUK Korçë (87.20%) dhe SHUK Vorë (84.80%), SHRUK Gjirokastrë (84.40%). Vihet re një përmirësim i lehtë i normës së arkëtimit korentë për SHRUK Lezhë, SHRUK Lushnje, SHUK Tiranë dhe SHRUK Berat.

Në brezin e performancës së pranueshme, me normë arkëtimi korentë 60% - 82% përfshihen 7 shoqëri SHRUK dhe 1 shoqëri UK përkatësisht: SHUK Kamëz (77.90%), SHRUK Shkodër (75.40%), SHRUK Pogradec (72.80%), SHRUK Fier (72.00%), SHRUK Vlorë (70.70%), SHRUK Kukës (70.00%), SHRUK Elbasan (69.10%), SHRUK Dibër (64.80%). Nga këto shoqëri konstatohet se 5 prej tyre e kanë përmirësuar këtë tregues krahasuar.

Ndërsa, SHRUK Sarandë ka ulur performancën lidhur me arkëtimin korent të debive, duke rënë në brezin me performancë të dobët, me normë arkëtimi 60.20%. SHRUK Sarandë vazhdon edhe për vitin 2024 të ketë një performancë të dobët të normës së arkëtimit korent në 60.20%, e cila edhe pse ka një rritje prej 2% të këtij treguesi është shoqëria me normën më të ulët.

Tabela nr.17: Ecuria e Normës së Arkëtimit Korente

(në %)

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024-2023
1	Kukës	UK	64.1	47.6	70.0	22.4
2	Gjirokastrë	UK	70.3	67.1	84.4	17.3
3	Korçë	UK	83.1	74.0	87.2	13.2
4	Lushnje	UK	78.6	81.6	93.8	12.2
5	Durrës	UK	73.9	79.7	87.9	8.2
6	Lezhë	UK	86.5	89.5	95.6	6.1
7	Shkodër	UK	72.9	69.4	75.4	6.0
8	Vlorë	UK	68.5	65.5	70.7	5.2
9	Berat	UK	89.5	90.4	92.8	2.4
10	Sarandë	UK	56.2	58.2	60.2	2.0
11	Kamëz	UK	66.7	76.6	77.9	1.3
12	Elbasan	UK	66.4	68.0	69.1	1.1
13	Fier	UK	72.8	74.4	72.0	-2.4
14	Tiranë	UK	92.6	97.4	93.0	-4.4
15	Vorë	UK	94.2	93.7	84.8	-8.9
16	Pogradec	UK	91.5	90.1	72.8	-17.3
17	Dibër	UK	79.9	82.6	64.8	-17.8

Referuar tabelës së mësipërme, nga 14 shoqëri rajonale dhe 3 ujësjellës kanalizime të analizuara, 12 prej tyre kanë shënuar përmirësim të treguesit NAK, krahasuar me vitin 2023, ku progresin më të madh e ka shënuar SHRUK Kukës me +22.40%, SHRUK Gjirokastrë me +17.30%, SHRUK Korçë me +13.20% dhe SHRUK Lushnje me +12.20%. Ndërkohë, pjesa tjetër e shoqërive, 8 shoqëri bëjnë pjesë në grupin që kanë shënuar rënie të këtij treguesi, ku rënien më të madhe e ka SHRUK Pogradec (-17.30%), ky ndryshim vjen si rritje e faturës korentë dhe zonat që janë shtuar sipas rajonalizimit dhe SHRUK Dibër me -17.80%, janë ulur arkëtimet. Për vitin 2022, ka qënë më e dobët për shkak të rajonalizimit dhe marrjes në menaxhim dhe të njëjësive të tjera, por ky përmirësim është i dukshëm në vitin 2024 ku ecurinë më të dukshme e ka SHRUK Kukës në krahasim me vitin 2023. Të gjitha njësitë duhet të rishikojnë strategjitë për arkëtimet në të gjitha zonat. Mbajtja e këtij treguesi në nivel të njëjtë këto dy vitet e fundit mund të konsiderohet si tregues i përmirësuar duke patur parasysh përfshirjen e zonave rurale nën administrimin e shoqërive UK, të cilat në përgjithësi këtë tregues e kanë mjaft nën

mesataren në rang vendi. Pavarësisht nga sa më sipër, shoqëritë duhet të rrisin akoma përpjekjet e tyre për përmirësimin e këtij treguesi si një nga drejtimet kryesore për të rritur qëndrueshmërinë financiare të shoqërive.

Përfundime

- Shoqëritë kanë raportuar për vitin 2024 të dhëna të ndara për secilin tregues. Gjithsesi, edhe për këtë vit ekziston një marzh gabimi në lidhje me treguesin NAK, pasi ka disa shoqëri rajonale dhe ujësjellës-kanalizime që ende konsiderojnë dhe i raportojnë debitë e krijuara gjatë vitit, si shlyerje të debive të prapambetura, por që në fakt ato likuidohen nga klientët brenda vitit
- Për vitin 2024, vërehet se shoqëritë rajonale UK dhe ato ekzistuese në përgjithësi kanë shënuar përmirësim të këtij treguesi, ku 8 prej tyre kanë pësuar regres referuar nivelit të arkëtimit të të ardhurave korente.
- Shoqëritë UK duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë arkëtimit të faturave korente si dhe mbledhjes së debive të prapambetura si një mjet i nevojshëm që lidhet direkt me qëndrueshmërinë e tyre financiare.

2.2.5 Niveli i Matjes


Për vitin 2024 ky tregues është 87.9 % duke pësuar një rritje prej 1.4 %, krahasuar me vitin 2023, i cili ka qenë 86.5 %. Ndërsa krahasuar me vitin 2022 ka një rritje prej 5.1 %, por që mbetet në nivele shumë të ulëta përmirësimi. Deri më tani, asnjë shoqëri UK nuk raporton të pajisur 100 % të konsumatorëve me matës. Për këtë vit nga 17 shoqëri, 10 prej tyre janë mbi kufirin e performancës së mirë, mbi 85 % nivelin e matjes.

Treguesi “Niveli i Matjes” është një ndër treguesit që ka patur trend në përmirësim në vite. Gjatë vitit 2024, shoqëritë UK kanë raportuar instalimin e 38,857 ujëmatësave më shumë se viti paraardhës, duke qëndruar në nivelet e performancës së mirë mbi 85 %. Numri i lidhjeve me matës në rang sektori ka shkuar 861,637 lidhje nga 980,514 lidhje UK që janë në total në të gjithë shoqëritë. Po ta krahasojmë me vitin 2023 numri i lidhjeve me matës është rritur me 78,719 lidhje. Sektori ende vazhdon të faturojë aforfe 4,154 klientë privat dhe institucione, ndërkohë që procesi i instalimit të matësve, në kategorinë klientë jo familjarë të financuara nga vetë klientët, duhet të kishte përfunduar në zbatim të VKM-së nr. 236, datë 10.5.1993 dhe VKM-së nr. 96, datë 21.2.2007.

Megjithëse ka përmirësim të treguesit, ende 7 shoqëri (Fier, Vorë, Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë, Dibër dhe Kukës) janë nën nivelin 85 %, mbetet ende shumë punë për të bërë për të arritur në nivel të performancës së mirë. SHRUK Kukës ka treguesin më të ulët përse i përket nivelit të matjes me 58 %.

ERRU thekson vazhdimisht nevojën e instalimit të matësve në të gjithë komponentët kyç të sistemeve të furnizimit me ujë dhe konsumatorëve individualë, por për këtë kërkohet edhe mbështetja me financime nga qeveria qendrore. Konsumatorët duhet të paguajnë për sasinë reale të ujit të konsumuar prej tyre, prandaj pajisja me ujëmatës e gjithë sistemit mbetet një nga objektivat kryesorë të shoqërive dhe një element që lehtëson problemet e menaxhimit të kërkesës për ujë dhe uljes së shpërdorimeve të mbikonusimit të tij.

Grafiku nr. 5: Niveli i Matjes, Viti 2024



Shoqëritë që paraqesin trend pozitiv në përmirësim të këtij treguesi, sipas grafikut të mësipërm janë 10 shoqëri të cilat kanë nivelin matjes mbi 85%, kufiri i performancës së mirë, SHUK Lushnje (99.8 %), SHUK Korçë (96.5 %), SHUK Pogradec (96.4%), SHUK Sarandë (95.2%), SHUK Durrës (94.3 %), SHUK Berat (92.2 %), SHUK Tiranë (91.4 %), SHUK Elbasan (90.6 %), SHUK Lezhë (85.5 %) dhe SHUK Kamëz (85.3 %). Krahasuar me vitin 2023, vërehet se tek të gjithë shoqëritë ky tregues është përmirësuar në vlera të njëjta, përjashtuar SHUK Lezhë që ka një përmirësim të ndjeshëm me +11.10 % duke bërë të mundur dhe kalimin tek kufiri i performancës së mirë mbi 85 %. Ulje të lehtë të këtij treguesi ka vetëm SHUK Vorë (-1.3 %).

Po të shohim ecurinë nga viti 2022 rritje të nivelit të matjes kanë SHUK Lezhë me 15.1 %, SHUK Dibër me 11.80 %, SHUK Durrës me 9.7 % dhe SHUK Pogradec me 9.00%.

Në tabelën nr. 18, jepet ecuria për treguesin e nivelit të matjes për tre vitet e fundit.

Tabela nr.18: Ecuria e Nivelit të Matjes

(në%)

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024-2023
1	Lezhë	UK	70.40	74.40	85.50	11.10
2	Vlorë	UK	67.80	71.20	73.80	2.60
3	Durrës	UK	84.60	91.80	94.30	2.50
4	Pogradec	UK	87.40	94.00	96.40	2.40
5	Shkodër	UK	74.30	74.90	77.00	2.10
6	Sarandë	UK	91.60	93.40	95.20	1.80
7	Berat	UK	86.90	90.60	92.20	1.60
8	Elbasan	UK	85.10	89.00	90.60	1.60
9	Fier	UK	74.70	80.60	81.20	0.60
10	Tiranë	UK	90.30	90.90	91.40	0.50
11	Gjirokastrë	UK	65.70	70.50	71.00	0.50

12	Korçë	UK	91.80	96.20	96.50	0.30
13	Lushnje	UK	99.20	99.60	99.80	0.20
14	Kamëz	UK	79.80	85.10	85.30	0.20
15	Diber	UK	54.20	66.00	66.00	0.00
16	Kukës	UK	57.30	58.20	58.00	-0.20
17	Vorë	UK	79.30	79.90	78.60	-1.30

Përfundime

- Matja e konsumit të ujit paraqet domosdoshmëri për mirëmanaxhimin e aktivitetit të shoqërisë. Vlerat e larta të treguesit të nivelit të matjes çojnë rrjedhimisht në uljen e nivelit të shpërdorimit të ujit, duke ulur kërkesën për ujë, rritur orët e furnizimit me ujë, pra përmirëson cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve.
- Për vitin 2024, mesatarja e treguesit niveli i matjes për sektorin është 87.9 % me një rritje prej 1.4 %, krahasuar me vitin 2023 dhe me një rritje prej 5.1 %, krahasuar me vitin 2022 i cili ka qënë 82.8 %. Pavarësisht ecurisë, sërish kërkon shumë angazhim nga ana e disa prej shoqërive për të përmbushur objektivin prej 85 % për nivelin e performancës së mirë të vendosur nga ERRU. Matja e konsumit të ujit ul nivelin e shpërdorimit të ujit që aktualisht shton në mënyrë domethënëse humbjet financiare të shoqërive dhe gjithashtu i krijon mundësi shoqërive të përshtatin prodhimin me kërkesën për ujë.
- Në total janë 17 shoqëri, nga të cilat 14 janë shoqëri rajonale dhe 3 Shoqëri UK. Mbi nivelin e performancës së mirë përsa i përket shërbimit të matur me mbi 85 % janë 10 shoqëri: SHRUK 99.8 %, SHRUK Korçë 96.5 %, SHRUK Pogradec 96.4%, SHRUK Sarandë 95.2%, SHRUK Durrës 94.3 %, SHRUK Berat 92.2 %, SHUK Tiranë 91.4 %, SHRUK Elbasan 90.6 %, SHRUK Lezhë 85.5 % dhe SHUK Kamëz 85.3 %.
- Për të dytin vit rradhazi, nivelin me të ulët të matjes e ka SHRUK Kukës me 58 %. Shoqëria duhet të ndërmarrë një angazhim serioz në përmirësimin e këtij treguesi për të bërë të mundur eliminimin e praktikës aforfe, si dhe pajisjen 100% me matësa të konsumatorëve privat.
- Gjatë vitit 2024, shoqëritë UK kanë raportuar instalimin e 38,857 matëseve të rinj, kështu numri i lidhjeve me matës në rang sektori ka shkuar 861,637 lidhje nga 980,514 lidhje UK. Po ta krahasojmë me vitin 2023, numri i lidhjeve me matësa është rritur me 78,719 lidhje. Sektori ende vazhdon të faturojë aforfe 4,154 klientë privat dhe institucione per vitin 2024 nga 5100 klientë privat dhe institucione qe ishin per vitin 2023, ndërkohë që procesi i instalimit të matësve, në kategorinë klientë jo familjarë të financuara nga vetë klientët, duhet të kishte përfunduar në zbatim të VKM-së nr. 236, datë 10.5.1993 dhe VKM-së nr.96, datë 21.2.2007.
- Mesatarja e sektorit për vitin 2024 me 87.9 % është arritur mbi nivelin e performancës së mirë 85% të vendosur nga ERRU për sektorin por sërish duhet një angazhim më i mirë nga ana e shoqërive pasi dhe rritjet nga viti 2023 janë në nivele shumë të ulta. Nivel matje 100 % nuk raporton asnjë prej shoqërive.

- Krahasuar me vitin 2023 vërehet se tek të gjithë shoqëritë, ky tregues është pothuajse në vlera të njëjta përjashtuar SHRUK Lezhë, e cila ka një përmirësim të ndjeshëm me 11.10 % duke bërë të mundur dhe kalimin tek kufiri i performancës së mirë mbi 85 %. Po të shohim ecurinë nga viti 2022, rritje të nivelit të matjes kanë SHRUK Lezhë me 15.1 %, SHRUK Dibër me 11.80 %, SHRUK Durrës me 9.7 % dhe SHRUK Pogradec me 9.00%.
- Rënie të këtij treguesi, por që janë në vlera të ulta, për vitin 2024 ka raportuar SHUK Vorë me -1.3% dhe SHRUK Kukës me -0.2 %.
- Ndër objektivat kryesorë të shoqërive, si një element që lehtëson mjaft problemet e menaxhimit të kërkesës për ujë dhe uljes së shpërdorimeve dhe të mbi konsumit në sisteme, është pajisja me ujëmatës e gjithë sistemit.
- ERRU, e konsideron procesin e vendosjes së matësve plotësisht të arritshëm nga shoqëritë UK, si dhe mbështet e nxit të gjitha shoqëritë për hartimin dhe zbatimin e programeve për instalimin e matësve individual.

2.2.6 Eficenca e Stafit

Treguesi i efencës së stafit është një tregues mjaft i rëndësishëm pasi lidhet direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë, dhe kostoja e personelit është zëri që zë përqindjen më të madhe prej 55% të kostove O&M.

Treguesi i efencës së stafit paraqet raportin e numrit të punonjësve të shoqërisë mbi totalin e numrit të lidhjeve të ujësjellës kanalizimeve të ujërave të ndotura që administron shoqëria.

Treguesi i Eficencës së Stafit analizohet duke përfshirë numrin e stafit sipas organigramës së shoqërisë. Kjo mënyrë krahasimi është vendosur nga ERRU me qëllim vendosjen e të gjitha shoqërive UK në të njëjtën bazë krahasimi për performancën e këtij treguesi.


Efikasiteti i stafit nënkupton që shoqëritë të mos kenë njerëz në organikën e tyre që nuk justifikojnë pozicionin e punës që presupozohet të kryejnë. Për vitin 2024, sektori ka operuar me 14 punonjës më shumë, por përsëri sektori paraqitet i mbingarkuar me staf të pajustifikuar që në mjaft raste janë të punësuar pa arsimin dhe kualifikimet përkatëse.

Sektori për vitin 2024 raporton se e ka zhvilluar aktivitetin me një staf prej 7616 punonjësish nga 7602 punonjës që janë raportuar në vitin 2023 dhe 7815 punonjës në vitin 2022, ndërkohë që edhe numri i lidhjeve të ujit është rritur me 29,320 lidhje dhe ai i kanalizimeve me 24,041 lidhje duke dhënë kështu impakt pozitiv në përmirësimin e këtij treguesi, i cili për vitin 2024 është 4.43 punonjës për 1000 lidhje nga 4.56 që ishte në vitin 2023 dhe 4.73 që ishte në vitin 2022.

Duke marrë parasysh specifikat e operimit dhe shërbimit të shoqërive si shtrirjen e shërbimit UK, numrin e sistemeve të furnizimit me ujë e të tjera arsye, ERRU ka vendosur nivel të diferencuar të objektivit të performancës së mirë për shoqëritë.

ERRU, nisur nga fakti se tashmë në sektor operojnë shoqëri rajonale UK të cilat kanë mundësitë dhe kapacitetet për një menaxhim më të mirë të stafeve objektivat e vendosura në grupin e parë të shoqërive të cilat i korrespondojnë shoqërive të mëdha. Kështu, performanca konsiderohet shumë e mirë deri në 4 punonjës për 1000 lidhje, performancë e pranueshme 4-6 punonjës për 1000 lidhje, dhe mbi 6 punonjës për 1000 lidhje performancë e dobët.

Grafiku nr. 6: Eficenca e Stafit, Viti 2024



Në këtë grafik, në zonën e performancës së mirë renditen dy shoqëri: SHUK Tiranë me 2.60 punonjës për 1000 lidhje dhe SHUK Korçë me 2.82 punonjës për një 1000 lidhje. Vërejmë SHUK Vlorë me 3.92 punonjës për 1000 lidhje që ka kaluar nga zona e performancës së mirë në zonën e performancës së pranueshme.

Në zonën e performancës së pranueshme sipas grafikut paraqiten 8 shoqëri SHUK Pogradec me 4.78 punonjës për 1000 lidhje, SHUK Kamëz me 4.88 punonjës për 1000 lidhje, SHUK Berat me 4.94 punonjës për 1000 lidhje, SHUK Durrës me 5.03 punonjës për 1000 lidhje, SHUK Lushnjë me 5.26 punonjës për 1000 lidhje, SHUK Lezhë me 5.27 punonjës për 1000 lidhje, dhe SHUK Sarandë me 5.42 punonjës për 1000 lidhje, SHUK Shkodër me 5.81 punonjës për 1000 lidhje.

Në zonën e performancës me më shumë se 6 punonjës për 1000 lidhje kemi 5 shoqëri, SHUK Fier me 6.26 punonjës, SHUK Gjirokastrë me 6.44 punonjës për 1000 lidhje, SHUK Elbasan me 6.60 punonjës për 1000 lidhje, SHUK Dibër me 6.61 punonjës për 1000 lidhje, SHUK Kukës me 8.73 punonjës për 1000 lidhje.

Në zonën e performancës me më shumë se 10 punonjës për 1000 lidhje kemi 1 shoqëri, SHUK Vorë me 11.59 punonjës per 1000 lidhje.

Shoqëria me ecurinë më të mirë paraqitet SHUK Kukës nga 9.42 punonjës për 1000 lidhje në 6.86 ose -2.56 punonjës për 1000 lidhje duke vijuar më tej me 10 shoqëri të tjera, të cilat kanë patur tendencë pozitive, nga SHUK Gjirokastrë -0.99 punonjës për 1000 lidhje deri tek SHUK Shkodër -0.21 punonjës për 1000 lidhje. Tre shoqëri janë pothuajse në të njëjtin nivel me vitin paraardhës, SHUK Durrës dhe SHUK Berat me -0.04 punonjës për 1000 lidhje, si dhe UK Tiranë me vetëm -0.01 punonjës për 1000 lidhje.

Ndërkohë që 3 shoqëri paraqiten me përkeqësim të këtij treguesi dhe janë SHUK Sarandë + 0.39 punonjës për 1000 lidhje, SHUK Elbasan me + 0.15 dhe SHUK Kamëz me +0.01 punonjës për 1000 lidhje.

Tabela nr. 19 paraqet ecurinë e treguesit të Eficencës së Stafit të shoqërive për dy vitet e fundit.

Tabela nr. 19: Ecuria e Eficencës së Stafit për Shoqëritë (staf/1000 lidhje)

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024-2023
1	Shkodër	UK	6.50	6.29	5.81	-0.48
2	Gjirokastrë	UK	7.82	6.83	6.44	-0.39
3	Elbasan	UK	6.82	6.97	6.60	-0.37
4	Pogradec	UK	5.42	5.13	4.78	-0.35
5	Berat	UK	5.30	5.26	4.94	-0.32
6	Durrës	UK	5.29	5.25	5.03	-0.22
7	Sarandë	UK	5.24	5.63	5.42	-0.21
8	Lezhë	UK	5.73	5.45	5.27	-0.18
9	Korçë	UK	3.19	2.96	2.82	-0.14
10	Vorë	UK	12.08	11.70	11.59	-0.11
11	Lushnje	UK	6.06	5.34	5.26	-0.08
12	Fier	UK	6.92	6.34	6.26	-0.08
13	Tiranë	UK	2.64	2.63	2.60	-0.03
14	Kamëz	UK	4.78	4.79	4.88	0.09
15	Vlorë	UK	4.26	3.77	3.92	0.15
16	Dibër	UK	6.57	6.28	6.61	0.33
17	Kukës	UK	9.42	6.86	8.73	1.87

SHRUK Kukës ka ecurinë më të madhe negative (+ 1.87) punonjës për 1000 lidhje, edhe pse numri i punonjësve është reduktuar pak, sërish ka një përkeqësim të vogël të treguesit si rrjedhojë e numrit të lidhjeve, SHRUK Dibër me +0.33 punonjës për 1000 lidhje si rezultat i shtimit të numrit të punonjësve me 21 punonjës gjatë vitit 2024, SHRUK Vlorë ka një përkeqësim thuajse të papërfillshëm me + 0.15 punonjës për 1000 lidhje dhe SHUK Kamëz me +0.09.

Pjesa tjetër e shoqërive përgjithësisht kanë tendencë të vogël pozitive duke filluar nga SHUK Tirana +0.03, etj.

Përfundime

- Në mbyllje të vitit 2024, treguesi staf për 1000 lidhje ka një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin paraardhës nga 4.56 në 4.43 punonjës për 1000 lidhje.
- Agregimi i sektorit UK duket se ka dhënë impaktin e tij në uljen e treguesit të efikencës së stafit nën nivelin e 7 punonjës për 1000 lidhje UK me përjashtim të SHUK Vorë e cila e ka këtë tregues 11.5 punonjës për 1000 lidhje UK pasi është ende një shoqëri e paagreguar.
- Ulja e numrit të punonjësve me 14 punonjës në rang sektori dhe rritja e lidhjeve UK me rreth 29,340 lidhje uji dhe 24,041 lidhje KUN, kanë dhënë një përmirësim të performancës së këtij treguesi.
- Nevoja për përmirësimin e këtij treguesi ka rëndësi të veçantë pasi lidhet me objektivin strategjik të sektorit për të arritur qëndrueshmëri financiare ku përmirësimi i efikencës së stafit është një nga elementet thelbësorë për përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive UK. Ulja e numrit të punonjësve ka dhënë efektin e saj pozitiv në përmirësimin e këtij treguesi, por përsëri kostot e punës zënë peshën kryesore në totalin e kostove O&M me 55%.

- ERRU, në mënyrë të vazhdueshme i kushton një vëmendje të veçantë shqyrtimit të organigramës së stafit të shoqërive UK kur ato paraqesin aplikime për tarifa të reja duke u treguar agresive në vendosjen e objektivit për secilën shoqëri në mënyrë që ato të jenë të justifikuara në numër punonjësish, pozicione dhe përshkrime të punës për secilin prej tyre.
- Motivimi dhe trajnimi i stafeve në drejtim të rritjes së kapaciteteve profesionale duhet të jetë në fokusin e shoqërive UK pasi do të ndikonte në mirëfunksionimin dhe zhvillimin e shoqërive.

2.2.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë


Kohëzgjatja e furnizimit me ujë është një nga treguesit më të rëndësishëm, pasi konsumatorët reagojnë më shpejt kundrejt kohëzgjatjes së furnizimit me ujë dhe cilësisë së tij. Ky tregues lidhet me aftësinë e shoqërisë për të mbajtur rrjetin e shpërndarjes nën një presion të caktuar shërbimi në mënyrë që t'u japë konsumatorëve të saj shërbimin në mënyrë të vazhdueshme dhe pa ndërprerje. Faktorët kryesorë që shkaktojnë këtë vazhdimësi të furnizimit me ujë janë humbjet e ujit nga mbi konsumi i pamatur si pasojë e faturimit aforfe, nga lidhjet e paligjshme dhe nga humbjet teknike në rrjet.

Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë në ditë për vitin 2024 është 17.44 orë/ditë, me një rritje 1.14 orë/ditë krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka qënë në të njëjtin nivel me vitin 2022 me 16.3 orë/ditë. Objektivi i performancës së mirë të vendosur nga ERRU prej 18 orë në ditë ende nuk është arritur në rang sektori ndërsa për 10 shoqëri ky tregues është mbi 18 orë/ditë të furnizimit me ujë.

Në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, për vitin 2024, kanë operuar 14 shoqëri rajonale UK dhe 3 shoqëri ekzistuese UK që janë: SHUK Tiranë, SHUK Kamëz dhe SHUK Vorë. Riorganizimi i shoqërive në zbatim të VKM-së nr. 302, 11.05.2022, u shoqërua me dinamikën dhe problematikën e saj që reflektohet në treguesit kryesorë të performancës të shoqërive në veçanti dhe sektorit në tërësi.

Gjatë vitit 2024 shoqëria që ka raportuar furnizimin me ujë të pijshëm 24 orë/ditë pa ndërprerje është SHUK Lezhë, e cila për këtë vit ka një rritje me +5.8 orë/ditë. Arsyeja lidhet me vënien në punë të ujësjellësit të ri për zonën e Laçit.

Grafiku nr. 7: Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë, Viti 2024



Shoqëritë që kanë pasur rritjen me të ndjeshme të këtij treguesi për këtë vit janë: SHRUK Sarandë, e cila ka pasur rritje me +11.00 orë/ditë si dhe SHRUK Dibër me +10.00 orë/ditë, pasi për të dy shoqëritë kanë përfunduar investimet e reja dhe si pasojë kanë sjellë impakt pozitiv në treguesit kryesorë. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë varion nga 4 - 24 orë/ditë nga të cilat 10 shoqëri performojnë mbi nivelin e mirë me 18 orë/ditë dhe 7 shoqëri janë nën këtë nivel, duke mos pasur asnjë përmirësim të këtij treguesi krahasuar me vitin 2022 dhe me vitin 2023. Ndërsa shoqëria rajonale UK Vlorë ka një rënie të këtij treguesi me -0.45 orë/ditë. Më problematikë janë dy shoqëritë e parajonalizuara: UK Vorë me 8 orë furnizimi me ujë dhe UK Kamëz me 4 orë furnizimi me ujë, në kufirin e performancës së dobët dhe duhet të punojnë seriozisht që të kenë përmirësim në vitin e ardhshëm.

Paraqitja grafike e mësipërme na mundëson të kuptojmë se cilat nga shoqëritë performojnë mirë në këtë tregues, si të tilla janë SHRUK Lezhë 24 orë/ditë, SHRUK Korçë 23.7 orë/ditë, SHRUK Pogradec 22.5 orë/ditë, SHRUK Dibër 22 orë/ditë, SHRUK Gjirokastër 22 orë/ditë, SHRUK Shkodër 21.55 orë/ditë, SHRUK Berat 22.11 orë/ditë, SHRUK Sarandë 21 orë/ditë, SHRUK Fier 18 orë/ditë dhe SHRUK Elbasan 18 orë/ditë.

Ecuria e këtij treguesi për të shoqëritë për tre vitet e fundit paraqitet në tabelën nr. 20.

Tabela nr.20: Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë (orë në ditë)

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024-2023
1	Sarandë	UK	10.00	10.00	21.00	11.00
2	Dibër	UK	11.50	12.00	22.00	10.00
3	Lezhë	UK	18.00	18.24	24.00	5.76
4	Gjirokastër	UK	18.10	18.00	22.00	4.00
5	Fier	UK	13.10	16.00	18.00	2.00
6	Kukës	UK	12.00	12.00	12.50	0.50
7	Durrës	UK	13.00	12.60	13.00	0.40
8	Lushnje	UK	16.00	16.32	16.69	0.37
9	Berat	UK	22.00	21.76	22.11	0.35
10	Korçë	UK	23.50	23.50	23.70	0.20
11	Pogradec	UK	22.00	22.50	22.50	0.00
12	Shkodër	UK	20.00	21.55	21.55	0.00
13	Elbasan	UK	19.00	18.00	18.00	0.00
14	Tiranë	UK	17.00	17.00	17.00	0.00
15	Vorë	UK	8.00	8.00	8.00	0.00
16	Kamëz	UK	4.00	4.00	4.00	0.00
17	Vlorë	UK	12.60	13.00	12.55	(0.45)

Përfundime

- Përgjatë vitit 2024 konsumatorët shqiptarë janë furnizuar mesatarisht me 17.44 orë ujë në ditë. Krahasuar me vitin paraardhës treguesi ka një rritje prej +1.14 orë/ditë ndërsa për dy vitet 2022, 2023 ky tregues ka qënë i pa ndryshueshëm me 16.3 orë ujë në ditë furnizim me ujë. SHUK Tiranë dhe SHRUK Lushnje furnizojnë me ujë 17 dhe 16.69 orë/ditë, shumë pranë realizimit të objektivit të performancës së mirë përcaktuar nga ERRU 18 orë/ditë, ndërsa 5 shoqëritë e tjera

SHRUK Kukës, Durrës, Vlorë dhe shoqëritë e parajonalizuara SHUK Vorë dhe SHUK Kamëz mbeten shume larg realizimit të këtij objekti, ndaj kërkohet një menaxhim më i mirë të kërkesës për ujë, si dhe nga investimet e pritshme që të përmirësohet situata.

- Në përgjithësi vihet re se shoqëritë, si ato rajonale dhe ato ekzistuese, këtë vit kanë pasur rritje ose nivel të njëjtë të orëve të furnizimit. Përfundim të vetëm SHRUK Vlorë, e cila ka një rënie të këtij treguesi me -0.45 orë/ditë krahasuar me vitin 2023.
- Investimet kapitale vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e situatës së sektorit dhe në oraret e furnizimit me ujë, por eksperiencia e shoqërive me performancë të mirë tregon se arritja e niveleve të pranueshme në oraret e furnizimit nuk varet vetëm nga investimet, por mund të arrihet edhe nëse menaxhohet me profesionalizëm. Shoqëritë duhet të kenë në fokus kryesor gjetjen e rrugës dhe mundësisë për përmirësim të mëtijshme të këtij treguesi dhe arritjen e objektivave strategjike të sektorit në tërësi. Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm, pavarësisht shkaqeve si (furnizimi i ujit me ndërprerje periodike, shpimi i tubave nga lidhjet e paligjshme, mbajtja e ujit në depozita etj.) ndikon edhe në cilësinë e ujit të pijshëm, që lidhet dhe me rrezikun e cenimit të shëndetit të popullatës.
- Shoqërive do t’iu kërkohet t’i vendosin këto objektiva në planet e tyre të biznesit dhe të marrin hapat e nevojshme për të arritur përmirësim duke analizuar edhe treguesit e tjerë të performancës të ndërlidhur me njëri tjetrin, si p.sh. Uji Pa të Ardhura që lidhet ngushtësisht me treguesin e Kohëzgjatjes së Furnizimit me Ujë të konsumatorëve.
- Kërkohet vëmendje nga shoqëritë UK dhe duhet të mbetet prioritet, ofrimi i vazhdueshëm i shërbimit për konsumatorët, pasi me arritjen e standardeve të kërkuara për këtë tregues, shoqëritë përmirësojnë shërbimin ndaj konsumatorëve, rrisin të ardhurat e tyre dhe ulin kërkesën e konsumatorëve për burime të tjera të furnizimit me ujë.

2.2.8 Mbulimi me Kanalizime

Treguesi “Mbulimi me KUN” si një ndër indikatorët kryesorë të objektivave strategjike për sektorin UK raportohet dhe monitorohet rregullisht. Kështu, për vitin 2024 ky indikator ka shënuar një rritje respektivisht me **2.2%** krahasuar me vitin 2023. Popullsia në zonën e juridiksionit, për vitin 2024, për 17 shoqëritë UK, raportohet **rreth 4,446,331** banorë, nga të cilët kanë akses në shërbimin e grumbullimit të ujërave të ndotura 2,535,858 banorë ose e shprehur në lidhje me KUN rreth **738,854 lidhje**. Ky tregues ka një rritje të lehtë, pasi shërbimi me kanalizime raportohet të jetë shtuar me rreth 7,616 lidhje, duke çuar mbulimin në 57% mbulimin me këtë shërbim, nga 54.8% në vitin 2023.

Mesatarja e këtij treguesi në rang vendi në nivelin 57 %, tregon që ky shërbim është larg objektivit të performancës së mirë 75% të vendosura nga ERU.


Mbulimi i shërbimit me KUN dhe ITUN mbetet sfidë për sektorin UK për t’u realizuar në të ardhmen duke pasur parasysh që është edhe një nga kërkesat që duhen plotësuar në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, të realizimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të mijëvjeçarit si dhe zhvillimin e turizmit sipas standardeve evropiane. Domosdoshmëria e ndërtimit të impianteve të reja

dhe vënia në punë me kapacitet të plotë e impianteve të ndërtuara apo rivënia në punë e atyre që janë jashtë funksionit, shoqëruar kjo me rrjet KUN të lidhura me këto impiante, do të rrisë ndjeshëm cilësinë e këtij shërbimi duke krijuar njëkohësisht mbrojtje më të madhe në mjedis. Aktualisht vetëm 5 shoqëri rajonale UK kanë në funksionim impiant trajtimi të ujërave të ndotura, përkatësisht SHRUK Korçë, SHRUK Pogradec, SHRUK Durrës, SHRUK Lezhë, SHRUK Shkodër, të cilat janë të licencuar nga ERRU për të ofruar këto shërbime.

ERRU rekomandon që shoqëritë rajonale UK duhet të inventarizojnë dhe përthithin të gjithë sistemet KUZ, të cilat kanë qënë nën administrimin e njësive të qeverisjeve vendore para rajonalizimit dhe t'i kthejnë sytë në drejtim të investimeve në të gjithë zonat e shërbimit, të cilat janë përfshirë së fundmi në juridiksionin e tyre, duke i bërë pjesë në planet e investimeve dhe zhvillimeve të reja që ato do të ndërmarrin në planet e tyre të biznesit.

Analiza e mëposhtme e këtij treguesi për shoqëritë rajonale UK dhe shoqëritë UK ekzistuese merret vetëm me grumbullimin dhe largimin e ujërave të ndotura, pra nuk pasqyron nëse ujërat e ndotura trajtohen, nuk përfshin sistemet individuale (gropat septike), si dhe nesë ky mbulim formal garanton funksionalitet të rrjetit KUN (amortizimin apo sistemet jofunksionale).

Grafiku nr. 8: Mbulimi me Kanalizime, Viti 2024



Krahasuar me vitin 2023, vihet re që SHRUK Korçë raporton këtë tregues me një trend të ndjeshëm rritës prej 15.8%, pesë shoqëri rajonale dhe SHUK Tirana raportojnë me rritje nga 2.72 % SHRUK Fier deri tek + 5.6% SHUK Tirana, për katër shoqëri rajonale ky tregues paraqet një trend më pak se 1%, shoqëritë e mbetura e raportojnë këtë tregues të përkeqësuar siç janë Vora apo Vlora. Megjithatë në tërësi si sektor ky tregues është përmirësuar me 2.2 %, ku peshën më të madhe e zë SHRUK Korçë me +15.8% dhe SHUK Tiranë me 5.61%, kanë pësuar rritje të këtij treguesi dhe SHRUK Gjirokastër +3.92%, SHRUK Kukës +3.86%, SHRUK Durrës +3.56%, SHRUK Pogradec +3.36%, SHRUK Lezhë +0.97%, SHRUK Shkodër +0.65% dhe SHRUK Elbasan +0.47%.

Mbi nivelin e performancës së mirë për vitin 2024 janë vetëm 2 shoqëritë ekzistuese UK Tiranë me 98.61% dhe SHUK Kamëz me 76.28%, ku kjo e fundit dhe pse ka pësuar rënie mbetet shoqëri me performancë të mirë, si dhe SHRUK Korçë që raporton për vitin 2024 në nivelin 70% duke u rreshtuar në shoqëritë me performancë të mirë, gjithmonë referuar treguesit “Mbulim me kanalizime”.

Vërehet mos ndryshimi i këtij treguesi për SHRUK Dibër përgjatë tre viteve të fundit duke mbetur kështu shumë larg mesatares kombëtare.

Shoqëritë me performancë më të dobët në sektor, me më pak se 30% mbulim me kanalizime janë SHRUK Kukës 28.98%, SHRUK Lushnje 23.26% dhe SHRUK Dibër 22.5%.

Analizimi i treguesit për shoqëritë rajonale **përgjatë periudhës 2022-2024** rezulton:

Me një trend pozitiv dhe përmirësim të dukshëm dhe të qëndrueshëm në drejtim të mbulimit të popullsisë për **SHRUK Korçë**, dhe trend pozitiv për SHUK Tiranë, SHRUK Elbasan, SHRUK Sarandë, SHRUK Vlorë, SHRUK Gjirokastrë. Ky trend pozitiv, tregon investime ose zgjerim të rrjetit. Trendi negativ për vitet 2022-2024, pasqyron një përkeqësim të këtij treguesi, i cili për shoqërinë e madhe para rajonalizimit paraqitet në nivele më të larta si tregues, por që ka ardhur duke u përkeqësuar dhe kjo mund të thuhet për SHRUK Kukës (-1.32%), Lezhë (-3.63 %), Lushnje (-3.54%), Fier (-0.68%), të cilat pas riorganizimit të shoqërive, raportojnë një përkeqësim të këtij treguesi (duke pasur parasysh dhe vërtetësinë e tij, të raportuara më parë nga ish shoqëritë UK ekzistuese).

Gjithashtu, rënie të këtij treguesi kanë pësuar dhe shoqëritë ekzistuese si SHUK Kamëz (-6.32%), dhe SHUK Vorë (-6.94%).

Ecuria e këtij treguesi për shoqëritë rajonale UK dhe shoqëritë UK ekzistuese për dy vitet e fundit paraqitet në tabelën nr. 21 .

Tabela nr. 21: Ecuria e mbulimit me kanalizime (në%)

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024-2023
1	Korçë	UK	53.7	54.2	70.0	15.80
2	Tiranë	UK	92.6	93	98.61	5.61
3	Gjirokastrë	UK	33.1	32	35.92	3.92
4	Kukës	UK	30.3	25.3	28.98	3.68
5	Durrës	UK	53	51.7	55.26	3.56
6	Pogradec	UK	52.7	49.3	52.66	3.36
7	Fier	UK	42.4	39	41.72	2.72
8	Lezhë	UK	50.2	45.6	46.57	0.97
9	Shkodër	UK	31.5	32.5	33.15	0.65
10	Elbasan	UK	37.2	41.6	42.07	0.47
11	Berat	UK	49.2	48.9	49.2	0.30
12	Dibër	UK	22.5	22.5	22.5	0.00
13	Sarandë	UK	44.4	49.3	49.27	-0.03
14	Lushnje	UK	26.8	24.3	23.26	-1.04
15	Kamëz	UK	82.6	78.6	76.28	-2.32
16	Vorë	UK	56.5	54	49.56	-4.44
17	Vlorë	UK	59.8	72.4	64.65	-7.75

Përfundime

- Treguesi i mbulimit me shërbimet e KUN në vite ka qëndruar pothuajse në të njëjtin nivel, me rritje pothuajse të papërfillshme. Këtë vit ky tregues është në nivelin 57 % me një rritje prej 2.2% krahasuar me vitin 2023. Në vitin 2024 vetëm 3 shoqëri arrijnë të mbulojnë me shërbim mbi 70 % të popullsisë në zonën e juridiksionit, SHUK Tiranë dhe SHUK Kamëz dhe SHRUK Korçë.
- Nga 17 shoqëritë UK në sektor, 6 shoqëri performojnë në kufirin e performancës mbi 50%, , ndërkohë që në 2023 vetëm 4 shoqëri kishin performancë mbi këte niveleve, ndërsa shoqëritë e tjera arrijnë të mbulojnë me shërbim një përqindje të ulët të popullsisë në juridiksion, kryesisht qendrat rurale.
- Trajtimi i ujërave të ndotura kryhet nga 5 shoqëri rajonale UK, Durrës, Korçë, Pogradec, Shkodër (ITUN Velipojë + ITUN Shirokë) dhe Lezhë, të cilat janë të licencuara nga ERRU për të ofruar këto shërbime.
- Mbulimi me shërbimin e kanalizimeve si një tregues që shpreh shkallën e zhvillimit të infrastrukturës së KUN si një nga sfidat kryesore për të gjitha shoqëritë UK duhet të jenë pjesë e planeve të biznesit, duke planifikuar investime në këtë drejtim si dhe të vendosin objektiva më agresiv për rritjen e këtij treguesi.
- Mbetet akoma problem respektimi i normave teknike për impiantet individuale të trajtimit të UN (gropat septike) për zonat rurale.
- Shoqëritë duhet të bashkëpunojnë me AKUK dhe të evidentojnë impaktin dhe efektivitetin e zbatimit të Aktit Normativ Nr.8, date 28.12.2023, për të vlerësuar mundësinë e aplikimit për ente privatë në pamundësi të lidhjes me impjante trajtimi të centralizuara/ose në mungesë, të cilët janë klientë potencialë.
- Është e domosdoshme rritja e vëmendjes për investime në sektor, si në drejtim të zgjerimit të rrjeteve të mbledhjes dhe largimit të UN, edhe të ndërtimit të ITUN para se të derdhen në ambientin pritës në respektim të direktivave të BE-së mbi ujërat e ndotura dhe mjedisin.

2.2.9 Eficenca Energjisë


Treguesi i "Eficencës së Energjisë" është një prej indikatorëve kyç të performancës teknike dhe financiare të shoqërive UK, duke reflektuar nivelin e konsumit të energjisë elektrike për prodhimin dhe shpërndarjen e 1 m³ ujë. Ky tregues është veçanërisht i ndjeshëm, pasi kostot e energjisë elektrike zënë pjesën më të madhe të kostove totale operative (O&M) në sektorin e ujit. Për vitin 2024, mesatarja sektoriale e eficencës së energjisë është në nivelin 0.66 kWh/m³, duke reflektuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2023 (0.63 kWh/m³).

Analiza e këtij treguesi bëhet për shkak se rritja e konsumit të energjisë elektrike është e lidhur drejtpërdrejtë me rritjen e kostove operative. Përkeqësimi i këtij treguesi krahasuar me vitin 2023 vjen

kryesisht se volumi i ujit të prodhuar është ulur me afërsisht 14.6 milion m³, ndërsa energjia e konsumuar në kWh është ulur me rreth 750 mijë, pra afërsisht 2 herë më pak se uji i prodhuar. Këtë diferencë mund ta shpjegojmë me faktin se pompat janë konsumuar më shumë për 1 vit dhe nuk janë efikase, por ekziston mundësia që raportimi nga shoqëritë UK, i sasisë së energjisë së konsumuar (ose matja e saj) ose i sasisë së ujit të prodhuar (40% e vlerësuar) nuk ka qënë i saktë. Nisur nga kjo situatë Shoqëritë UK duhet domosdoshmërisht të gjejnë mundësinë për të realizuar studim mbi eficientë e energjisë dhe përmirësimin e saj, në sistemet e furnizimit me ujë dhe KUN.

Aneks 12, tabela nr. 35, jepen të detajuara të dhënat e detyrimeve ndaj OSHEE për secilën shoqëri UK të grupuara sipas reformës në shoqëri rajonale UK.

Grafiku nr. 9: Eficienta e Energjisë, Viti 2024



Nga grafiku vihat re se nga 17 shoqëritë që operojnë në sektorin UK janë 8 shoqëri UK, të cilat e kanë eficientën e energjisë mbi mesataren e sektorit e cila është 0.66 kWh/m³, shoqëritë rajonale UK Durrës 1.44 kWh/m³, Fier 1.34 kWh/m³, Lezhë 1.2 kWh/m³, Lushnjë 0.88 kWh/m³, Shkodër 0.87 kWh/m³, Vlorë 0.78 kWh/m³ si dhe shoqëria ekzistuese UK Vorë 0.72 kWh/m³.

Krahasuar me vitin 2023, vihat re se shoqëria SHRUK Dibër 0.01 kWh/m³ dhe SHRUK Korçë kanë ruajtur të njëjtin nivel të këtij treguesi gjatë vitit 2024. Përkeqësim të këtij treguesi ka patur shoqëria SHRUK Lezhë, e cila nga 0.83 kWh/m³, aktualisht e ka 1.2 kWh/m³, SHRUK Fier, e cila nga 1.02 kWh/m³, aktualisht e ka 1.34 kWh/m³, SHRUK Sarandë e cila nga 0.62 kWh/m³, aktualisht e ka 0.86 kWh/m³, SHRUK Pogradec e cila nga 0.47 kWh/m³, aktualisht e ka çuar 0.66 kWh/m³ sa mesatarja e sektorit.

Shoqëria UK me performancën më të keqe për këtë vit është SHRUK Durrës 1.44 kWh/m³. Kjo vjen si rezultat i largësisë së madhe të burimeve të ujit, nga të cilat furnizohet kjo shoqëri dhe detyrimisht pompimi i ujit çon në konsum të lartë të energjisë, duke patur në konsiderate dhe humbjet e larta të ujit që ka kjo shoqëri. Shoqëri të tjera të cilat e ka këtë tregues mbi nivelin 1 kWh/m³, është Sh.R UK Lezhë, e cila e ka eficientën e energjisë 1.2 kWh/m³ dhe SHRUK Fier, e cila e ka eficientën e energjisë 1.34 kWh/m³, por kjo shoqëri e ka konsumin e lartë të energjisë elektrike, pasi e ka të gjithë sistemin e furnizimit me ujë me ngritje mekanike. Vlen për t'u përmendur dhe SHRUK Pogradec, e cila edhe pse ka patur një përkeqësim të këtij treguesi me 0.19 kWh/m³, përsëri e ka këtë tregues sa niveli i mesatares së sektorit 0.66 kWh/m³.

Gjithashtu, shoqëri të cilat kanë patur përmirësim të lehtë të këtij treguesi si shoqëritë rajonale ka qenë SHRUK Berat (-0.09 kwh/m³), SHRUK Elbasan (-0.07 kwh/m³), ndërsa si shoqëri ekzistuese SHUK Vorë (-0.14 kwh/m³), e cila ka raportuar përmirësimin më të lartë për këtë vit dhe SHUK Tiranë (-0.06 kwh/m³). Performancën më të mirë për këtë tregues e kanë shoqëritë rajonale SHRUK Dibër 0.01 kwh/m³, SHRUK Kukës 0.2 kwh/m³, të cilat përgjithësisht sistemin e furnizimit me ujë e kanë me rrjedhje të lirë dhe shumë pak me ngritje mekanike. Ecuri më të mirë ka patur SHRUK Elbasan, e cila nga 0.84 kwh/m³ në vitin 2022 e ka çuar në 0.63 kwh/m³ duke e ulur me 0.21 kwh/m³.

ERRU, për të realizuar një analizë sa më të saktë të këtij treguesi shumë të rëndësishëm për përmirësimin financiar të shoqërive, e shikon të domosdoshme prej shoqërive UK, realizimin e një studimi mbi efencën e energjisë në sistemet e furnizimit me ujë dhe KUN të tyre, në të cilin të analizohet efikasiteti i përdorimit të energjisë elektrike, kryesisht në stacionet e pompimit të ujit të pijshëm e të ujërave të ndotura, si dhe në ITUN.

Tabela nr. 22: Efienca e energjisë për Furnizimin me Ujë (n% %)

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024-2023
1	Vorë	UK	0.01	0.86	0.72	-0.14
2	Berat	UK	0.43	0.45	0.36	-0.09
3	Elbasan	UK	0.84	0.7	0.63	-0.07
4	Tiranë	UK	0.22	0.22	0.16	-0.06
5	Dibër	UK	0.01	0.01	0.01	0.00
6	Korçë	UK	0.59	0.63	0.63	0.00
7	Gjirokastrë	UK	0.39	0.24	0.29	0.05
8	Durrës	UK	1.37	1.39	1.44	0.05
9	Lushnje	UK	0.75	0.82	0.88	0.06
10	Kukës	UK	0.01	0.08	0.2	0.12
11	Shkodër	UK	0.74	0.74	0.87	0.13
12	Kamëz	UK	0.77	0.05	0.19	0.14
13	Vlorë	UK	0.77	0.64	0.78	0.14
14	Pogradec	UK	0.68	0.47	0.66	0.19
15	Sarandë	UK	0.98	0.62	0.86	0.24
16	Fier	UK	1.37	1.02	1.34	0.32
17	Lezhë	UK	0.94	0.83	1.2	0.37

Përfundime

- Mesatarja e sektorit UK, për vitin 2024, për treguesin efienca e energjisë për shërbimin e furnizimit me ujë në sektor është 0.66 kwh/m³ dhe ka pësuar një përkeqësim të lehtë me 0.03 kwh/m³ krahasuar me vitin 2023.
- Nisur nga kjo situatë është e rëndësishme që çdo shoqëri UK duhet të disponojë një studim mbi efencën e energjisë dhe përmirësimin e saj, në të cilin analizohet efikasiteti i përdorimit të

energjisë elektrike, kryesisht në stacionet e pompimit të ujit të pijshëm, e të ujërave të ndotura, në ITUN, në sasinë e ujit të prodhuar, rehabilitimet e rrjetit, humbjet e ujit etj.

- Ky tregues merr një rëndësi të veçantë kur kemi parasysh se në mbyllje të vitit 2024 në sektor janë 12 shoqëri UK nga 17 që operojnë në sektor që nuk arrijnë të mbulojnë kostot O&M. Kostot e energjisë elektrike në sektorin UK zënë rreth 23.2% të totalit të kostove O&M. Pra, janë disa shoqëri të cilat nuk arrijnë të mbulojnë kostot e O&M dhe mbijetesën financiare e sigurojnë me anë të subvencioneve nga qeveria qendrore ose duke mos paguar faturën e energjisë elektrike ndaj FSHU-së.

2.2.10 Ankesat e Klientëve

Ky tregues nga ana e ERRU-së lidhet direkt edhe me angazhimin e ERRU-së në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit nga shërbime të karakterit monopol, siç janë ato të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Vendorsja e këtij treguesi si pjesë e treguesve kryesorë të performancës dhe si objektiv për shoqëritë UK, lidhet edhe me angazhimin e ERRU-së në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit.


Në këtë kontekst, ERRU, ka krijuar brenda strukturës organizative Strukturën e Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjes (SZAM), si struktura përgjegjëse brenda rregullatorit për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve midis konsumatorit dhe shoqërisë UK në sektorin FU dhe KUN.

Theksohet fakti se konsumatorët i drejtojnë ankesat që kanë ndaj shoqërive UK, pranë ERRU-së, pasi kanë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për zgjidhjen e tyre me këto të fundit.

Natyrë e ankesave të klientëve paraqitet kryesisht në tre kategori “zbatueshmëria e kushteve të kontratës për shërbime ujësjellës kanalizime”, “cilësia e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK” dhe “faturimi aforfe”.

Ankesat e klientëve në raport me numrin total të lidhjeve të sektorit UK për vitin 2024 janë 4.60%, nga 4.23% që ishin në vitin 2023, me një rritje prej 5,000 ankesash për të gjithë sektorin. Ndikimin kryesor në përkeqësimin e këtij treguesi e kanë dhënë kryesisht shoqëritë SHUK Tirana, SHUK Korçë, SHUK Vorë.

Grafiku nr. 10: Ankesat e Klientëve, Viti 2024



Në tabelën nr.23 të mëposhtme jepen ankesat e klientëve në raport me numrin total të lidhjeve të sektorit UK, ku për vitin 2024 rezulton të jenë në nivelin e 4.6%.

Referuar tabelës, vihet re se 5 shoqëri UK e kanë këtë tregues mbi mesataren e sektorit dhe 15 shoqëri UK nën mesataren e sektorit.

Tabela nr.23: Ankesat e klientëve për secilën shoqëri UK (në%)

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024-2023
1	Shkodër	UK	3.5	7.9	2.15	-0.06
2	Gjirokastrë	UK	0.0	4.2	1.45	-0.03
3	Berat	UK	3.2	6.3	3.95	-0.02
4	Pogradec	UK	1.4	3.6	2.73	-0.01
5	Kukës	UK	2.5	2.5	2.05	0.00
6	Vlorë	UK	5.6	7.7	7.36	0.00
7	Fier	UK	5.8	7.0	6.89	0.00
8	Durrës	UK	1.8	2.2	2.16	0.00
9	Kamëz	UK	0.9	0.7	0.7	0.00
10	Sarandë	UK	2.2	1.1	1.12	0.00
11	Dibër	UK	0.9	1.3	1.33	0.00
12	Lezhë	UK	3.7	2.9	3.10	0.00
13	Lushnje	UK	3.0	3.4	3.63	0.00
14	Tiranë	UK	0.13	4.6	5.09	0.00
15	Vorë	UK	13.3	22.2	23.04	0.01
16	Elbasan	UK	1.0	0.9	4.24	0.03
17	Korçë	UK	0.0	5.3	13.50	0.08

ERRU i ka sugjeruar shoqërive UK hartimin e planeve të veprimit konkrete nga ana e shoqërive UK për zgjidhjen e këtyre rasteve të ankimit dhe eliminimin përfundimtar të faturimit aforfe të konsumatorëve familjarë.

Rastet e faturimit aforfe, ku konsumatorët faturohen më shumë se norma e konsumit mujor për person e parashikuar në rastet kur konsumatori nuk ka ujëmatës, vijnë të jenë objekt i ankesave pranë ERRU, por në shumë raste është evidentuar se konsumatorët familjarë, të cilët janë ankuar për faturimin aforfe kanë qenë konsumatorë të cilët janë me kolona të përbashkëta të furnizimit me ujë.

Përfundime

- Gjatë vitit 2024 Shoqëritë kanë rritur kërkesat e ankesave krahasuar me vitin 2023. Natyra e ankesave ka qenë në tre kategori “faturime aforfe”, “cilësia e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK” dhe “zbatueshmëria e kushteve të kontratës për shërbimet UK”.
- Objektet e ankimit për cilësinë e ofruar të shërbimit kanë qenë të fokusuar në probleme teknike, për të cilat shoqëritë nuk kanë dhënë zgjidhje ose nuk i janë përgjigjur konsumatorëve, ndaj për këto lloj ankesash ka qenë i nevojshëm verifikimi nga ana e ERRU-së. Nëpërmjet shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave, ERRU evidenton problematikat që kanë shoqëritë UK në lidhje me ofrimin e shërbimit.

- Një nga mekanizmat kryesorë të mbrojtjes së konsumatorit është sigurimi që nëpërmjet trajtimit të ankesave, konsumatorët të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë në zgjidhjen e ankesës së tyre.

Renditja e Shoqërive UK Sipas Performancës

Për të vlerësuar arritjet në performancën e shoqërive UK në sektor gjatë vitit 2024 u përzgjedhën katër Tregues Kryesorë të Performancës, të cilët lidhen direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive, si dhe të cilësisë së shërbimit që ato i ofrojnë konsumatorëve, respektivisht: Mbulimi i Kostove të O&M, Norma Korente e Arkëtimit, Uji Pa të Ardhura dhe Vazhdimësia (o rët) e Furnizimit me Ujë.

Bazuar në mesataren e renditjes të katër treguesve të mësipërm, në klasifikimin e përgjithshëm shoqëria me performancën më të mirë për vitin 2024 për të tretin vit radhazi u rendit Shoqëria SHRUK Korçë, e ndjekur nga shoqëritë rajonale SHRUK Lezhë, Berat dhe Pogradec. Ndërsa, shoqëritë me performancë më të dobët në sektor u klasifikuan shoqëritë SHUK Vorë, SHRUK Vlorë dhe SHRUK Elbasan dhe SHUK Kamëz, (shih Aneks 6, tabela nr. 29).

Referuar renditjes së mësipërme vërehet nevoja që kanë shoqëritë UK të paagreguara, si SHUK Vorë dhe SHUK Kamëz për t'u bërë sa më parë pjesë e shoqërisë rajonale, sipas reformës me qellim përmirësimin e performancës së tyre tekniko ekonomike dhe rritjes së cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve.

3 Progresi i Reformës në Sektorin Ujësjellës-Kanalizimeve

Reforma strukturore në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, e nisur nga qeveria qendrore në maj të vitit 2022 mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 ka hyrë tashmë në një fazë konsolidimi, duke dëshmuar qartazi rezultatet e para konkrete dhe pozitive. Synimi kryesor i kësaj reforme ishte kalimi nga një sistem i shpërndarë në 58 shoqëri në 61 bashki, drejt një strukture më të centralizuar dhe më eficiente përmes krijimit të 15 shoqërive rajonale, duke rritur kapacitetin operacional, cilësinë e shërbimeve dhe qëndrueshmërinë financiare të sektorit.

Zbatimi i reformës nisi me shoqëritë e para rajonale në Lezhë dhe Korçë dhe brenda vitit 2023, procesi i rajonalizimit mori trajtë konkrete me ngritjen e 14 nga 15 shoqëritë e planifikuara. Këto përfshijnë: Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Durrës, Fier, Lushnjë, Sarandë, Elbasan, Korçë, Pogradec, Berat, Gjirokastrë dhe Vlorë. Nga këto, 13 nisën zyrtarisht funksionimin gjatë vitit 2023, ndërsa shoqëria rajonale Vlorë e filloi aktivitetin në janar 2024.

Aktualisht, procesi ka përparuar edhe në drejtim të strukturimit të brendshëm të këtyre shoqërive, të cilat kanë përfituar ndjeshëm nga mbështetja institucionale dhe rritja e kapaciteteve tekniko-menaxheriale. Këto përmirësime kanë filluar të reflektohen në mënyrë të dukshme në nivelin e shërbimeve dhe indikatorët financiarë të shoqërive.

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) ka ndjekur me përkushtim çdo hap të këtij transformimi, duke licencuar në kohë shoqëritë e reja dhe duke zhvilluar takime intensive me të gjithë aktorët përkatës, përfaqësues të AKUK, drejtues të shoqërive rajonale UK dhe anëtarë të këshillave mbikëqyrës. ERRU ka ofruar orientime të qarta për zbatimin e VKM-së dhe të legjislacionit përkatës në një periudhë tranzitore delikate, gjatë së cilës janë adresuar dhe zbutur problematika të shumta praktike.

Gjatë zbatimit të reformës janë hasur një sërë sfidash, që lidhen me trashëgiminë e problematikave nga strukturat ekzistuese, të tilla si:

- Mospërputhje në bilancet financiare dhe numrin real të klientëve aktiv;
- Detyrime të mbartura dhe marrëveshje kontraktuale të papërputhura;
- Probleme me dokumentacionin ligjor dhe mungesë e stafit të kualifikuar;
- Vështirësi në operim për shkak të llogarive të bllokuara bankare.

Megjithatë, falë ndërhyrjeve të strukturuar, trajnimeve të ofruara dhe mbështetjes nga ERRU dhe partnerët teknikë, këto problematika janë adresuar pjesërisht dhe pritet të zgjidhen në tërësi gjatë fazës së konsolidimit. Një përmirësim i ndjeshëm është vënë re sidomos në aspektin e menaxhimit të të ardhurave, raportimit financiar dhe rritjes së ndërgjegjësimit mbi shërbimin ndaj konsumatorit.

Një nga objektivat e reformës është unifikimi i tarifave brenda secilës shoqëri rajonale. Në disa zona, ku tarifat ekzistuese ishin të ngjashme, ky proces është më i lehtë dhe në vazhdim. Ndërsa për zona me diferenca të mëdha në tarifa dhe cilësi shërbimi (si Durrësi apo Korça), ERRU ka rekomanduar një qasje të kujdesshme dhe graduale për të shmangur pasoja të padëshiruara, si ulja e normës së arkëtimit për shkak të mospagesës nga konsumatorët.

Plani i unifikimit përmes rritjes progresive të tarifave, i shoqëruar me përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së shërbimit, parashikohet të sjellë përfitime afatgjata në performancën financiare të

shoqërive. Kjo do të sigurojë një sistem më të drejtë dhe të qëndrueshëm për të gjithë konsumatorët në territorin e mbuluar nga çdo shoqëri rajonale.

Reforma në sektorin UK po tregon efektet të qëndrueshme dhe të përmirësuar. Konsolidimi i sektorit ka sjellë rritje të efikasitetit në operim, përmirësim të monitorimit teknik dhe financiar, dhe një bazë më të qëndrueshme për investime të ardhshme në infrastrukturë.

Sektori kërkon ende mbështetje dhe ndjekje të vazhdueshme nga institucionet qendrore, veçanërisht në menaxhimin e aseteve, planifikimin e investimeve dhe përcaktimin e subvencioneve të nevojshme, për të garantuar ofrimin e një shërbimi cilësor për të gjithë qytetarët.

Në këtë fazë, është e qartë se reforma po jep rezultatet e saj, duke kaluar nga konceptimi dhe organizimi në zbatim konkret dhe në përmirësime reale në terren. Kjo përbën një hap të rëndësishëm drejt modernizimit dhe profesionalizimit të shërbimeve të ujit në Shqipëri.

4 Konkluzione dhe Rekomandime

- Shoqëritë rajonale duhet të kenë në fokus hartimin e Planeve të Menaxhimit të Aseteve, si instrumenti bazë që justifikon kërkesat dhe nevojat për financimin e investimeve fizike, si dhe efikasitetin e pritshëm të tyre në operimin e shoqërisë dhe uljen e kostove.
- Duke pasur parasysh rëndësinë e Planeve të Bizneseve 5-vjeçare për shoqëritë UK, të nxitet nga ERRU hartimi i tyre si një prerogativë ligjore kur shoqëritë aplikojnë për tarifa të reja. Ky dokument duhet të jetë i orientuar në drejtim të mbulimit të plotë të kostove O&M, në mënyrë që të gjitha shoqëritë UK të arrijnë mbulimin e tyre mbi 100%.
- Saktësia dhe besueshmëria e të dhënave të raportuara pranë ERRU-së, vijon të jetë problem edhe gjatë hartimit të këtij raporti. Shoqëritë rajonale UK duhet të punojnë në drejtim të rritjes së profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë për saktësinë e të dhënave të raportuara duke qenë se tashmë kanë kapacitetet e nevojshme të stafeve në këtë drejtim. Në të njëjtën kohë duhet të respektojnë procedurat për shkallën e saktësisë së tyre të përcaktuara në Metodologjinë e Vendosjes së Tarifave të Shërbimeve UK.
- Nivelet e larta të Ujit Pa të Ardhura (UPA) prej **61.00%** mbeten problem serioz brenda sektorit, pasi kërcënon qëndrueshmërinë e shoqërive rajonale UK dhe atyre ekzistuese. Shoqëritë rajonale duhet të kenë në fokusin e tyre kryesor reduktimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme si dhe të humbjeve fizike. Nga ana tjetër, për një vlerësim real të gjendjes së humbjeve dhe të hartimit sa më të saktë të balanceve të ujit nga shoqëritë, mbetet e një rëndësie të veçantë financimi dhe instalimi i matësve të mëdhenj të ujit në burim dhe ato individualë, tek konsumatorët privatë dhe familjarë. Bilancet e ujit përcaktojnë gjendjen reale të kërkesës për ujë dhe shërbejnë si bazë për hartimin e planeve për reduktimin e humbjeve dhe mbrojtjen e burimeve nga mbikonsumi i pajustificuar. Si fillim, shoqëritë mund të përqendrohen në trajtimin e humbjeve administrative (komerciale) që bëjnë të mundur rikuperimin e të ardhurave, të cilat për momentin nuk arkëtohen për shkak të konsumit të paligjshëm. Gjithashtu, sa herë që të tentohet rehabilitimi apo shtrimi i ri i rrjetit për reduktimin e humbjeve reale është nevojshme të gjenden zgjidhje teknike me kosto të përballueshme
- Kostot e punës zënë aktualisht **55%** në Kostot O&M të shoqërisë. Treguesi i efikasitetit të stafit në nivelin 4.43 punonjës për 1000 lidhje UK, edhe pse i përmirësuar për vitin 2024, ka mjaft hapësirë për reduktimin e tij nga punonjësit e tepërt në numër dhe pozicione të pajustificuara. Shoqëritë rajonale UK duhet të rishikojnë organigramën dhe pozicionet e punës bazuar në një analizë të detajuar, me qëllim për të justifikuar numrin e punonjësve në përputhje me nevojat reale që kërkon zhvillimi i aktivitetit normal të saj, kërkesë e cila theksohet në veçanti nga ERRU kur shoqëritë UK aplikojnë për tarifa të reja.
- Eficenca e energjisë duhet të jetë në fokus të shoqërive UK, pasi ky zë shpenzimesh mbetet kryesor pas atyre të punës. Fokusi duhet të jenë kryesisht shoqëritë që pjesën më të madhe të sistemeve të FU e kanë me ngritje mekanike. Këto shoqëri duhet të studiojnë mundësitë për burime alternative të pavarura furnizimi me energji elektrike të rinovueshme dhe në të njëjtën kohë të investojnë në pompa të reja me efikasitet të lartë energjie.
- Referuar VKM-së Nr. 302, datë 11.5.2022, si akti nënligjor bazë për konceptimin dhe zbatimin e reformës për agregimin e sektorit, nënkuptohet që afati maksimal i vendosur nga qeveria qendrore që nga themelimi i shoqërive rajonale, që sektori UK të vetëfinancohet nga të ardhurat, është 10 vjet. Zbatimi i reformës premtun një situatë optimiste që mbulimi i të gjitha kostove të shërbimeve UK në sektor të mbulohet kryesisht me tarifë, të realizohet para këtij afati. Pra, që të zbatohet plotësisht parimi i Rikuperimit të Kostove.

5 Tema e Veçantë: Ndikimi i Skemës së Subvencionimit për Familjet me Ndhmë Ekonomike

1. Qëllimi

Sigurimi i aksesit në ujë të sigurt, me cilësi të mirë dhe me kosto të përballueshme për të gjithë qytetarët është një nga qëllimet kyçe të zhvillimit global. I përcaktuar në Objektivin 6 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG 6) të Kombeve të Bashkuara, ai nënvizon rëndësinë e shërbimeve të besueshme të ujës-jellës-kanalizimeve si themel për mirëqenien njerëzore dhe zhvillimin ekonomik. Në të njëjtën linjë, UN-Water nënvizon se “sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe higjienës për të gjithë është thelbësor për arritjen e gjithë Agjendës 2030. Uji është jetë dhe pa të, zhvillimi i qëndrueshëm është thjesht i pamundur. Kjo qasje kërkon politika gjithëpërfshirëse që garantojnë barazi në akses dhe menaxhim të përgjegjshëm të burimeve ujore. Në këtë frymë, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të qartë për të mbështetur shtresat më të pambrojtura të popullsisë dhe për të forcuar funksionimin e sektorit të ujit në vend.

Në vitin 2024, qeveria shqiptare miratoi skemën e subvencionimit që mbulon plotësisht konsumin mujor prej 5 m³ ujë për çdo familje përfituese të ndihmës ekonomike, duke përfshirë tarifat për furnizimin me ujë, kanalizimet dhe tarifën fikse ku zbritja do të bëhet automatikisht në faturë çdo muaj. Objektivi kryesor i kësaj politike është sigurimi i aksesit minimal në shërbime bazë për shtresat në nevojë. Njëkohësisht, ajo synon jo vetëm lehtësim të barrës ekonomike por dhe të nxisë formalizimin e konsumatorëve dhe reduktimin e ujit pa të ardhura, nëpërmjet rritjes së matjes dhe ndërgjegjësisht duke çuar në përmirësimin e performancës së shoqërive UK. Subvencioni ofrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga buxheti i shtetit për ato shoqëri që kanë lidhur kontrata performance me AKUK. Në mungesë të kësaj kontrate, operatorët janë të detyruar të mbulojnë vetë kostot e shërbimit për familjet përfituese, duke ndikuar ndjeshëm në bilanci të tyre financiare.

Në vijim të kësaj analize jepet një pasqyrë e ndikimit financiar të këtij subvencioni tek konsumatori familjar (familjet me ndihmë ekonomike) dhe tek 17 shoqëri UK (14 të rajonalizuara dhe 3 ekzistuese: Tiranë, Kamëz, Vorë) në raport me strukturën e të ardhurave, vëllimin e konsumit dhe përqindjen e familjeve me ndihmë ekonomike. Gjithashtu do të paraqesim ndikimin e subvencionit tek indikatorët e performancës si dhe ndikimi i tij në mbrojtjen e burimeve ujore.

2. Përfitimet e konsumatorit familjar

Një nga aspektet më të rëndësishme të kësaj politike është ndikimi pozitiv i drejtpërdrejtë tek familjet përfituese. Subvencionimi i 5 m³ ujë në muaj siguron për familjet me ndihmë ekonomike akses të qëndrueshëm në një shërbim jetik, siç është uji i pijshëm.

Përfitimet kryesore për konsumatorët përfshijnë:

- Siguri për mbulimin e konsumit bazë për nevoja higjienike, ushqimore dhe sanitare;
- Lehtësim të barrës ekonomike mujore për familjet me të ardhura të ulëta;
- Reduktim të riskut për krijim borxhesh dhe ndërprerje të shërbimit;
- Nxitje për formalizimin e lidhjes me shoqërinë UK dhe përdorimin e matësve të ujit;

- Ndjenjë përfshirjeje sociale, duke u trajtuar në mënyrë të barabartë me konsumatorët e tjerë.

Për më tepër, kjo politikë synon të zhvillojë një ndërgjegjësim të ri për përdorimin racional të ujit, duke edukuar familjet që të mbështeten në konsum të qëndrueshëm dhe të matur, pa shpërdorim.

3. Analizë e ndikimit financiar në shoqëritë UK

Tarifat e përdorura në këtë analizë bazohen në vendimet aktuale të ERRU-së, të vlefshme deri në fund të vitit 2024 dhe janë aplikuar për çdo njësi administrative përkatëse. Bazuar në këto tarifa është ndërtuar një tabelë e detajuar që tregon volumin e subvencionit të nevojshëm për secilën shoqëri UK. Më pas, subvencioni teorik është krahasuar me shumën reale të subvencioneve që janë disbursuar nga AKUK, për të vlerësuar zbatimin dhe ndikimin financiar në sektor.

Për këtë analizë janë marrë parasysh këto elementë të përbashkët për çdo shoqëri:

- Numri mesatar i familjeve me ndihmë ekonomike për muaj (bazuar në të dhënat nga Bashkitë dhe Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH).
- Tarifa mesatare e ujit, kanalizimeve dhe tarifa fikse në çdo shoqëri.
- Numri total i abonentëve familjarë dhe përqindja që përbëjnë përfituesit nga ndihma ekonomike.
- Vlera mujore dhe vjetore e zbritjes për familje.

3.1 Metodologjia e Llogaritjes së Subvencioneve për Secilën Shoqëri UK

Për të vlerësuar impaktin financiar të skemës së subvencionimit prej 5 m³ ujë në muaj për familjet me ndihmë ekonomike, është ndjekur një metodologji e unifikuar e bazuar në strukturën tarifore të miratuar për çdo shoqëri UK dhe në numrin e familjeve përfituese të raportuar nga operatorët në AKUK.

- **Llogaritja për një familje përfituese**

- **Tarifa variabël për ujë të pijshëm (lek/m³)** — sipas vendimit përkatës për shoqërinë;
- **Tarifa variabël për kanalizime (lek/m³)** — për çdo m³ të furnizuar;
- **Tarifa fikse mujore (lek)** — tarifë që aplikohet një herë në muaj për çdo lidhje familjare;
- **Volumi i subvencionuar: 5 m³/muaj.**

Zbritja mujore për një familje përfituese është llogaritur sipas formulës:

$$\text{Zbritja mujore (lek)} = 5 \text{ m}^3 \times (\text{Tarifa ujit} + \text{Tarifa kanalizimeve}) + \text{Tarifa fikse}$$

Ndërsa subvencioni vjetor për një familje:

$$\text{Zbritja vjetore (lek)} = \text{Zbritja mujore} \times 12 \text{ muaj}$$

- **Llogaritja për shoqëritë UK**

Për çdo shoqëri UK, subvencioni total llogaritet si:

$$\text{Zbritja mujore totale (lek)} = \text{Numri i familjeve me ndihmë ekonomike} \times \text{Zbritja mujore për familje}$$

$$\text{Zbritja vjetore totale (lek)} = \text{Zbritja mujore totale} \times 12 \text{ muaj}$$

Ky vlerësim për secilën nga 17 shoqëritë UK (14 të rajonalizuara dhe 3 të pavarura) përcakton subvencionin teorik që duhet të kompensohet nga AKUK për të mbuluar koston e plotë të shërbimit ndaj kësaj kategorie.

Ky vlerësim tregon kontributin real të skemës në buxhetin e një familjeje përfituese. Në rastin e një familjeje që konsumon rregullisht **5 m³ ujë në muaj**, subvencioni që mbulon këtë sasi përbën zakonisht **80% deri në 100% të vlerës totale të faturës mujore**, në varësi të tarifave të zbatuara nga shoqëria UK përkatëse.

Në shumë raste, ky subvencion **eliminon plotësisht nevojën për pagesë nga ana e përfituesit**, duke bërë që familjet me të ardhura të ulëta të **mos kenë asnjë kosto mujore për ujin**, çka përbën një ndihmë të rëndësishme sociale dhe ekonomike.

Tabela e mëposhtme paraqet një krahasim të detajuar mes subvencionit teorik që i takon çdo shoqërie UK, bazuar në tarifat aktuale të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit të ujërave të ndotur dhe tarifës fikse mujore për konsumatorët familjarë, dhe subvencionit faktik të përfituar nga AKUK gjatë vitit 2024.

Tabela nr.1: Subvencioni teorik dhe ai faktik për familjet me ndihmë ekonomike

Nr	Emri i shoqërisë rajonale	2024						
		Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm	Shërbimi i largimit të ujërave të ndotur	Tarifë fikse	Subvencion 5m³/muaj, familje	Subvencioni teorik	Subvencio ni i marrë nga AKUK	Mbulimi me subvencion
		Tarifë variabël	Tarifa variabël					
		Familjar	Familjar	Familjar	lek	lek	lek	(%)
Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Korçë sh.a				1,569	379,628,964	6,300,044	2%	
1	Njësia Korçë	72/38/28*	42	140	710			
	Njësia Devoll	38		50	240			
	Njësia Maliq	45/22.5*	54/50/27*		279			
	Njësia Pustec							
	Njësia Kolonjë	38	10	100	340			
Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Pogradec sh.a				1,250	335,865,000	8,626,699	3%	
2	Njësia Pogradec	65/35*	35/25*	200	700			
	Njësia Prrenjas	45/35*	25	200	550			
Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Durrës sh.a				3,180	2,175,120	26,351	1%	
3	Njësia Durrës	70	50	200	800			
	Njësia Shijak	70	50	200	800			
	Njësia Kavajë	50	30	200	600			
	Njësia Krujë	48	10	200	490			
	Njësia Rrogozhinë	48	10	200	490			
Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Lezhë sh.a				2,120	81,484,320	1,412,476	2%	
4	Njësia Lezhë	65	19	200	620			
	Njësia Kurbini	45	15	100	500			
	Njësia Rrëshen	45	15	100	500			
	Njësia Rubik	45	15	100	500			
Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Dibër sh.a				635	114,703,860	2,493,684	2%	
5	Njësia Dibër	27			135			
	Njësia Bulqizë	25	10	100	275			
	Njësia Mat	23	2		225			
	Njësia Klos							
Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Kukës sh.a				565	83,427,900	3,078,055	4%	
6	Njësia Kukës	30	10	50	250			
	Njësia Tropojë	30/40	13	100	315			
	Njësia Has							
Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Elbasan sh.a				1,450	107,880,000	2,268,456	2%	
7	Njësia Elbasan	40	9	200	445			
	Njësia Librazhd	42/26	15	100	385			
	Njësia Gramsh	32		60	220			
	Njësia Cërrik							
	Njësia Belsh							

	Njësia Peqin	48	12	100	400			
Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a					2,450	88,258,800	1,701,667.0	2%
8	Njësia Fier	60	20	200	600			
	Njësia Patos	70	20	200	650			
	Njësia Mallakastër	60	20	200	600			
	Njësia Roskovec	60	20	200	600			
Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër sh.a					3,100	128,340,000	786,988.3	1%
9	Njësia Gjirokastër	50/30*	15	200	525			
	Njësia Tepelenë	50	15	200	525			
	Njësia Këlcyrë	50	15	200	525			
	Njësia Përmet	50/30*	15	200	525			
	Njësia Libohovë	30	15	200	245			
	Njësia Dropull	30		200	230			
	Njësia Memaliaj	50	15	200	525			
Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Lushnje sh.a					495	7,484,400	495,878	7%
10	Njësia Lushnjë	62	17	100	495			
	Njësia Divjakë							
Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat sh.a					1,575	52,088,400	1,008,607	2%
11	Njësia Berat	50/40*	14	100	420			
	Njësia Kuçovë	50	14	100	420			
	Njësia Dimal							
	Njësia Skrapar	35	10	100	325			
	Njësia Poliçan	50	12	100	410			
Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë sh.a					1,422	25,681,320	796,044.0	3%
12	Njësia Sarandë	60	25	200	625			
	Njësia Finiq							
	Njësia Konispol	50/66.7*			250			
	Njësia Delvinë	58	18	167	547			
Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a					2,775	142,723,800	1,208,055	1%
13	Njësia Shkodër	55	30	200	625			
	Njësia Fushë Arrëz	40	20	200	500			
	Njësia Pukë	40	20	200	500			
	Njësia Vau Dejës	55	20	200	575			
	Njësia Malësi e Madhe	55	20	200	575			
Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlorë sh.a					1,360	4,536,960	114,489.0	3%
14	Njësia Vlorë	60	17	200	585			
	Njësia Selenicë	30			150			
	Njësia Himarë	55	30	200	625			
Shoqëritë ekzistuese								
15	UK Tiranë	65	11	200	580	7,321,920	604,568.0	8%
16	UK Kamëz				0	0	0	0
17	UK Vorë	65	15	200	600	806,400	49,920.0	6%
TOTALI					25,125	29,268,674,376	30,971,981	0.1%

* Në shoqëritë me disa tarifa për ujin e pijshëm në llogaritje e subvencioneve kemi marrë vetëm tarifën më të lartë.

Në këtë analizë është marrë në konsideratë konsumi i subvencionuar prej 5 m³/muaj për çdo familje me ndihmë ekonomike, duke reflektuar kostot reale të shërbimit për operatorët në raport me mbulimin financiar të siguruar nga fondet publike.

Në shumicën e shoqërive UK, subvencioni i përfituar mbulon një përqindje shumë të ulët të nevojës teorike financiare për të mbështetur konsumin bazë të familjeve në nevojë. Në disa raste ky mbulim lëviz nga 1% deri në 4%, ndërsa vetëm në pak raste kalon këtë nivel.

Shoqëritë që operojnë me sisteme të furnizimit me ujë me ngritje mekanike (ku kostoja e energjisë është e lartë) kanë marrë subvencion edhe për shpenzimet e energjisë, siç është rasti i SHRUK Durrës dhe SHRUK Fier e cila reflektohet në vlera të diferencuara subvencionimi.

SHUK Tiranë, SHUK Vorë dhe disa shoqëri rajonale kanë një mbulim më të mirë për shkak të strukturës tarifore dhe kapacitetit të mirë manaxherial duke përmbushur dhe objektivat e përcaktuara në kontratat e performancës, ndërsa shoqëritë pa kontratë performance (si UK Kamëz) nuk kanë përfituar subvencion dhe e përballojnë vetë kostot financiare të shërbimit për familjet në ndihmë ekonomike.

Shoqëritë rajonale UK si Gjirokastrë, Lezhë dhe Dibër, ku përqindja e popullsisë vulnerabël është më e lartë, përballen me një ekspozim më të madh financiar për shkak të peshës së kësaj kategorie mbi totalin e lidhjeve të tyre.

Në sektorin UK në Shqipëri kemi 25,125 familje përfituese, vlera teorike e subvencionit llogaritet në rreth 29.3 miliardë lekë, ndërkohë që vlera faktike e përfituar është rreth 30.9 milionë lekë, duke përfaqësuar një mbulim real minimal prej vetëm 0.1% të nevojës financiare në shkallë kombëtare.

3.2 Ndikimi i Kontratës së Performancës dhe Subvencionit në Qëndrueshmërinë Financiare të Shoqërive UK

Një faktor me ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën e zbatimit të skemës së subvencionimit dhe në efektet e saj financiare është prania ose mungesa e kontratës së performancës ndërmjet shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime (UK) dhe AKUK. Në përputhje me këtë mekanizëm ligjor, shoqëritë që kanë finalizuar këtë marrëveshje përfitojnë drejtpërdrejtë fondet e subvencionit nga buxheti i shtetit. Ndërkohë, shoqëritë që nuk e kanë përfunduar këtë proces mbeten të ekspozuara financiarisht, pasi detyrohen të mbulojnë subvencionin për shtresat në nevojë nga të ardhurat e tyre, duke reduktuar kështu kapacitetin për investime dhe përmbushjen e detyrimeve operacionale.

Tabela nr.2: Statusi i Shoqërive UK në lidhje me Subvencionet dhe Kontratën e Performancës

Shoqëria UK	Subvencion për shtresat në nevojë	Subvencion për energji	Kontratë performance
UK Tiranë	Po	Jo	Po
UK Kamëz	Jo	Jo	Jo
UK Vorë	Po	Po	Po
UKR Durrës	Po	Po	Po
UKR Elbasan	Po	Po	Po
UKR Fier	Po	Po	Po
UKR Berat	Po	Po	Po
UKR Shkodër	Po	Po	Po
UKR Vlorë	Po	Po	Po
UKR Kukës	Po	Jo	Po
UKR Dibër	Po	Jo	Po
UKR Gjirokastrë	Po	Jo	Po
UKR Korçë	Po	Jo	Po
UKR Lezhë	Po	Jo	Po

UKR Lushnje	Po	Jo	Po
UKR Pogradec	Po	Jo	Po
UKR Sarandë	Po	Jo	Po

Nga tabela evidentohet se **SHUK Kamëz** mbetet operatori më i rrezikuar, duke mos përfituar asnjë lloj subvencioni dhe pa kontratë performance, duke rrezikuar rëndë qëndrueshmërinë e tij financiare dhe operative. Shoqëritë rajonale që marrin subvencion për shtresat në nevojë por jo për energjinë (SHRUK Kukës, Dibër, Gjirokastrë, Korçë, Lezhë, Lushnje, Pogradec, Sarandë) përballen me kosto të konsiderueshme të energjisë që i mbulojnë vetë nga të ardhurat e veta, gjë që redukton fleksibilitetin financiar dhe mundësinë për investime në rrjet.

Shoqëritë UK që përfitojnë të dy llojet e subvencionit dhe kanë kontratë performance (p.sh. SHRUK Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Shkodër, Vlorë, SHUK Vorë) janë në pozicion më të favorshëm për të ruajtur likuiditetin, për të kryer investime dhe për të përmirësuar treguesit e performancës, sidomos në O&M dhe matjen e konsumit.

Shoqëritë UK pa mbështetje të plotë financiare kanë më shumë vështirësi në përmbushjen e objektivave të kontratave të performancës, sidomos për treguesit si: Mbulimi i Kostove Totale, Normat e Arkëtimit, Reduktimi i Ujit Pa të Ardhura dhe Eficienca e Energjisë. Rreziku i akumulimit të detyrimeve financiare është më i lartë për këta operatorë, duke rrezikuar ndikimin zinxhir mbi shërbimin dhe cilësinë për konsumatorët.

3.3 Vlerësimi i Qëndrueshmërisë Financiare në Kontekstin e Subvencionit dhe Performancës së sektorit UK

Për të vlerësuar ndikimin e subvencionit prej 5 m³ ujë në muaj për familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike, është e domosdoshme të shqyrtohet edhe konteksti më i gjerë i performancës së sektorit UK. Ky vlerësim mbështetet në analizën e **12 indikatorëve kryesorë**, të raportuar nga shoqëritë UK për vitin 2024. Përmirësimi i disa prej këtyre treguesve thelbësorë dëshmon ndikimin pozitiv të politikës së subvencionimit, si në **formalizimin e konsumit**, ashtu edhe në **ngarkesën financiare që mbartin operatorët**.

Tabela nr.3: Ndikimi i Skemës së Subvencionimit mbi Treguesit Kryesorë të Performancës së sektorit UK për vitin 2024

Nr.	Treguesi i Performancës	Njësia Matëse	2023	2024	Tendenca	Koment mbi ndikimin e subvencionit
1	Uji Pa të Ardhura (UPA)	%	64.7	61.1	↗	Subvencioni mund të ndihmojë në formalizimin e konsumatorëve vulnerabël, duke reduktuar lidhjet e paligjshme dhe abuzimet.
2	Mbulimi i Kostove Operative (O&M)	%	100.5	109.8	↗	Rritja tregon përmirësim në eficiencë, subvencioni ndihmon duke stabilizuar të ardhurat përmes rimbursimit të shtresave në nevojë.
3	Norma e Arkëtimit Korrente	%	83.9	84.6	↗	Subvencioni garanton pagesën e 5 m ³ për një pjesë të konsumatorëve, çka ndihmon pjesërisht arkëtimin.
4	Mbulimi i Kostove Totale	%	72.8	83.2	↗	Ndihma financiare shtetërore për shtresat në nevojë ul riskun e mos pagesës dhe përmirëson bilancin.

5	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme	%	103.5	102.6	↘	Subvencioni ndihmon, por vetëm për një segment të vogël; ndikimi i plotë varet nga disiplinimi i konsumatorëve të tjerë.
6	Niveli i Matjes	%	86.5	87.9	↗	Matja është thelbësore për aplikimin e subvencionit me saktësi – kjo shtyn shoqëritë të instalojnë më shumë matësa.
7	Eficienca e Stafit	staf / 1000 lidhje	4.56	4.43	↗	Mbulimi i subvencionit për familjet vulnerabël ul presionin e ndjekjes për arkëtime, çka rrit eficiencën.
8	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	orë / ditë	16.3	17.44	↗	Mbështetja financiare ndihmon Shoqëritë të investojnë në përmirësime teknike.
9	Mbulimi i Furnizimit me Ujë	%	75.3	77.8	↗	Subvencioni mund të përdoret si bazë për zgjerim të shërbimit në zonat me konsumatorë të pambuluar.
10	Mbulimi me Kanalizime	%	54.8	57	↗	Rritja e formalizimit të konsumatorëve përmes subvencionit mbështet edhe lidhjen me sistemin e kanalizimeve.
11	Eficienca e Energjisë (kWh/m³)	kWh / m³	0.63	0.66	↘	Subvencionimi i kostove të energjisë për shoqëritë me ngritje mekanike është një komponent i drejtpërdrejtë që duhet të çonte në përmirësim, por besueshmëria e të dhënave sjellë problematika.
12	Ankesat e Klientëve	%	4.23	4.6	↘	Zbritja direkte në faturë për shtresat në nevojë përmirëson perceptimin e shërbimit dhe duhet të uli ankesat.

Të dhënat tregojnë që, në nivel sektori:

- *Performanca teknike dhe financiare është përmirësuar në shumicën e treguesve në vitin 2024;*
- *Subvencioni ka rol mbështetës, sidomos në përmirësimin e arkëtimeve, nivelit të matjes, reduktimit të ujit pa të ardhura, dhe perceptimit të konsumatorëve;*
- *Por ndikimi i tij është i kufizuar në përmasa, për shkak se shtrihet vetëm te një pjesë e konsumatorëve (shtresat në nevojë) dhe nuk adreson problemet sistematike si humbjet e mëdha të ujit apo tarifimi jo-kosto reale.*
- *Shoqëritë me performancë të dobët dhe pa kontratë me AKUK (si Kamëz) do të përballen me vështirësi për shkak të mungesës së rimbursimit dhe strukturës së të ardhurave.*
- *Shoqëritë rajonale me bazë më të gjerë konsumatorësh kanë më shumë kapacitet për të përballuar zbritjen, por gjithsesi rrezikojnë nëse numri i përfituesve është i lartë dhe efikasiteti operacional mbetet i ulët.*
- *Ndikimi është më i madh në shoqëritë rajonale me përqindje të lartë të popullsisë me ndihmë ekonomike dhe me tarifa më të ulëta, duke përforcuar nevojën për masa balancuese financiare.*

4. Ndikimi i Skemës së Subvencionimit në Menaxhimin e Qëndrueshëm dhe Mbrojtjen e Burimeve Ujore

Përveç efektit të drejtpërdrejtë financiar dhe social, subvencionimi i 5 m³ ujë për familjet me ndihmë ekonomike përbën edhe një **instrument mjedisor indirekt** për mbrojtjen e burimeve ujore. Përmes

matjes së saktë, ndërgjegjësimi dhe vendosjes së limiteve të subvencionit, arrihet një ulje e abuzimit me konsumin. Rritja e efikasitetit të energjisë dhe kontrollit ndaj rrjedhjeve gjithashtu ndihmon në ruajtjen e burimeve ujore.

Zbatimi i skemës së subvencionimit të konsumit bazë të ujit ka sjellë një sërë ndikimesh pozitive në drejtim të mbrojtjes së burimeve ujore dhe rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit. Impaktet kryesore për mbrojtjen e burimeve ujore përfshijnë:

- *Reduktimi i shpërdorimit të ujit* – kufizimi i subvencionit në 5 m³ në muaj nxit konsumatorët të jenë më të ndërgjegjshëm dhe të shmangin përdorimin e panevojshëm, duke kontribuar në ruajtjen e burimeve të kufizuara ujore;
- *Përdorim racional dhe më efikas i ujit* – subvencioni zbatohet vetëm mbi konsumin e matur në mënyrë të verifikueshme, çka inkurajon përdorimin në përputhje me kufijtë teknikë dhe ekonomikë të sektorit;
- *Rritja e ndërgjegjësimi mjedisor të konsumatorëve* – përfituesit zhvillojnë një kuptim më të mirë për rëndësinë e kursimit të ujit dhe kontrollit të konsumit, duke ndihmuar në ndërtimin e një kulture të qëndrueshmërisë dhe përgjegjshmërisë mjedisore;
- *Rritje e efikasitetit në shpërndarje* – përmes formalizimit të lidhjeve dhe eliminimit të lidhjeve të paligjshme ose abuzive, Shoqëritë arrijnë të kontrollojnë më mirë presionet në rrjet dhe humbjet nga rrjedhjet e paidentifikuara.
